



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
PËRPUTHSHMËRIE
KRYER NË “ DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t KAVAJË”

DHJETOR 2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

PËRMBAJTJA		Faqe	
I.	Përmbledhje Ekzekutive	3-15	
II.	Hyrja	<i>a. Objektivat dhe qëllimi</i>	15-19
		<i>b. Identifikimi i çështjes</i>	
		<i>c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	
		<i>d. Përgjegjësitë e audituesve</i>	
		<i>e. Kriteret e Vlerësimit</i>	
		<i>f. Standartet e auditimit</i>	
III	Përshkrimi i auditimit	19-101	
III.1	<i>Zbatimi i procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale</i>	19-56	
III.2	<i>Auditim mbi hartimin dhe zbatimin buxhetit</i>	56-75	
III.3	<i>Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës</i>	75-82	
III.4	<i>Mbi administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i asetëve dhe aktiveve</i>	82-89	
III.5	<i>Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.</i>	89-101	
III.6	<i>Probleme të ndryshme që mundë të dalin gjatë auditimit, ankesat.</i>	101-104	
IV	Gjetje dhe Rekomandime	104-125	
V	Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	125-127	
VI	Anekse	127-189	



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. a. Përshkrimi i shkurtër i Auditimit

Në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë nga viti 2006 deri në 31.08.2019, sipas pasqyrave të paraqitura për objektet informale të ndërtuara dhe kërkesat e bëra për legalizim (vetëdeklaruar), nga viti 2005 deri në 31 Gusht 2019 janë vetëdeklaruar **17,625 objekte informale**. Për vitet 2005 – 2006 janë vetëdeklaruar *9,603 objekte informale*, për vitin 2013 janë vetëdeklaruar *515 objekte informale*, për vitin 2014 – 2015 janë vetëdeklaruar *7,239 objekte informale*, për vitin 2017 – deri në korrik të 2019 janë vetëdeklaruar *268 objekte informale*.

Sipas procesit të ndjekur për legalizimin e objekteve rezulton se sipas Urdhërit nr.58, datë 05.04.2016 është miratuar, struktura e organikes së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave /Informale (Aluizni dhe Drejtoritë në vartesi të saj).

Sipas urdherit me nr.641, datë 09.05.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm është krijuar Drejtoria e Aluiznit Kavajë e cila ushtron veprimtarine dhe funksjonin për kryerjen e procedurave të legalizimit në teritorin e bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë.

Nga sa më sipër u kostatuan se nga Qershori i vitit 2016 deri në Gusht të vitit 2019 kostatohet se janë legalizuar gjithsej **2950 objekte**, nga këto në vitin 2016 janë legalizuar *296 objekte*, në vitin 2017 janë legalizuar *894 objekte*, në vitin 2018 janë legalizuar *1,315 objekte* dhe në vitin 2019 janë legalizuar *445 objekte*

Për periudhën e programit të auditimit për objektet e legalizuara nga viti 2016 deri në Gusht të vitit 2019 rezulton se janë 2,950 objekte të legalizuara në një periudhë 38 mujore, pra në muaj mesatarisht janë legalizuar 78 objekte, pra nga 17,625 objekte gjithsej janë legalizuar 2,950 objekte dhe ngelen për tu legalizuar dhe **14,675 objekte** (17,625-2,950), pra duhen edhe **16 vjet** për të mbaruar procesi i legalizimeve me ritmet e përmendura si më sipër.

-Nga 2950 objekte të legalizuara nga viti 2016 deri në tetor të vitit 2019, janë pa likuiduar parcelat ndertimore *1,798 objekte*, ose 61 përqind e lejeve të legalizimit janë të pa përfunduara.

Në mënyrë të përmbledhur, referuar pasqyrave të paraqitura nga viti 2016 deri në gusht të vitit 2019 sipas raportimeve në ish/Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit Tiranë rezulton se në nxjerrjen e praktikave nga arkiva për dosjet në proces legalizimi për shqyrtim administrativ të procedurave të legalizimit në përfundim të auditimit rezultoi se:

-Në 61 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndertimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndertimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri).

- Në 18 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, ndërkohë që në 5 raste nuk është respektuar afati 30 ditor për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim me: pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 i ndryshuar “Për përcaktimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar, pika 2 e VKM nr.954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” me ndryshime

-Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi*”. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 1947 objekte informale dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 78,940,503 lekë

-Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë (Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2016 deri 31.08.2019 janë lëshuar 2950 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 2950 leje legalizimi të lëshuara, 1798 leje legalizimi ose rreth 60 % e tyre lejet e legalizimit janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “*Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave*” referuar V.K.M. nr.954, datë 25.11.2015 dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015”. Për 2431 leje legalizimi nuk është arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore në vlerë 63,700,768 lekë dhe Bono Privatizimi. Veprim në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17.

-Në 29 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi*:

-Në 11 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në 5 raste është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, geramat: “dh”;

-Në 13 raste me sipërfaqe prej 6727 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll, Ullishte”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT “DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË”

zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

- Në 2 raste u konstatua se ndërtimet informale të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, konkretisht:

a. *Leje legalizimi 7002061, datë 31.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, mbi godinë ekzistuese 2-kat (gjithsej godinë banimi 4-kat), pasuria 16/148/1, ZK 8551, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 126 m², me sipërfaqe ndërtimi 126 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 294,2 m², rezulton se:*

b. *Leje legalizimi 7002117, datë 26.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, e ngritur mbi ndërtesën e vjetër 82 m² (prishur), pasuria 4/154, ZK 8552, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 109 m² me sipërfaqe ndërtimi 109 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 255 m², rezulton se: ndërtimi informal ka pjesërisht probleme me truallin për diferencën me sipërfaqe 27 m² (109-82= 27 m² rrugë), pasi ndërtimi informal ka baze ndërtimi sipërfaqen 109 m² nga 82 m² që ishte ekzistuesi.*

-Në 1 rast legalizimi i ndërtimit informal prek zbatimin e projektit infrastrukturës rrugore, pasi nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga me të cilat kufizohet, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar ligjin nr. 50/2014, me VKM nr. 756 datë.10.2016 pika 2 /i dhe gj, me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës të ligjit urbanistikës 8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar.

-Dosja nr. 1145, A.A, leje legalizimi datë 27.08.2019, titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM, “ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik”, pasuria 14/389, ZK 8551, lagjia nr. 2 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 34,5 m² me sipërfaqe ndërtimi 34,5 m², rezulton se:

-Subjekti ka të legalizuar parcelën ndërtimore me sipërfaqe 34,5 m², por në fakt disponon sipërfaqen e zënë në mënyrë të paligjshme 62 m², sipas të dhënave të ZVRPP, për rrjedhojë diferenca tepër 27,5 m² e zënë në mënyrë të paligjshme duhet të sistemohet.

-Në një rast, për “shtesën anesore 2-kat + ngritje 1-kat në godinën ekzistuese ish-dekori, argjila dhe qeramika ose poceria Kavajë”, pasuria nr. 2/304/2 dhe 2/304/1, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 93 m² (sipërfaqe ndërtimi 85 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi e shtesës 161,7 m² për banim dhe 170 për aktivitet), pasi nuk respektohet distanca, konkretisht: skicat nuk i pasqyrojnë distancën e pronës nga rruga (veri), Po kështu, proces verbali i konstatimit datë 27.02.2018 nuk pasqyron pasuritë kufitare dhe distancat e tyre nga pasuria e legalizuar.

Nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin për diferencën 514 m² (blerë 2040 m²- 2554m² LN), e cila duhej të kalonte “shtet” si diferencë midis sipërfaqes blerjes truallit (1998) me LN (2017), pasuria 2/304 (2017) ZK 8551, vol 13, faqe 247, në emër të K.Ç, sipas shkresës ZVRPP 1362/1 datë 28.03.2018, ku pasuria e legalizuar përfshinë pasuritë 2/304 “K.”, 2/55 dhe 2/54 “shtet si dhe nr. 2/56 “bashkpronarët Tare”

-Në dosjen me leje legalizimi datë 23.08.2019, për “godinë e kombinuar 3-kat”, pasuria 482/17/1, ZK 3235, Rrogzhinë, parcela ndërtimore 500 m², për aktivitet 328 m² dhe 585 m² për banim, rezulton se: mungon pjesërisht marrëdhënia me truallin për pasurisë 482/17/1, pasi një pjesë e sipërfaqes “arë” mbi të cilin është ngritur objekti është pronë e një personi tjetër (akti 329, H.Q.), sipas KPP pasuria 482/17, vol 10, faqe 224, ZK 3235. Subjekti ka në pronësi pasurinë 482/16, sipërfaqe 638 m², arë, vol 3, faqe 100, ZK 3235, përfutur me KDH (me origjinë AMTP 198). Në seksionin “D” ose “E” të 2 KPP nuk citohet se: ka ndërtim pa leje ose okupim mbi pasuritë 482/16 dhe 482/17



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

- Në një rast, për “*godinë e kombinuar 2-kat*”, pasuria 6/187/1, ZK 8552, Kavajë, parcela ndërtimore 148 m², për aktivitet 132 m² dhe 170.5 m² për banim, rezulton se:
 - a. leja e legalizimit është dhënë në kushtet e mos paraqitjes së plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të parregullsisë së tij, në kundërshtim me nenin 33 “Dispozitë detyruese” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin 50/2014, neni 33,
 - b. mungon shkresa e pushtetit vendor, nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të sistemit rrugor, për efekt të zgjerimit rrugëve me interes publik, pasi objekti ndodhet ngjitur dhe mbi trotuarin e rrugës, sipas fotove dhe genplanit të objektit të kryer nga inspektorët e terrenit.
- Në 2 raste u konstatua se ndërtimet informate të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë edhe pasuri të tretëve, të cilët kanë certifikate pronësie, *ndërtesë social-ekonomike 3-kat*, pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² me sipërfaqe ndërtimi 262 m², sipërfaqe për aktivitet 795,2 m², *ndërtesë social-ekonomike 2-kat*, pasuria 72/24/1, ZK 3554, S. Kavajë, baxho qumështi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqe ndërtimi 2271,3 m² sipërfaqe për aktivitet 4542,6 m².
- Në ish Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë nuk administrohet dokument mbi përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, duke mos siguruar edhe gjurmët e auditimit, në kundërshtim me Kap. I, pika 1.2, shkronja “a” dhe Kap. II, pika 2.1.2 dhe 2.1.3 të Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, me përcaktimet e bëra në Kap. 2, pika 7 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.3.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të qeverisë”, si dhe me nenin 12, pika 2 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pra nga DRAK nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar mbi planifikimin e nevojave për fonde buxhetore për vitin 2018 dhe 2019
- Në 6 raste është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve në llogaritë ekonomike të përdorura, në kundërshtim me përcaktimet e bëra për SKK 5 të përmirësuara (trajtimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale) bazuar në Urdhrin nr.65, datë 5.5.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar”, i ndryshuar, me Kreun III, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar, si dhe me nenin 12, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar
- Në dy raste është vepruar në kundërshtim me pikën nr.151, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe pikës 3, Kreu I, të Udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, për mosrespektimin e prioritetit të radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit
- Në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë për vitet 2016-2018 nga DRAK nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar i monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Për vitin 2018 nga DRAK janë drejtuar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t 6 kërkesa për fonde për miratim rritje autorizim buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet, për kryerjen e shpenzimeve operative, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me nenin 45, të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe me pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

- Procedurat për marrjen në dorëzim të aktiveve për vitin 2016 dhe 2018, nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 42, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Për vitet 2015-2018, u konstatua se vlerat e aktiveve të institucionit, të pasqyruara në raportet e inventarizimit periodike vjetore rezultojnë me diferenca, viti 2016-410,139 lekë; viti 2017-306,674 lekë dhe viti 2018-644,957 lekë. Gjithashtu rezultoi se në asnjë prej viteve 2016/17/18, nga komisionet respektive të inventarizimit të aktiveve, nuk janë pasqyruar diferencat dhe më pas të mbaheshin procesverbalet për këto diferenca, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja "b" dhe "c" të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar
- Për periudhën 2016-2018 është konstatuar se vlera e detyrimeve të DRAK-së, pasqyruar në Pasqyrat Financiare sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni janë të gabuara dhe nuk pasqyrojnë informacion të saktë dhe real, në kundërshtim me nenin 61, shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar
- përlllogaritje të gabuar të vlerës së amortizimit për aktivet e institucionit, konkretisht për vitin 2017 sipas përlllogaritjeve të DRAK vlera e amortizimit është 287,183 lekë, ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit është 130,942 lekë
- Në vitin 2018, në 3 raste ka konstatuar se llogaria 7110 të ardhura nga tarifa administrative dhe rregullatore, llogaria 7115 të ardhura nga gjoba, kamatvonesa, sekuestrime, llogaria 7116 të ardhura nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore, nuk pasqyrojnë vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar
- Në dy raste të procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra për vitin 2018 dhe 2019, grupi i auditimit ka konstatuar se ofertuesi i shpallur fitues nga anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave të ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.35 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra" është bërë në kundërshtim me kriteret e hartuara në dokumentin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 34 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qera", për arsye se është vlerësuar oferta e cila ka mangësi në dokumentacion dhe nuk plotëson kriteret e vendosura, konkretisht për dokumentin e pronësisë së ambjenteve pasi disponohet dokument pronësie vetëm për sipërfaqen 110 m² dhe jo për sipërfaqen 101.6 m², dhe si pasojë e këtyre veprimeve fondet e shpenzuara për hapsirën 101.6 m² nga data 03.04.2018-03.04.2019 në vlerën **384,000 lekë** do të konsiderohen mospërdorim efektiv i fondeve publike.

I.b. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJ A NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMITAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
1.	<p>Në 61 rastet "Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje", pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin "Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri)</p>	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë të marrë masa për 61 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar " <i>Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje</i> ", me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore dhe t'i kërkojnë Ministrisë së Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
2.	<p>Në 18 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbal i konstatimit në terren, ndërkohë që në 5 raste nuk është respektuar afati 30 ditor për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim: pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 i ndryshuar "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" i ndryshuar, pika 2 e VKM nr.954, datë 25.11.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit" me ndryshime</p>	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke ritur edhe transparencën për publikun.
3.	<p>Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) në marrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" – "<i>vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi</i>". Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 1947 objekte informale dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 78,940,503 lekë</p>	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i dërgojë shkresat Bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë për 823 objekte të cilat nuk u janë nisur shkresat bashkive perkatse për likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën 78,940,503 lekë, dhe nga keto nuk janë nisur shkresat për 823 objekte në vlerën prej 31,737,349 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, në refuzim të vendosjen masë për kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMTAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
4.	<p>Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2016 deri 31.08.2019 janë lëshuar 2950 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 2950 leje legalizimi të lëshuara, 1798 leje legalizimi ose rreth 60 % e tyre lejet e legalizimit janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit "<i>Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave</i>" referuar V.K.M. nr.954, datë 25.11.2015 dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015". Për 2431 leje legalizimi nuk është arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore në vlerë 63,700,768 lekë dhe Bono Privatizimi. Veprim në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 5)</p>	Faqe 19-56	E lartë	<p>Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:</p> <p>-të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për 1798 dosje të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin e vlerës së parcelave ndërtimore.</p>
5.	<p>Në 29 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:</p> <p>- Në 11 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përfundimi nga legalizimi" me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" kreu III. "Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara", pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë", neni 2 "Përcaktime dhe klasifikime rrugësh" dhe neni 4, "Përcaktimi i qendrave të banuara" -VKM nr. 153, date 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë" neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;</p> <p>- Në 5 raste është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacioni justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" Kreu III, pika 4, geramat: "dh";</p> <p>-Në 13 raste me sipërfaqe prej 6727 m2, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP,</p>	Faqe 19-56	E lartë	<p>Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë (DRASHK), për objektet informale të ndërtuara në kundërshtim me ligjin e legalizimit dhe të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara: të marrë masa në të ardhmen që të mos lejojë legalizimin e ndërtimeve informale të ndërtuara pranë kanaleve rrugeve, objekte papërfunduara me tendecë ngritjen e kateve tjera mbi objektin e legalizuar.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMTAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
	parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit "Arë, Pyll, Ullishte". Pra legalizimi është kryer në zona "Territore të tjera", për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimit e zonave informale" i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale".			
6.	Nga auditimi i dosjes I.M me leje legalizimi datë 01.08.2016, <i>godinë banimi 1-kat</i> , Synej, për parcelën ndërtimore të tij me sipërfaqe 171,6 m ² , sipërfaqe totale ndërtimi 171,6 m ² , në ZK 3554, pasuria 73/1/1, rezultoi se: distanca e ndërtimit informal me rrugën nuk saktësohet, pasi sipas genplanit paraqitet 21,5 m, ndërsa sipas HTR pasqyrohet ngjitur me rrugën	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 73/1/1, ZK 3554, Synej , për shkeljet e konstatuara të kërkojë nga subjekti plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar, për saktësimin e distancës të ndërtimit informal nga rruga dhe për pagesën e taksës infrastrukturës, në të kundërt të fillojë procedurat e anulimit të lejes së legalizimit.
7.	Dosja 665 S.Gj. me leje legalizimi 7002128, datë 16.09.2016, "godinë banimi 1-kat", Golem, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 399 m ² (sipërfaqe ndërtimi dhe totale 133,1 m ² , në ZK 1791, pasuria 38/26/1. Statusi juridik i pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti është sipërfaqja 650 m ² arë "shtet", pasurisë 38/24, vol 6, faqe184, ZK 1791, rezultoi se: a. Përveç legalizimit të parcelës ndërtimore shtet 399 m ² , subjekti ka të zaptuar dhe e posedon edhe pjesën e parcelës ndërtimore të pa legalizuar 250 m ² (650-399), pa asnjë detyrim financiar apo qiraje. Veprim në kundërshtim me urdhrin e drejtorit përgjithshëm 30, datë 15.01.16, i ndryshuar, si dhe shkronja "F" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 38/26/1, Golem, ZK 1791 , për shkeljet e konstatuara: - të marrë masa për sistemimin "shtet" të sipërfaqes të palegalizuar 250 m² , ose për shitjen e saj poseduesit me çmimet e tregut apo dhënien me qera, - të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar për pagesën e taksës infrastrukturës dhe parcelës ndërtimore
8.	Dosja e H.Rr. leje legalizimi datë 16.09.2016, ndërtesë banimi 2-kat, pasuria 3/312, ZK 8552, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 123 m ² , me sipërfaqe ndërtimi 123 m ² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 263,4 m ² , rezultoi se: a. ALUIZNI Kavajë nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka dërguar shkresë pushtetit vendor, nëse ndertimi informal pengon planin rregullues të qendrës qytetit, ka zënë hapësirën publike, shkel distancat nga rruga dhe pallati si dhe kufitarët. b. Ndertimi informal 2-kat me 123 m ² është ngritur mbi ndertimi ekzistues (prishur) me 109 m ² , pra paraqet shtese të bazes së ndertimit prej 14 m ² , madje shkallet jane jashte objektit mbi trotuare, për pasojë kjo shtesë dhe shkallet kanë ndikuar në hapësirën publike, probleme të cilat nuk jane prekur nga inspektorët e terrenit. c. Nuk ka paguar taksën e ndikimit të	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria nr. 3/312, ZK 8552 , për shkeljet e konstatuara: të marë masa për kufizimin e pasurisë deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar në bashkëpunim me pushtetin vendor , për shtesën e ndertimit prej 14 m ² dhe për pagesën e taksës infrastrukturës në vlerën 41,815 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMTAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
	infrastrukturës në vlerën 41,815 lekë për godinën banimi 2-kat me sipërfaqe totale ndërtimi 263,4 m ² (263,4 m ² x 31750 leke/m ² x 0.5 %) pranë Bashkisë Kavajë, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, nenin 27, pika ç dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146, datë 28.9.2009 "Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore"			
9.	<p>Në 2 raste u konstatua se ndertimet informale të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, konkretisht:</p> <p>a. Leje legalizimi 7002061, datë 31.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, mbi godinën ekzistuese 2-kat (gjithsej godinë banimi 4-kat), pasuria 16/148/1, ZK 8551, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 126 m² me sipërfaqe ndërtimi 126 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 294,2 m², rezulton se:</p> <p>- ndertimi informal krahas shtesës në lartesi 2-kat paraqet dhe zgjerrim 30 m² (126-96), shtesë e cila prek rrugën dhe nuk kthehet në truall, sipas shkresës ZVRPP nr. 4613/1 datë 21/07/2016, ku thuhet: <i>parcela ndërtimore 126 m², mbi të cilin është ngritur ndertimi informal 126 m², përfshinë pasuri tjera, si: * pasurinë 16/143, rrugë, vol 7, faqe 146, ZK 8551, në emer shtet dhe * pasurinë 16/148, truall 273 m² (nga kjo 96 m² ndërtesë) vol 10, fq 55, ZK 8551,</i></p> <p>b. Leje legalizimi 7002117, datë 26.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, e ngritur mbi ndërtesën e vjetër 82 m² (prishur), pasuria 4/154, ZK 8552, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 109 m² me sipërfaqe ndërtimi 109 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 255 m², rezulton se: ndertimi informal ka pjesërisht probleme me truallin për diferencën me sipërfaqe 27 m² (109-82= 27 m² rrugë), pasi ndertimi informal ka baze ndertimi sipërfaqen 109 m² nga 82 m² që ishte ekzistuesi.</p>	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektet informale të pajisur me leje legalizimi, pasuria 16/148/1, ZK 8551 dhe pasuria 4/154, ZK 8552 , për shkeljet e konstatuara: të kërkojë plotësimin dhe rivlerësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar në bashkëpunim me pushtetin vendor, për disponimin e dokumentin për marrëdhëniet pjesërisht me truallin (30 dhe 27 m²), pasi ndertimet informale prekin pjesërisht rrugën, në të kundërt të kufizohen pasuritë.
10.	Dosja B.dhe A.L me leje legalizimi datë 28.08.2019, për "godinë banimi 2-kat", pasuria 11/114/1, ZK 8551, Kavajë, parcela ndërtimore 154 m ² , rezulton se: Dokumentacioni tekniko-ligjor paraqet mangësi, konkretisht: * parcela ndërtimore mbi të cilën është ngritur ndertimi informal (nr.11/114/1=200 m ² ,vol 9, faqe 223) i poseduar nga pronarët L përfshinë edhe pasuritë 11/73 dhe 11/74 të personave tjerë, sipas shkresës 6328/1 datë 22.10.2018 të ZVRPP Kavajë. Pra nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin. Veprim në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 50/2014, nenin 62 të rregullores së urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr. 8405 datë 17.09.1998 i ndryshuar me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 "Për miratimin rregullores zhvillimit territorit" e ndryshuar. * mungon marrëveshja noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, pasi parcela	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 11/114/1, ZK 8551 , Kavajë, për shkeljet e konstatuara: të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, në të kundërt pasuria të kufizohet.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJ A NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMTAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
	ndërtimore prej 200 m ² është pronë e 2 personave të B.Ldhe A.L. sipas KPP vol 9, faqe 223 dhe 2 certifikatave familjare, veprim në kundërshtim me nenin 28/ë të ligjit "Dhënia e lejes së legalizimit"			
11.	<p>Në 2 raste u konstatua se ndërtimet informate të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë edhe pasuri të tretëve, të cilët kanë certifikate pronësie:</p> <p>a. Dosja e B.H.dhe F.H., leje legalizimi datë08.2019, ndërtesë social-ekonomike 3-kat, pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m², me sipërfaqe ndërtimi 262 m², sipërfaqe për aktivitet 795,2 m²,</p> <p>b. Dosja e A.C. ose "M" shpk, leje legalizimi datë01.2019, ndërtesë social-ekonomike 2-kat, pasuria 72/24/1, ZK 3554, Synej Kavajë, baxho qumështi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqe ndërtimi 2271,3 m²., sipërfaqe për aktivitet 4542,6 m²,</p> <p>"M" shpk disponon prone te tij pasurinë 72/24, siperfaqe 2000 m² truall (nga kjo 380 m², ndertese 3-kat ekzistuese ish-zyrat e konop. Synej), sipas certifikates pronesise 13.03.2007, ndersa per zgjerimin "shtese 2-kat në objektin ekzistues 3-kat" nuk ka dokument pronësie për diferencën e truallit me sipërfaqe 271,3 m² (2271,3-2000), pasi sipërfaqja e parcelës dhe ndërtimore është 2271,3 m², 2271,3 m², nga 2000 m² që ka pronën e tij</p>	Faqe 19-56	E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për 2 objektet informale të pajisura me leje legalizimi, pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille dhe pasuria 72/24/1, ZK 3554, Synej , për shkeljet e konstatuara: të kufizohen pasuritë deri në zgjidhjen e marrëdhënieve për një pjesë me truallin , pasi është pasuri e të tretëve me certifikate pronësie.
12.	<p>Në dy raste të procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra për vitin 2018 dhe 2019, grupi i auditimit ka konstatuar se ofertuesi i shpallur fitues nga anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave të ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.35 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra" është bërë në kundërshtim me kriteret e hartuara në dokumentin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 34 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qera", dhe si pasojë e këtyre veprimeve fondet e shpenzuara për hapsirën 101.6 m² nga data 03.04.2018-03.04.2019 në vlerën 384,000 lekë do të konsiderohen mospërdorim efektiv i fondeve publike.</p>	Faqe 56-75	E lartë	Titullari i DVASHK Kavajë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 384,000 lekë, nga subjekti përfitues.
13.	<p>Grupi i auditimit nga auditimi i dokumentacionit financiar (urdhër shpenzimet, situacionin e shpenzimeve për vitin 2016) të vënë në dispozicion nga DRAK, rezulton se për periudhën (01.05.2016-31.12.2016) ose 8 muaj, në procedurën e marrjes në përdorim të ambjenteve të Pallatit të Kulturës për zyra për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë, nga DRAK nuk janë paguar detyrimet për ujën dhe energjinë elektrike të konsumuar, sipas përcaktimit të bërë në nenin 2, pika 5 të kontratës nr.1871 prot., datë 04.07.2016, me objekt "HUAPËRDORJE", duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt dëm ekonomik</p>	Faqe 56-75	E lartë	Grupi i auditimit, për arsye të mungesës së dokumentacionit që tregon sasinë e ujit dhe energjisë elektrike të konsumuar për gjatë kësaj periudhe , i rekomandon Drejtorit aktual të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kavajë, marrjen e masave për përllogaritjen e vlerës së dëmit të shkaktuar, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës në buxhetin e shtetit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

GJETJ A NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERE NCA ME RAPORT IN PËRFUN DIMTAR	RËN DËSI A	REKOMANDIMI
14.	Në ish Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë nuk administrohet dokument mbi përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, duke mos siguruar edhe gjurmët e auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika 2 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Pra nga DRAK nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar mbi planifikimin e nevojave për fonde buxhetore për vitin 2018 dhe 2019.	Faqe 56-75	E mes me	Titullari i DVASHK Kavajë, në rolin e drejtuesit të programit buxhetor, në fillim të planifikimit të nevojave për fonde buxhetore të marri masat e nevojshme duke krijuar ekipin e menaxhimit të programit, si dhe përcaktimin e nëpunësit zbatues të DVASHK, në rolin e sekretarit të grupit për hartimin e projekt-buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor. Gjithashtu procedura e përgatitjes së buxhetit të sigurojë gjurmët e auditimit, ku çdo anëtar i grupit të menaxhimit të programit të dokumentojë me shkresë përcjellëse drejtuar sekretarit të grupit, kërkesat për fondet buxhetore, për strukturën që është përgjegjës.
15.	Grupi i auditimit për vitin 2018, në 3 raste ka konstatuar se llogaria 7110 të ardhura nga tarifa administrative dhe rregullatore, llogaria 7115 të ardhura nga gjoha, kamatvonesa, sekuestrime, llogaria 7116 të ardhura nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore, nuk pasqyrojnë vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.	Faqe 82-89	E mes me	Titullari i DVASHK Kavajë, të marri masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë dhe real të vlerave të të ardhurave në llogaritë e mësipërme në pasqyrat financiare.
16.	Grupi i auditimit ka konstatuar se në procedurën e prokurimit publik me objekt "furnizimin me kompjutera" për vitin 2016, me fond limit 300,000 lekë pa tvsh, nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të furnizuara, nuk administrohet asnjë dokument ose procesverbal për marrjen në dorëzim të mallrave nga OE "P.S", verifikimin e tyre e më pas në arritjen në përfundimin se këto mallra nuk janë sipas përcaktimeve të bëra. Si pasojë e këtij mosveprimi është shpallur fitues operatori ekonomik i renditur i dyti në ofertë, dhe <i>ndaj buxhetit të shtetit është krijuar efekt negativ financiar në vlerën 32,500 lekë</i> , diferenca në lekë nga oferta e përzgjedhur fituese me ofertën e skualifikuar.	Faqe 89-101	E lartë	Titullari i DVASHK Kavajë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 32,500 lekë , si dhe çdo veprim nga komisionet e ngritura për realizimin e procedurave të prokurimeve (komisioni i prokurimit, komisioni i marrjes në dorëzim, komisioni i përcaktimit të kriterëve kualifikuese, etj) të dokumentohen dhe inventarizohen.

I.c. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë), në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe (ISSAI 4100)¹ për të cilën do të japim opinion:

-Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i dërgojë shkresat Bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë për 823 objekte të cilat nuk u janë nisur shkresat

¹ **ISSAI 4100** - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

bashkive perkatse për likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën **78,940,503 lekë, dhe nga keto nuk janë nisur shkresar për 823 objekte ne vlerën prej 31,737,349 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, në refuzim të vendosën masë për kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

- Për 1798 leje legalizimi të lëshuara dhe dërguar në ZVRPP për regjistrim të objektit informal për periudhën objekt auditimi në momentin e auditimit nuk ka VKM për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objektit të legalizuar duke sjellë mos llogaritjen e detyrimit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore dhe krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimin e ish pronarëve në shumën 63,700,768 lekë,

- Në 11 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përjashtimi nga legalizimi" me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" kreu III. "Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara", pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë", neni 2 "Përcaktime dhe klasifikime rrugësh" dhe neni 4, "Përcaktimi i qendrave të banuara" -VKM nr. 153, date 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë" neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në 6 rast është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" Kreu III, pika 4, geramat: "dh";

-Në 19 raste me sipërfaqe prej 6,727 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit "Arë, Pyll,Ullishte". Pra legalizimi është kryer në zona "Territore të tjera", për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale" i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale", duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë "Truall"

-Në 2 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti ndodhen mbi një objekt tjetër, dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej verifikimit të pronësisë së parcelës ndërtimore si dhe marrëdhënieve me objektin e vjetër, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprimet janë në kundërshtim me: nenit 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", ndryshuar pika 13.

-Në 3 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e



paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i ndërtuar mbi tortuar mos zbatimit së ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Veprimet në kundërshtim me: nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006; VKM nr.280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", ndryshuar pika 1 e 7.

- Në 3 raste Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si vetëdeklarimi (i regjistruar edhe në faqen zyrtare të ALUIZNI-t) fotografitë e objektit si dhe imazhet satelitore konstatohet se objekti informal i vetëdeklaruar është ndërtuar prane shinave hekurudhore në kundërshtim me ligjin 9317, date 18.11.2004 " Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" neni 35 pika 2 i ndryshuar me 142/2016 neni 118 ,pika 2 si dhe me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, dhe VKM 280 pika 2 dhe 4 e ndryshuar.

-Në 61 rastet "Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje", pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin "Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri)

Opinion i kundërt mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së ALUIZNI Kavajë²

Sipas opinionin tonë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, aktiviteti i kryer nga Drejtoria e ALUIZNI Kavajë për zbatimin e procedurave në legalizimin e ndërtimeve informale për periudhën 2016-Gusht 2019, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, kuadrin ligjor "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

Ne besojmë se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kundërt.

II. HYRJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim për periudhën objekt i këtij auditimi etj.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr.373/1, datë 28.05.2019 dhe nr.577/2 datë

² Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së**, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura, ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.



KONTROLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

24.09.2019, në subjektin Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë, për periudhën nga 01.01.2016 deri në 31.08.2018 u krye auditimi "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.H.M., përgjegjës grupi
2. B.B, anëtar,
- 3.K.K., anëtar,
4. Xh.D., anëtar.

a.Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim për periudhën objekt i këtij auditimi, në përputhje me:

-ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

-Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 i ndryshuar.

-Rregullore "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar. Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi "Auditimin e përputhshmërisë", Manual i Auditimit Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.

-ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.07.2007, ligjin nr.9895, datë 09.06.2008, ligjin nr. 10099, datë 19.03.2009, ligjin nr.10169, datë 22.10.2009 ligjin nr.10219, datë 04.02.2010, ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjin nr.50/2014, datë. 15.05.2014, ligjin nr.62/2015, datë 11.06.2015 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;

-Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" i ndryshuar edhe me VKM nr.756, datë 26.10.2016;

-Vendimi i KM nr.488, datë 22.07.2014 "Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës" i ndryshuar;

-Vendimi i KM nr.1180, datë 5.8.2008 "Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimit e të ardhurave të procesit të legalizimit" i ndryshuar;

-ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave;

-ligjin nr.10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", i ndryshuar; ligjin nr.119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", i ndryshuar; ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";

-ligji nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin"; ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";

-ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik"; ligji nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.



Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Kavajë, mbi çështjet që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, si dhe veprimtarisë ekonomike financiare të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Kavajë.

b. Identifikimi i Çështjeve

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë për periudhën objekt auditimi ka për objekt të veprimtarisë: administrimin e vetëdeklarimeve; procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit; procesi i rregullimit ligjor të situatës, midis poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe pronarëve trualli i të cilëve është zënë nga ndërtime informale; lëshimin e lejeve të legalizimit si dhe bashkëpunimin me institucionet e përfshira në procesin e legalizimit.

Aktivitetet që vlerësohen sipas kriterëve të vlerësimit mbështetur në burimet e përdorura (Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë) janë:

-Të dhënat e aplikimeve për legalizim. Duhet patur parasysh se për shkak të disa fushatave të vetëdeklarimeve, ka një numër dublikimesh në vetëdeklarime (i njëjti objekt i deklaruar disa herë që shkon nga 20-30% të vetëdeklarimeve (sipas D.P. ALUIZNI). Gjithashtu, në vetëdeklarime janë përfshirë edhe një numër objektesh të cilat nuk mund të përfshihen në legalizim për shkak të kohës së ndërtimit të tyre. Kjo shifër varijon nga 7-10% të vetëdeklarimeve (sipas D.P. ALUIZNI). Si rezultat për të arritur në shifrën reale të ndërtimeve pa leje, nga numri i vetëdeklarimeve duhen zbritur dy kategoritë e mësipërme. Përfundimisht, rezulton që numri real i ndërtimeve pa leje të futura në proces legalizimi, në periudhën 2006-Maj 2019, është **17,625 objekte**.

-Procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit. Gjatë periudhës së përfshirë në projekt raport është **kryer evidentimi faktik në terren për 3577 ndërtime pa leje, si dhe janë kryer kualifikimet e 3312 objekteve informale**. Kjo procedure, përfshin përditësimin në terren të gjendjes ndërtimore dhe plotësimin e hartimin e dokumentacionit tekniko-ligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj.)

-Procesi i rregullimit ligjor të situatës, midis poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe pronarëve, trualli i të cilëve është zënë nga ndërtime informale, sikurse është përcaktuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar. Në periudhën objekt auditimi nga ish DR ALUIZNI-t Kavajë janë lëshuar **1798 leje legalizimi vetëm objektin në pritje të daljes së VKM për të likuiduar parcelën ndërtimore në sipërfaqe 419,084 m² ne vlere totale te pa likuiduar prej 79,625 mijë lekë (419,084 m² x 190 lek për m²) lekë + bono privatizimi**.

c.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Drejtoria e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimin e Zonave\Ndërtimeve Informale Kavajë, në zbatim të ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ka për objektiv:

-Legalizimin e objekteve pa leje dhe shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi".

-Kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji në favor të zaptuesit të pronës.

-Urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës.



-Procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve dhe shtesa informale në objektet me leje ndërtimi si dhe ngritjen e funksionimit të strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.

d.Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH^{së}, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, ka zbatuar, Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit dhe Standardet e Miratuara të Auditimit duke patur në qendër të vëmendjes:

- Evidentimi i shmangieve në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Kavajë me kërkesat e ligjshmërisë për periudhën objekt i auditimit.
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve në përputhje me legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Kavajë.
- Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve, zbulimi i veprimeve të kundërligjshme me pasojë dëm ekonomik, mungesë të ardhurash.
- Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.
- Evidentimi i shkeljeve dhe parregullsive në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik-financiar të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Kavajë.
- Vlerësimi i transparencës me publikun, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërpulthjeve në të ardhmen.

f.Kriteret e vlerësimit:

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Kavajë, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave të paraqitura, sistemit hartografik.

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën, është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", -ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.07.2007, ligjin nr.9895, datë 09.06.2008, ligji nr.10099, datë 19.03.2009, ligjin nr.10169, datë 22.10.2009 ligjin nr. 10219, datë 04.02.2010, ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjin nr.50/2014, datë. 15.05.2014, ligjin nr.62/2015, datë 11.06.2015 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar; ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin standardeve dhe rregullave kontabël", ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" etj.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;



-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:

-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

g.Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksonimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr.85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

Pika nr.1 e Raportit të Auditimit: Zbatimi i procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale.

-Krijimi i bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe përpunimi i tyre. Evidentimi dhe diferencimi në subjekte përfitues apo jo nga procesi i legalizimit.

Nga viti 2006 deri në 31.08.2019, sipas pasqyrave të paraqitura për objektet informale kërkesat për legalizim (vetëdeklaruar),nga viti 2005 deri në 31 Gusht 2019 janë vetedeklaruar **17,625 objekte informale**. Për vitet 2005 – 2006 janë vetedeklaruar 9,603 objekte informale, për vitin 2013 janë vetedeklaruar 515 objekte informale, për vitin 2014 – 2015 janë vetedeklaruar 7,239 objekte informale, për vitin 2017 – deri në korrik të 2019 janë vetedeklaruar 268 objekte informale. Të dhënat e detajuara janë pasqyruar në tabelen e mëposhteme:

Nr.	Periudha	Nr. vetedeklarimeve
1	2005 – 2006	9,603
2	2013	515
3	2014 – 2015	7,239
4	2017 – korrik 2019	268
TOTALI		17,625

Sipas procesit të ndjekur për legalizimin e objekteve rezulton se sipas Urdhërit nr.58, datë 05.04.2016 është miratuar, struktura e organikes së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjensisë së Legalizimit,Urbanizimit dhe Integritit të Zonave /Informale (Aluizni dhe Drejtoritë në vartesi te saj).

Sipas urdherit me nr.641,datë 09.05.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm është krijuar Drejtoria e Aluiznit Kavajë e cila ushtron veprimtarine dhe funksjonin për kryerjen e procedurave të legalizimit në teritorin e bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Nga sa më sipër u kostatuan se nga Qershori i vitit 2016 deri në Gusht të vitit 2019 kostatohet se janë legalizuar gjithsej **2950 objekte**, nga këto në vitin 2016 janë legalizuar 296 objekte, në vitin 2017 janë legalizuar 894 objekte, në vitin 2018 janë legalizuar 1,315 objekte dhe në vitin 2019 janë legalizuar 445 objekte (shif tabelen si me poshtë)

Nr.	Viti i legalizimit	Nr i objekteve	
1	2016	296	
2	2017	894	
3	2018	1315	
4	2019 (deri në Gusht)	445	
Totali nga 2016 -2019			2950

Për periudhën e programit të auditimit për objektet e legalizuara nga viti 2016 deri në Gusht të vitit 2019 rezulton se janë 2,950 objekte të legalizuara në një periudhë 38 mujore, pra në muaj mesatarisht janë legalizuar 78 objekte, pra nga 17,625 objekte gjithsej janë legalizuar 2,950 objekte dhe ngelen për tu legalizuar dhe **14,675 objekte** (17,625-2,950), pra duhen edhe **16 vjet** për të mbaruar procesi i legalizimeve me rritmet e përmendura si më sipër.

Nga 2950 objekte të legalizuara nga viti 2016 deri në tetor të vitit 2019, janë pa likuiduar parcelat ndertimore 1,798 objekte, ose **61 përqind** e lejeve të legalizimit janë të pa përfunduara.

Gjithashtu kostatohet se sipas pasqyrave të paraqitura kostatohet se nga viti 2016 deri në gusht të vitit 2019 sipas raportimeve në ish/Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit Tiranë rezulton se në nxjerrjen e praktikave nga arkiva për dosjet në proces legalizimi për shqyrtim administrativ të procedurave të legalizimit rezultoi se:

Sipas Urdhërit Nr. 903, datë 10.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për përfundimin dhe pezullimin e procedrave administrative të legalizimit, të ndërtimeve pa leje dhe veprimtarisë administrative financiare të drejtorive të varësisë së ALUIZNI-t (ASHK Kavajë)", praktikat e dala për shqyrtim administrative për periudhën;

01.06.2016 deri me 31.12.2016

04.01.2017 deri më 31.12.2017,

04.01.2018 deri më 31.12.2018,

04.01.2019 deri më 31.05.2019.

Pasqyra e aktivitetit të punës se kryer nga viti 2016 deri në tetor 2019

NR	MUAJI	DALE NGA ARKIVA	EVIDENTIM NE TERREN	PLAN + GENPLAN	KUALIFIKUAR	KALUAR NE ZVRPP	LEJE TE PRINTUARA
1	Krr-16	0	50	40	106	-	3
2	Gsh-16	0	0	-	97	-	106
3	Sht-16	0	0	-	50	-	72
4	Tet-16	0	0	-	29	-	35
5	Nën-16	0	0	-	111	-	45
6	Dhj-16	0	0	-	31	-	34
7	Jan-17	0	0	-	15	-	29
8	Shk-17	0	0	-	63	-	56
9	Mar-17	0	0	-	106	-	69
10	Pri-17	0	170	200	175	145	183
11	Maj-17	0	170	175	122	93	132
12	Qer-17	0	170	75	34	175	45
13	Krr-17	0	170	-	78	-	57
14	Gsh-17	0	170	70	52	64	58



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

15	Sht-17	0	170	100	88	36	71
16	Tet-17	0	0	-	97	-	104
17	Nën-17	0	110	70	-	-	11
18	Dhj-17	117	110	110	99	101	79
19	Jan-18	182	0	65	27	87	54
20	Shk-18	148	100	85	72	20	43
21	Mar-18	190	120	120	113	35	114
22	Pri-18	105	170	120	113	35	123
23	Maj-18	296	170	130	130	23	128
24	Qer-18	162	0	-	128	-	117
25	Krr-18	121	170	140	152	150	127
26	Gsh-18	231	170	110	112	-	114
27	Sht-18	0	170	140	114	89	125
28	Tet-18	40	170	140	134	133	125
29	Nën-18	52	22	130	129	114	132
30	Dhj-18	92	170	120	89	69	113
31	Jan-19	82	46	55	54	-	58
32	Shk-19	321	170	137	120	-	81
33	Mar-19	525	170	-	110	-	117
34	Pri-19	10	0	-	34	-	68
35	Maj-19	24	0	-	6	-	7
36	Qer-19	39	180	-	46	10	24
37	Krr-19	54	150	106	40	44	43
38	Gsh-19	158	139	130	142	32	46
39	Sht-19	63	0	-	94	-	50
	Totali	3012	3577	2568	3312	1455	2998

Pra kostatohet se janë evidentuar dhe kryer veprimet matjet në terren nga viti 2016 deri në shtator 2019 gjithsej 3577 objekte dhe janë legalizuar 2950 objekte, pra me një diferencë dosjesh **627 dosje**, të cilat nuk janë ndjekur procedurat e legalizimit ,por janë rrikthyer përsëri në arkivin e institucionit.

Nga raportimet për këto dosje të nxjerra nga arshiva që janë janë raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Aluizni-t Tiranë, kanë përjashtuar nga procesi i legalizimit **18 objekte** ,kryesisht pranë shinave të trenit , por sipas informacioneve të marra, rezulton se janë **196 objekte** të cilat nuk plotesojnë kushtet për të vazhduar procesin e legalizimit të cilat janë ndërtuar pranë shinave të trenit ,pranë rruges nacionale ,zona turistike ,akrologjike (sipas Pasqyrës nr.1 bashkëlidhur Projektraportit.Objekte të cilat duhen skualifikuar nga procesi që ndodhen pranë vijës Hekurudhore

Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë nuk ka dokumentacion shkresor për shkualifikimin ose jo të **196 objekteve**, nga këto 22 subjekte janë në Rrogzhinë dhe 174 subjekte janë në zonën e Kavajës të ndërtuara në afersi të shinave të trenit, si dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e pushtetit vendor për këtë problem, këto veprime janë në kundërshtim me neni 38 "Dhënia e lejes së legalizimit" dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime (shif pasqyrën si më sipër).

Gjithashtu kostatojmë se në vitin 2019 janë gjendje në ish/Drejtorinë e Aluiznit Kavajë **150 leje** legalizimi të mbaruara dhe të printuara ,të cilat nuk kanë likujduar taksën e



iunfrastruktures (si më poshtë pasqyra) për të cilat duhet të njoftohen personat konkretë dhe Bashkia Kavaje e Rrogozhinë.

Pasqyra nr.2:Objekte që nuk kanë likujduar taksen e infrastruktures dhe lejet e legalizimit ndodhen gjendje në ish/Drejtorinë e Aluizni-t Kavajë.

Nga sa me sipër mbajnë përgjegjisi punonjstit e ish/Drejtorisë të ALUIZNI-t,”Agjensia Shtetore e Kadastrës (Drejtoria Vendore Kavajë) “ me ish /Drejtorin z.D.M. nga qershori 2016 deri ne dhjetor te vitit 2016,me ish/Drejtori z.Sh.D me detyrë ish/ Drejtor i Aluizni-t nga dhjetori 2016 deri në 04.05.2017, z.G.M. me detyrë ish/ Drejtor e Aluizni-t nga 24.11.2017 deri 29.01.2018, Y.N. me detyrë Drejtor i Kadastres Vendore Kavajë nga data 29.01.2018 e ne vazhdim, z.F.M. me detyrë ish Përgjegjes i legalizimit nga 01.05.2016 deri në 29.06.2018, z.L.K. nga viti 2016 me detyrë ish /Përgjegjës i legalizimit e në vazhdim,z.S.H. me detyrë Përgjegjës i Hortografise nga viti 2016 e në vazhdim.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI Kavajë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore përsa i përket respektimit të kriterëve ligjore për pajisjen me leje legalizimi, referuar: Neni 17 dhe 27 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 dhe neni 4, VKM nr. 465, datë 22.06.2016”, pika 10, VKM nr. 280, datë 01.04.2015, pika 8 dhe (i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016) kreu i I pika 1/4 dhe kreu 4, pika 8, VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 27, pika 3, VKM 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, pika 2, 3 dhe 10, VKM Nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit”, pika 2 dhe 5, Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e plan veprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6, ku ndër të tjera citohet:

*VKM Nr. 280, datë 01.04.2015“Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”,

pika 2 “ . Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme, germa “gj” Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

pika 8. Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

pika 8/1. Në vlerësimin e kriterëve për rrugët ekzistuese, verifikimi i trupit të rrugës kryhet mbi bazën e dokumentacionit të gjendjes faktike dhe të klasifikimit të rrugës, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ose nga autoriteti vendor i zhvillimit të territorit. Nëse nuk disponohet dokumentacion, konstatimi i trupit të rrugës bëhet sipas evidentimit faktik në terren, të kryer nga vetë drejtoria e ALUIZNI-t. Në kuadër të këtij vendimi, “qendra të banuara” konsiderohen zonat e urbanizuara (zonat e ndërtueshme), sipas vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të KKT-së.

*Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”



*VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –"c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se – "Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit", etj....

Në auditimin "**Mbi zbatimin e procedurave ligjore për legalizimin e ndërtimeve informale**" për periudhën **01.01.2016-31.08.2019**, nga subjekti Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë janë tërhequr listat e subjekteve me leje legalizimi këto lista janë ballafaquar me hartën vektor të azhurnuar me lejet në mënyrë grafike, me studimet infrastrukturore të ardhura nga Pushteti Vendor si dhe me:

- distancat e lejuara të rrugëve ekzistuese, të kategorive A e B, ose trupin e rrugëve ekzistuese, të kategorive C, D e E, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar dhe të akteve në zbatim të tij;
- brezin mbrojtës të vijës hekurudhore ekzistuese funksionale, të nivelit kombëtar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
- vijën kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike (institucione shtetërore, shkolla e kopshte publike, spitale, qendra shëndetësore publike, kampuse studentore);
- zonën e sigurisë së centraleve prodhuese të energjisë elektrike, nënstationeve elektrike ose shkel brezin mbrojtës të sistemit të linjave ekzistuese të interkonjeksionit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;
- zonën mbrojtëse të objekteve të trashëgimisë kulturore, të shpallura në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar;
- zonat dhe/ose nënzonave të mbrojtura, apo zonave të ruajtjes së veçantë, shkalla e mbrojtjes të së cilave nuk lejon ndërtime me funksion banimi apo social/ekonomik, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar;
- me territorin/vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave objekt kulturi, përveç rasteve kur posedues/ subjekt ndërtues është vetë institucioni fetar;
- me shtretërit e lumenjve ose brenda sipërfaqeve të baseneve dhe rezervuarëve, të mbrojtura sipas ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

Nga përzgjedhja referuar kushteve të mësipërme u tërhoqën nga arkiva e institucionit 647 dosje vetë deklarimesh të subjekteve të pajisur me leje legalizimi.

Nga auditimi janë konstatuar se në **147 dosje subjektesh vetëdeklarues u evidentuar 135 shkelje të kriterëve dhe kushteve tekniko-ligjore për lëshimin e lejes së legalizimit, por të cilat nuk çënojnë drejtpërdrejtë procesin e legalizimit të këtyre subjekteve.** Për më hollësisht sipas dosjeve e shkeljeve konkrete si më poshtë:

-Objekte të legalizuara ku kostatohen se janë dhënë në kundërshtim me ligjin për legalizimin si më poshtë :

1-Dosja me nr.2612 me procedues S. Q. dhe nr.2613 me procedues D.Q, me leje legalizimi nr 7002069 date 02.08.2016 dhe nr.7002053 datë 02.08.2016, ndërtese per aktivitet e firmosur nga F.M, ish/Përgjegjës i i Legalizimit, ish/ Përgjegjse e Hortografisë D.D.

Nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk është përshkruar dorzuesi dhe marrsi në dosje ndodhen më teper letra se në inventar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët A.K,L.K. dhe Hortografi D.D, nuk shënohen distancat nga rruga dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 20.07.2016.

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia Kavajë dhe Prefektura për të kthyer këtë zone infotmale arre ne trual, për ambientin e ndertuar nga proceduesi.

Nga informacioni i marë nga ZRPP –Kavajë rezulton se objekti i ndërtuar është tokë “arë” dhe figuron në distance 3 m nga rruga. Gjithashtu në distancën 2.6 m linear nga kanali dhe objekti i (S) dhe 4.5m (karer metro e 50 cm) linear kufizohet nga një kanal objekti i D, në dosje **nuk** ka informacion nga istucioni përkatës “Drejtoria e Ujrave”.

Pra rezulton se ky objekt cenon infrastrukturen pasi është ndërtuar buze kanalit dhe prane rrugës dytore (shif foton si më poshtë).

Pra kostatojme mos ndjekje procedurave ligjore, zgjatje procedurash,veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010 dhe në mospërputhje me ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”.



2-Dosja me nr.2141 procedues S.M, me leje legalizimi nr.7002559 datë 10.04.2017 e firmosur nga F.M, ish/Përgjegjës i i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk është përshkruar dorzuesi dhe marrsi ne dosje ndodhen më teper letra se në inventar.

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët E.B, Engjellushe Ndrecaj,dhe B.T, nuk shënohen distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 28.02.2017 dhe leja është dhënë mbas 2 muaj nga dalja e dosjes për pune .

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia Kavaje per ambientin e zaptuar nga proceduesi, nga shkresa me përgjigjen me nr.817/1 datë 15.03.2017 rezulton se kjo pasuri nuk është e regjistruar ,gjithashtu rezulton se ky objekt cenon infrastrukturen pasi është ndërtuar mbi tortuar (shif foton si më poshtë).



3-Dosja me nr.419 procedues B.A., me leje legalizimi nr.7008792 datë 27.12.2017 e firmosur nga ish /Drejtori G.M. dhe L.K ish/Përgjegjës i i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk është përshkruar dorzuesi dhe marrsi ne dosje jane 43 dokumenta ligjore ne fleten e inventarit eshte shenuar 40 fletë.

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët K.N,K.k., F.M., nuk shënohen distancat nga rruga dhe distanca nga kufitarët dhe emrat përkates , proces verbali është mbajtur në datën 12.11.2017

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia Kavajë per ambjentin e zaptuar nga proceduesi, sipas Vkm 293 ,datë 21.05.2018 ne nr rendor 508 rezulton se siperfaqja per kalim pronsie është 193 m² , ne lejen e legalizimit i eshte dhenë 218.² m², pra jane + **25 m²** me tepër nga VKM.

Nga dokumentacioni i paraqitur kostatohet se objekti cenon infrastrukturen pasi është ndërtuar mbi tortuar (shif foton si më poshtë).



4-Dosja me nr.2141 procedues S.Sh., me leje legalizimi nr.7002659 datë 25.04.2017 e firmosur nga L.K., ish/Përgjegjës i i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

sistemuar nuk është përshkruar dorzuesi dhe marrsi në dosje ndodhen më teper letra se në inventar.

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët E.B., E.N., dhe F. M., nuk shënohen distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 14.03.2017.

Është kërkuar informacion nga Bashkia Kavajë për ambjentin e zaptuar nga proceduesi, por nuk ka as një përgjigje, nga informacioni i marë nga ZRPP –Kavajë rezulton se objekti i ndërtuar është tokë shtet dhe figuron ne distance 3 m nga rruga. gjithashti në distancën 1 (një) m linar kufizohet nga një kanal, në dosje **nuk** ka informacion nga istucioni përkatës "Drejtoria e Ujrave

Pra rezulton se ky objekt cenon infrastrukturen pasi është ndërtuar buze kanalit dhe prane rrugës dytore (shif foton si më poshtë).

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010 dhe në mospërputhje me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje", Kreu III, pika 4, germa "dh" dhe Kreu II, pika 2, germa "gj".



5-Dosja me nr.16 me procedues E.P., me leje legalizimi nr.7002667 datë 26.04.2017 e firmosur nga L.K., ish/Përgjegjës i i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndërtuar është në distancën 0.5 m linar nga tortuari kur rruga është në gjersinë 8.3 m gjersi.

Në dokumentacionine paraqitur nga Zyra e Mbrojtjes Mjedisit të Tokës me nr 309 prot date 15.03.2017 e protokolluar ne Drejtorinë e Aluiznit me nr 733.ku thuhet se ky ambjent ka qënë dyqanet e ish/ kooperativave buqësore dhe kjo siperfaqe është shtet me siperfaqe 502m² dhe truall 107 m²(shif dokumentin e ZMM.Tokës).

Dokumenti i "fotokopjuar" ,në dosje nuk ndodhet statusi juridik,në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët L.K., M.D.,F.M, nuk shënohen distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 17.03.2017.

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia për ambjentin e zaptuar nga proceduesi, por nuk ka as një përgjigje, nga informacioni i marë nga ZVRPP –Kavajë.

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"



6.Dosja me 381 me procedues G.L., me lejë legalizimi nr.7006777 datë 21.12.2017 e firmosur nga ish /Drejtori G.M. dhe ish/Përgjegjës i Legalizimit L.K. , nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gjenplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndërtuar është në distancën 15 m litar nga rruga nacionale kuk ligji e jejon ndertimin mbi litar (shif foton) , në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialiste K.N.,K.K. F.M., nuk shënohen sakt distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 14.11.2017..

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’, të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.



7.Dosja me 1561 me procedues P.S., me lejë legalizimi nr.7006829 datë 15.01.2018 e firmosur nga ish /Drejtori G.M. dhe ish/Përgjegjës i Legalizimit L.K., nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gjenplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndërtuar është në distancën 1.9 m litar nga rruga në njërin krah dhe ne krahun tjetër nuk distance te shenuar,sipas informacionit nga ZVRPP ky objekt eshte ndertuar ne prone shtet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet K.N.,M.D dhe F.M., nuk shënohen sakt distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 14.11.2017.

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.

8.Dosja me 390 me procedues E.B., me leje legalizimi nr.7006835 datë 18.01.2018 e firmosur nga ish /Drejtori G.M. dhe ish/Përgjegjës i Legalizimit L.K., nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndërtuar është në distancën 1.5 m linar nga rruga ne njerin krah dhe ne krahun tjetër nuk distance të shenuar,sipas informacionit nga ZVRPP ky objekt është ndërtuar në prone te pa rregjistruar . Nuk ka sa nje dokument nga Bashkia për zaptimin e ketij trualli.

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet K.N., M.D.dhe F. M., nuk shënohen sakt distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 14.11.2017.

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.



9-Dosja me nr.08 me procedues M. A. Sh.p.k, me leje legalizimi nr.7002672 datë 28.04.2017 e firmosur nga L.K., ish/Përgjegjës i i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndërtuar është në distancën 0.9 m linar nga mbi tortuari kur rruga është në gjersinë 7.3 m gjersi.

Në dokumentacionine paraqitur nga ZVRPP-Kavaje rezulton se kjo pronë është e regjistruar ne emer te **M.A., Sh.p.k**, pot nuk ka ruajtur distancën nga rruga .

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët **L.K., K.K.,F.M.**, nuk shënohen distancat nga rruga nacionale dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 14.03.2017.

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia për ambientin e ndertuar nga proceduesi.

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, të ndryshuar,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010 .

10 - Dosja me nr.1924 me procedues E.T., me leje legalizimi nr.7006915 datë 26.02.2018 e firmosur nga L.K. ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti i ndertuar ne distancen nga nga rruha 0.4 m(shif foton)



Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët M.D., A.D, nuk shënohen distancat nga rruga dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 19.12.2017, gjithashtu nuk është përshkruar saktë dhe nga hortografi F.M..

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia për ambientin e ndërtuar nga proceduesi.

11 - **Dosja me nr.(pa numer) me procedues G. T.**, me leje legalizimi nr.7002079 datë 02.08.2016 e firmosur nga F.M, ish/Përgjegjës i i Legalizimit, ish/ Përgjegjese e Hortografisë D.D.

Nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk është përshkruar dorzuesi dhe marrsi në dosje ndodhen më teper letra se në inventar.

Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistët A.K.,L.K. dhe Hortografi D.D, nuk shënohen distancat nga rruga dhe distanca nga kufitarët e mbajtur në datën 27.06.2016 .

Nga gent plani i paraqitur tregon se ne objektin e ndertuar ka ndertuar dhe nje objekt tjeter prane fushes se shkolles .

Në dosje nuk ka as një dokument mbi ndertimin e ketij objekti , nuk ka as nje shkresë nga istucioni përkaates ,nese ky objekt është ndërtuar në fusha e shkolles ,apo ne pronen e vet.

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010 .



12 - Dosja me nr.1540 me procedues Xh.C., me leje legalizimi nr.7002211 datë 31.08.2016 e firmosur nga F.M., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi (shif foton).



Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialisti i "Vetem" A.K., nuk shënohen distancat nga rruga dhe distanca nga kufitarët e largësia nga kanali etj, mbajtur në datën 20.07.2016, gjithashtu nuk është përshkruar saktë dhe nga hortografi D.D..

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia për ambientin e ndërtuar nga proceduesi.

13 - Dosja me nr.6 me procedues B.S , me leje legalizimi nr.7002142 datë 17.09.2016 e firmosur nga F.M, ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në ndërtim,ku kati i dyte eshte pa solete, nga A. K., L.K. dhe Hotografi D.D. (shif foton)



Në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj, mbajtur në datën 25.07.2016, gjithashtu nuk është përshkruar saktë dhe nga hortografi D.D.

Nuk është kërkuar informacion nga Bashkia për ambientin e ndërtuar nga dhe dokumentacion per vazhdimin e ndertimit.

14 - Dosja me nr.201/1 me procedues I.R., me leje legalizimi nr.7002064 datë 02.08.2016 e firmosur nga F.M., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij me fushen e sportit te shkollës dhe në krahun tjerër Komiteti



Mysliman. Në dosje nuk ka as një dokument nga istucionet përkatse, proces verbali është mbajtur në datën 20.07.2016, nga A.K., L.K. dhe Hotografi D.D., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj

15 - Dosja me nr.1427 me procedues A.Xh., me leje legalizimi nr.7002051 datë 02.08.2016 e firmosur nga F.M., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në tok "Pemtore" në sipërfaqen 122 m². Proces verbali është mbajtur në datën 30.05.2016, nga A.K., L.K. dhe Hotografi D., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia, etj.

16 - Dosja me nr.2118 me procedues Sh.R., me leje legalizimi nr.7002177 datë 22.09.2016 e firmosur nga F.M., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij të afert me Kanalin vadites 0.5 m linear. Proces verbali është mbajtur në datën 27.07.2016, nga k.N., E.N. dhe Hotografi D.D., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj .

17 - Dosja me nr.2070 me procedues M.C., me leje legalizimi nr.7002072 datë 02.08.2016 e firmosur nga F.M., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij të afert me rrugën, prona e proceduesit është "Arre" 358 m² . Në dosje nuk ka dokument nga istucionet përkatse, proces verbali është mbajtur në datën 19.07.2016, nga E.b., K.N. dhe Hotografi D.D., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj

18 - Dosja me nr.6604 me procedues E.H., me leje legalizimi nr.7002622 datë 24.04.2017 e firmosur nga L.K., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti është prona e proceduesit është "Arre" 433 m² . Në dosje nuk ka dokument nga istucionet përkatse, proces verbali është mbajtur në datën 14.03.2017 nga L.K., M.D. dhe Hotografi F.M., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.

19 - Dosja me nr.45 me procedues H.K., me leje legalizimi nr.7006836 datë 19.01.2018 e firmosur nga ish/Drejtori G.M. dhe L.K., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gëntplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij të afert me autostradën në distance 15.4 m linear nga objekti . Në dosje nuk ndodhen dokument tjetër nga istucioni përkatës. Vendimi me nr 1560 datë 19.01.2018 firmosur "në mungesë" nga L.K. dhe Drejtori G.M..

Në proces verbali është mbajtur në datën 13.12.2017, nga A.D. "Vetëm" dhe i pa firmosur nga Hotografi , në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj



Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.

20 - Dosja me nr.45 me procedues H.L., me leje legalizimi nr.7006819 datë 08.01.2018 e firmosur nga Drejtori G.M. dhe L.K., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij të afërt me autostradën në distance 19.5 m linar nga objekti . Në dosje nuk ndodhen dokument tjetër nga istucioni përkatës.

Në proces verbalit është mbajtur në datën 15.11.2017, nga M.D., A, D,dhe nga Hotografi F.M., në përpilimin e proces verbalit të verifikimit në teren nuk janë shënuar të dhënat sipas formatit të duhur nga specialistet e terrenit, nuk shënohen distanca nga kufitarët e largësia etj. Ne dosje nuk është statusi juridik i objektit "E Hotel" është leja nendertimit

Veprimet e kryera janë në mospërputhje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27 dhe VKM.Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.

21 - Dosja me nr.448 me procedues N,A., me leje legalizimi nr.7006852 datë 26.01.2018 e firmosur nga Drejtori G,M, dhe L.K., ish/Përgjegjës i Legalizimit, nga auditimi kostatohet se dosja është e pa sistemuar nuk përshkruhet dorzuesi dhe marrësi, në gentplanin e paraqitur kostatohet se objekti është në kufij te afert me kanaln 260 cm ,pra nuk ka as nje shkrese nga istucioni perkatës mbi katigordine e këtij kanali .



Në procesverbalin e mbajtur në datën 12.12.2017, nga specialistet e terrenit është pershkuar sakt distanca nga kanali dhe është firmosur nga Hotografi F.M..

Veprimet e kryera janë në mospërputhje me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje", Kreu III, pika 4, germa "dh" dhe Kreu II, pika 2, germa "gj", i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) dhe VKM .Nr.267, datë 21.4.2010.

Pra sa me sipër në Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Kavajë"Agjensia Shtetërore e Kadastrës" me veprime e mos veprime bien në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar dhe mbajnë përgjegjësi, ish/Drejtori z.Sh.D. me detyrë ish/ Drejtor i Aluizni-t nga Dhjetori 2016 deri në 04.05.2017, z.G.M.me detyrë ish/ Drejtor e Aluizni-t nga 24.11.2017 deri 29.01.2019, z.F. M me detyrë ish Përgjegjes i legalizimit nga 01.05.2016 deri në 29.06.2018, z.L.K. nga viti 2016 me detyrë ish /Përgjegjës i legalizimit e në vazhdim,z.S.H.me detyrë Përgjegjës i Hartografisë nga viti 2016 e në vazhdim, z. A.K. specialist terreni,z. D.D. Hortograf,z. M.D.specialist terreni,zj.E.B. specialist terreni,z. E.N.specialist terreni,z. K.K,specialist terreni,z.K.K.specialist terreni,z. B.T.specialist terreni,z. A.D.specialist terreni.



Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3, datë 08.11.2019

Nga shqyrtimi me vemendje i observacioneve me nr. 6103 date 12.11.2019 deri në nr.6103/10 të paraqitura nga punonjësit specialistët verifikues të terrenit dhe hartograf etj. konstatohet se pretendohet në mënyrë individuale se sipas funksioneve i ka plotësuar kërkesat dhe nuk e lidh punën e tij me grupin e caktuar për kompletimin dokumentar e ligjor të dosjes për legalizim. Mos harmonizimi i detyrave me gjithsecilin pjestar të grupit të punës, ka bërë që të mos vlersohet në se, objekti i plotëson kushtet për legalizim në përputhje me kuadrin ligjor por procesverbalet e plotesimit të kushteve firmosen apriori. Për rrjedhojë janë marrë vendime dhe bëhen legalizime me të meta e mangësi. Në këtë kuptim cdo njeri prej punonjësve duhet të siguroje se dosja është plotësuar saktësisht nga i gjithë grupi i punës, prandaj përgjegjësia është aq sa personale aq dhe e përbashket, gjithashtu theksojme se në argumentat që ju keni paraqitur nuk janë argumentus dhe ligjore nga istucionet përkatës.

1/1-“Mbi zbatimin e procedurave ligjore për legalizimin e ndërtimeve informale” për periudhën 01.01.2016-05.11.2019.

- **Dosja nr. 1227 datë 31.08.2006**, leje legalizimi nr. 7010051, datë 31.12.2018, për objektin ndërtim për aktivitet 1 kat, me pronar i ndërtimit pa leje: F.Sh.R., N.Sh, G.R.i dhe D.R., të cilët janë trashëgimtarë sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr.1602 Rep. 854 Kol, me adresë Lagja Nr.3 Kavajë. Objekti ka sipërfaqe të parcelës ndërtimore 181.6 m², sipërfaqe ndërtimit 45.1 m², trualli sipas statusit juridik të konfirmuar nga ZVRPP Kavajë si dhe pjesërisht do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës”. procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pika 1, “c” ku përcaktohet: –“për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se – “Drejtoria e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit”.

- Në dosje gjendet procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 14.12.2018, firmosur nga specialistët M.D. dhe A.D. nga ku rezulton me këto mangësi:

-Nuk është plotësuar rubrika për qellimin e shfrytëzimit të objektit duke specifikuar në se është për banim apo aktivitet ekonomik.

-Nuk është plotësuar rubrika për pasuritë kufitare të saktësuara me përshkrim në metra dhe me fjalë.

-Nuk është firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes.

Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët A.D.dhe K.N., përgjegjësi i sektorit të legalizimit L.K. përgjegjësi i sektorit të kualifikimit.

Shqyrtuam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësi A.D., për pretendimin e tij se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Lidhur me këtë,grupi i auditimit veç të tjerash, kemi konstatuar mangësinë e rubrikës për mos përshkrimin me fjalë të distancave.



Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim nuk është kryer. Në keto rrethana observacionin nuk mund ta marrim në konsideratë.

- **Dosja** me vet deklarin nr. 5005 prot datë 19.01.2015, leje legalizimi nr. 7010230, datë 19.03.2019, për objektin dërtim për aktivitet ekonomik 1 Kat, me pronar i ndërtimit pa leje: qytetarin Besim Shefik Hallulli pais me prokurë ligjore nr. 144 Rep. 95 Kol, me adresë fshati Synej Kavajë, zk 2962 për kryerje veprime mbi pasuria 190/1/3 sipërfaqe e parcelës ndërtimore 151.8 m², sipërfaqe e ndërtimit 50 m², trualli sipas statusit juridik të konfirmuar nga ZVRPP Kavajë por që do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" – "vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës". procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pika 1, "c" si dhe pika 2.

-Në dosje gjendet dokumenti procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 15.02.2019, firmosur nga specialistët E.B. dhe E.N., si dhe specialisti i hartografisë S.H. Nga auditimi rezulton se:

-Eshtë plotësuar rubrika për qellimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për aktivitet ekonomik.

-Janë plotësuar rubrika për pasuritë kufitare por janë të pa saktësuara me distanca dhe me përshkrim fjalë.

-Eshtë firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes,

-Në gent planin e hartuar nuk shënohet distanca që kufizohet me rrugën ne jug të objektit.

-Në përgjigjen e ZQVRPP datë 25.02.2019, mbi kërkesën e ZVRPP Kavaje nr. 681, prot datë 15.02.2019 për statusin juridik të objektit informal të qytetarit B.H. thuhet se objekti ndodhet ne pasurinë nr. 106/21 vol 4 faqe 69 me sipërfaqe 164000 m2 ne pronësi "shtet" si dhe ne seksionin D të kartelës me shkresë 0059 datë 28.10.2008 është lidhur kontratë koncesionare me shoqërinë "Agrotal".

Leja legalizimi nr. 7010230, datë 19.03.2019, për objektin ndërtim për aktivitet ekonomik 1 Kat, me pronar i ndërtimit pa leje është lëshuar për qytetarin B.H. Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët E.B. dhe znj.E. N.

Shqyrtuar me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Lidhur me këtë, vec të tjerash kemi konstatuar mangësinë e rubrikës për mos përshkrimin me fjalë të distancave. Në dokumentet e audituara dhe ato bashkëlidhur observacionit ka rezultuar se ky veprim nuk është kryer. Në keto rrethana observacionin nuk mund ta marrim në konsideratë.

- **Dosja** nr. sipas vet deklarin nr. 490 datë 20.06.2006 për leje legalizimi nr. 7010109, datë 31.01.2019, ndërtim 2 kat nga i cili për banim 49.9 m² dhe aktivitet ekonomik 36.5 m² me pronar i ndërtimit pa leje: N.B. me adresë Lagja nr. 3 Bashkia Kavajë zk 8552, pasuria 3/190 sipërfaqe e parcelës ndërtimore 98.9 m², sipërfaqe e ndërtimit 36.5 m², trualli sipas statusit juridik shtet të konfirmuar nga ZVRPP Kavajë, do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç", procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pika 1, "c" si dhe pika 2..



-Në dosje gjendet dokumenti procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 15.02.2019, firmosur nga specialistët M.D. dhe E.B. dhe specialisti i hartografisë K.N. Nga auditimi rezulton se:

-Eshhtë plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për banim dhe për aktivitet ekonomik.

-Janë plotësuar rubrika për pasuritë kufitare të pa saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

-Ëshhtë firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes,

-Në përgjigjen e ZQVRPP datë 19.02.2018, mbi kërkesën e Aluiznit Kavaje nr.3769, prot datë 31.10.2018 për statusin juridik të objektit informal të qytetarit N.L. sipas kartelës së pasurisë palujtëshme thuhet se objekti ndodhet në pasurinë nr. 3/174 vol 13 faqe 148 me sipërfaqe 101.50 m2 ne pronësi "R.B. dhe N.B." si dhe ne seksionin përshkrimi i vecantë është shënuar se për këtë pasuri ka rekurs në gjykatën e lartë sipas shkresës nr. 760/15datë 10.01.2017 kundër vendimit gjyqsor 3997dt 23.12.2016. Kartela është firmosur nga ish regjistruesi A.C..

Shqyrtoam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në keto rrethana observacioni e marrim në konsideratë.

Përsa i përket pretendimit të Znj E.B. se nuk mban përgjegjësi për rrethanat se dosja është në gjykatë, pretendimi është i drejte dhe për këtë rrethane asaj nuk do i kërkohet përgjegjësi nga ana jonë.

- **Dosja nr.1151** sipas vet deklarimit datë 24.10.2014, leje legalizimi nr. 7009554, datë 20.09.2018, ndërtim 1 kat për aktivitet ekonomik sipërfaqe 98 m2, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 98.5 m2 me pronar i ndërtimit pa leje: A. Gj., me adresë Njësia Administrative G zk 2140, pasuria nr. 212/99/1, trualli sipas statusit juridik "shtet" të konfirmuar nga ZVRPP Kavajë, por që do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç", procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pika 1, "c", si dhe pika 2.

- Në dosje gjendet dokumenti procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 15.08.2019, firmosur nga specialistët M.D. dhe A.D dhe specialisti i hartografisë K. T, ku rezulton se:

-Eshhtë plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për banim dhe për aktivitet ekonomik.

-Janë plotësuar rubrika për pasuritë kufitare të pa saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

-Objekti është deklaruar për qëllim banimi ndërsa në lejen e lgalizimit është shënuar për aktivitetet ekonomik.

-Ëshhtë firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes,

-Sipas gent planit bashkëlidhur procesverbalit të verifikimit në terren si dhe fotove që gjenden në dosje rezulton se pasuria bie mbi trotuar.

-Në përgjigjen e ZVRPP nr. 5633 datë 31.08.2018, mbi kërkesën e Aluiznit Kavaje nr.2654, prot datë 16.08.2018 për statusin juridik të objektit informal të qytetarit A.Gj. sipas kartelës së pasurisë palujtëshme thuhet se objekti ndodhet në pasurinë nr. 212/99 vol 9 faqe 91 me sipërfaqe 91.00 m2 ne pronësi "shtet"



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Objekti është vënë në ipotekë ligjore me kufizim.

- **Dosja** nr.484/12 sipas vet deklarimit datë 09.03.2005, leje legalizimi nr. 7009867, datë 21.11.2018, objekti ndërtim 2 kat për aktivitet ekonomik me sipërfaqe 214.2 m², sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m² me pronar të ndërtimit pa leje: B.L. me adresë Njësia Administrative G zk 3774, pasuria nr. 99/1/1, trualli sipas statusit juridik të pa përcaktur nga ZVRPP Kavajë, por që do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç", procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pika 1, "c", si dhe pika 2.

- Në dosje gjendet dokumenti procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 15.08.2019, firmosur nga specialistët A.K., E.N. dhe specialisti i hartografisë K.T., ku rezultojn se:

-Në procesverbalin e verifikimit nuk është plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për banim dhe për aktivitet ekonomik.

-Janë plotësuar rubrikat për pasuritë kufitare të pa saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë

-Është firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes,

-Në përgjigjen e ZVRPP nr. 5623/1 datë 31.08.2018, mbi kërkesën e Aluiznit Kavajë nr.2664, prot datë 16.08.2018 për statusin juridik të objektit informal të qytetarit B.Q. sipas kartelës së pasurisë palujtëshme thuhet se objekti ndodhet në pasurinë nr.99/1/1, trualli sipas statusit juridik të pa përcaktur nga ZVRPP Kavajë cilësohet se HTRP e Aluiznit nuk është me të njetat kushte të HTP që punon ZVRPP, por që do të miratohet me VKM.

Shqyrtuar me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur , për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim është kryer. Në keto rrethana observacionin do ta marrim në konsideratë.

- **Dosja** nr.1561 sipas vet deklarimit datë 01.09.2006, leje legalizimi nr. 7009794, datë 31.10.2018, për objektin ndërtim 2 kat për aktivitet ekonomik sipërfaqe 747.42 m², me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², me pronar i ndërtimit pa leje: H.D. me adresë Njësia Administrative Golem zk 229, pasuria nr.322/20/1, trualli sipas statusit juridik të pa përcaktur nga ZVRPP Kavajë, por që do të miratohet me VKM.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç", procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pika 1, "c", si dhe pika 2.

-Në dosje gjendet dokumenti procesverbali i verifikimit në terren i mbajtur me datë 12.07.2018, firmosur nga specialistët A.K., E.B dhe specialisti i hartografisë K.T. Nga auditimi rezultojn se:

-Në procesverbalin e verifikimit nuk është plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për banim dhe për aktivitet ekonomik.

-Janë plotësuar rubrikat për pasuritë kufitare të pa saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

-Procesverbali është firmosur nga specialisti i hartografisë K.T..

-Në dosje mungon procesverbali i vlersimit të dosjes,



Dosja nr. 49, datë 21.03.2017, leje legalizimi nr. 7010124 datë 31.01.2019, ndërtim për aktivitet social ekonomik, pronar i ndërtimit pa leje: Th.S, me adresë Njësia Administrative Golem, ZK 2291, për objektin me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 265.9 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 313/33, vol 12 faqe 42, e konfirmuar nga ZVRPP.

- Në dosje administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit të pronarëve veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç", si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c, si dhe pika 2.

- Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 2490 prot. datë 06.08.2018, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë nr.313/32 zk 2291 vol 12 faqe 41.

Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B.dhe E. N. ku;

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 06.08.2018, firmosur nga ish-specialistët e verifikimit në terren z. E.B. dhe E.N. është pa miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë.

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, e konfirmuar për statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë buqësore në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët E.B. dhe A.K.pasi është pa miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë, përgjegjësi i sektorit të hartografisë K.T.

Shqyrtuam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e ripërsëritur prej tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim është kryer. Në keto rrethana observacioni mund ta marrim pjeserisht në konsideratë.

Dosja nr. 953 datë 16.10.2014, leje legalizimi nr. 7010218 datë 01.03.2019, ndërtim për aktivitet social ekonomik , pronar i ndërtimit pa leje: P.H. me adresë fshati Spille, Njësia Administrative Kryevidh, ZK 35.01, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 17.5 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 47/52/1 vol 13 faqe 21 e konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 750 prot. datë 22.02.2019 drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë nr. 47/52 vol 13 faqe 21 pronësi shtet blerje nga z P.H. , 47/53 vol 13 faqe 22, 47/14 vol 9 faqe 2, zk 3501.

Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga ku,

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 22.02.2019, firmosur nga ish-specialistët e verifikimit në terren z. A.D. dhe K.N.. Sipas gent planit bashkëlidhur rezultojnë se objekti është mbuluar me llamarinë

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, ku sipas konfirmimit për statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë buqësore në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. *Vendimi nr 3045 datë 28.02.2018, sipas formularit të kualifikimit e ndërtimit informal është i pa firmosur nga verifikuesi i plotësimit të kushteve K.K.*



Shqyrtoam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim është kryer jo i plotë. Në keto rrethana observacioni do ta marrim pjeserisht në konsideratë.

- **Dosja nr. 292/1, datë 13.11.2003**, leje legalizimi nr. 7010336 datë 07.04.2019, ndërtim për aktivitet social ekonomik ,pronar i ndërtimit pa leje: A.L. me adresë Njësia Admisatrive H., ZK 3427, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 579.2 m², sipërfaqe e ndërtimit 579.2 m², trualli i pa konfirmuar nga ZVRPP Kavajë.

- Në dosje administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit të pronarëve.

- Në dosje nuk administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 965 prot. datë 07.03.2019 drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në bllokun kadastral nr.115, 126 zk 34257(administruar me observacionin).

Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët A.D. dhe M.D. nga ku,

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 07.03.2019, firmosur nga ish-specialistët e verifikimit në terren z. A.D.e M. D. si dhe është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë S.H.. Të dhënat sipas gent planit bashkëlidhur rezultojn se në procesverbalin e verifikimit nuk janë plotësuar rubrikat për pasuritë kufitare të saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

Shqyrtoam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim është kryer. Në keto rrethana observacioni do ta marrim në konsideratë.

Dosja nr. 3465 datë 30.12.2014, leje legalizimi nr. 7008083 datë 21.05.2018, ndërtim për aktivitet social ekonomik , pronar i ndërtimit pa leje: E.C. me adresë Njësia Admisatrive Luz i Vogël, ZK 3817, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 483.7 m², sipërfaqe e ndërtimit 483.7 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 136/36/1 vol 9 faqe 159 konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për fondin e kompensimit të pronarëve.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 144 prot. datë 06.03.2019 drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë E.C. zk 3817. ZVRPP Kavajë me shkresë nr. 1131/1,datë 12.03.2018 ka konfirmuar se pasuria nr. 136, vol 9, faqe 159 e llojit truall me sipërfaqe 800 m2 paraqitet me pronësi shtet.

Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B. dhe E. N, nga ku,

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 06.03.2019, firmosur nga ish-specialistët e verifikimit në terren z. E.B. dhe E.N. është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë F.M.. Sipas gent planit bashkëlidhur rezultojn se objekti Të dhënat sipas gent planit bashkëlidhur rezultojn se në procesverbalin e verifikimit nuk janë plotësuar fare rubrikat për pasuritë kufitare të saktësuara me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët E.B. dhe E. N., përgjegjësi i Sektorit të hartografisë F.M.

Shqyrtoam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara dhe ato bashkëlidhur observacionit ka rezultuar se ky veprim është kryer. Kur punohet në grup, dokumentacioni firmoset nga i gjithë grupi, pasi veprimet kanë lidhje me detyrat e njeri tjetrit dhe vetëm atëherë dokumentacioni bëhet i vlefshëm e ligjor.



Dosja nr.139/1, datë 10.03.2005, leje legalizimi nr. 7009301 datë 23.07.01.2018, ndërtim për aktivitet social ekonomik, pronar i ndërtimit pa leje: T.H. , me adresë Njësia Administrative Lekaj, ZK 2399, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 223.4 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 141/34 vol 14 faqe 121 konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për **fondin e kompensimit të pronarëve**.

- Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 1148 prot. datë 25.05.2018, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë nr. 141/34,vol 14 faqe 121, zk 2399, zeri kadastral tokë arë me sipërfaqe 1235 m².

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë buqësore në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët M.D.dhe A.D. nga ku:

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 25.05.2018, firmosur nga specialistët e verifikimit në terren z. M.D dhe A.D është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë K.T.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët M>D, përgjegjësi i Sektorit të hartografisë K.T.

Dosja nr. 277, datë 22.02.2005, leje legalizimi nr.7012176 datë 22.09.2016, për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje: I.B , me adresë Njësia Administrative Golem, ZK 2291, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 406 m², sipërfaqe e ndërtimit 280.9 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 323/3 vol 3 faqe 21 konfirmuar nga ZVRPP.

- Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 669 prot. datë 9.08.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në Zk 2291 , zeri kadastral ullishte me sipërfaqe 3100 m².

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri,duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga ullishte në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët A.K dhe D.D hartograf nga ku:

- Skica fushore dhe procesverbalit të verifikimit në terren datë 24.06.2016, firmosur vetëm nga specialisti verifikimit në terren z.A.K nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë D.D.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Shqyrtuar me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur , për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim është kryer. Në keto rrethana observacioni mund ta marrim pjesërisht në konsideratë.

Dosja nr.1595, datë 04.09.2006, leje legalizimi nr.7002163 datë 20.09.2016,për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje: R.A, me adresë Njësia Administrative



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Golem, ZK 2291, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 490 m², sipërfaqe e ndërtimit 350.3 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 134/3 vol 6 faqe 54 konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 856 prot. datë 06.09.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në Zk 2291, zeri kadastral e llojit arë me sipërfaqe 1780 m².

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë arë në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B dhe K.N, nga ku:

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 25.07.2016, firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. E.B dhe K.N dhe është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë D.D.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Dosja nr. 1469 datë 29.08.2006, leje legalizimi nr.702154 datë 19.09.2016, për ndërtim për banim 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: M.S me adresë Njësia Administrative Golem, ZK 2291, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 168.1 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 6/20, vol 7 faqe 49 me sipërfaqe 300 m² e llojit ullishte, pasuria 6/21, vol 7 faqe 48 sipërfaqe 300 m² e llojit ullishte, konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 621 prot. datë 4.08.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në Zk 2291, zeri kadastral ullishte.

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga ullishte në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët A.K dhe L.K hartografi D.D nga ku:

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 24.06.2016, firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. A.K është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë D.D.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

- Nga pamjet në ortofoto konstatohet se objekti është pranë zonës rezidenciale dhe në dosje nuk ka shkresë të dërguar institucionit përkatës për konfirmimin e distancave të lejueshme

Shqyrtoam me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësit e lartpërmendur për pretendimin e tyre se distancat nga objektet kufitare janë shënuar. Në dokumentet e audituara ka rezultuar se ky veprim nuk është kryer.

Dosja nr. 381 datë 25.03.2005, leje legalizimi nr.7010327 datë 28.03.2019, për objektin ndërtim për banim 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: A.S, me adresë Bashkia Kavajë lagja nr 6, ZK 8552, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 339 m², sipërfaqe e ndërtimit 113 m², trualli pa konfirmuar nga ZVRPP për mungesë informacioni.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 2253 prot. datë 29.09.2017, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 10/2 dhe 12 që ndodhn në Zk 8552, ku për zeri kadastral nuk ka informacion.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke mos patur informacion për statusin e pronës. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 280 datë 01.04.2015 pika 9 e tij citohest se :

Në rast mosplotësimi, nga subjekti poseduesi ndërtimit informal, të dokumentacionit që duhet të dorëzohet prej tij, brenda 6 muajsh nga njoftimi zyrtar i ALUIZNI-t, ky i fundit informon Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për të vepruar, sipas legjislacionit përkatës.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B dhe A.D hartografi S.H nga ku:

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 18.03.2019, është firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. E.B dhe A.D është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë S.H.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Dosja nr. 1467, datë 29.08.2006, leje legalizimi nr.7002152 datë 29.09.2016, për ndërtim për banim 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: Xh.S, me adresë Kryemëdhënë, ZK 2291, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 146.7 m², sipërfaqe e ndërtimit 146.7 m², trualli ullahte konfirmuar nga ZVRPP.

- Në vet deklarin datë 29.08.2006 e qytetarit Xh.S cilësohet se objekti ndërtimit është godine njëkatëshe e dokumentuar edhe me ortofotot në dosje. Nga Aluizmi Kavaje dosja me dokumentacionin për legalizimin e objektit bën fjalë për objekt me dy kate si dhe leja është plotësuar me legalizim të objektit me dy kate. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin 9482, datë 3.04.2006, neni 27.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 584 prot. datë 28.07.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 6/27 vol 7 faqe 42 ndodhur në Zk 2291, për zerin kadastral ullahte me sipërfaqe 500 m².

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B dhe A.D hartografi D.D nga ku:

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 11.07.2006, është firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. E.B, dhe K.N nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufiarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Në dosje nuk gjendet shkresa e Bashkisë për pagesën e taksës së infrastrukturës.

- Nga pamjet në ortofoto konstatohet se objekti është në zonë turistike dhe në dosje nuk ka shkresë të dërguar institucionit përkatës për konfirmimin e distancave të lejueshme për legalizim.

Dosja nr. 1372, datë 21.08.2006, leje legalizimi nr.7002134 datë 16.09.2016, për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje: F.D, me adresë Njësia Administrative Golem, ZK 2291, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 440 m², me sipërfaqe e ndërtimit 140.1 m², trualli vreshte pa konfirmuar nga ZVRPP.

-Në vet deklarin datë 21.08.2006 e qytetares flora Q.D cilësohet se objekti ndërtimit është gadine njëkatëshe e dokumentuar edhe me ortofotot në dosje. Nga Aluizmi Kavaje dosja me dokumentacionin për legalizimin e objektit bën fjalë për objekt me dy kate si dhe leja është plotësuar me legalizim të objektit me dy kate

- Në dosje nuk administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 625 prot. datë 04.08.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 187/162 vol 25 faqe 187 ndodhur në Zk 2291, për zerin kadastral vreshtë me sipërfaqe 634 m².

-Me mangësi është plotësuar procesverbali datë 05.08.2016 për verifikimin në terren nga speciaslistët A.K dhe hartografi D.D nga ku mungojnë të gjitha të dhënat sipas rubrikave të formatit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 05.08.2016, është firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. A.K nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë. Distanca nga kufitari në veri të objektit përshkruhet 2 m dhe në jug 2.30 m dhe në dosje nuk ka asnjë deklaratë noterile me kufitarët.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Në dosje nuk gjendet shkresa e Bashkisë për pagesën e taksës së infrastrukturës.

Dosja nr. 573 datë 3.10.2014 është dhënë leje legalizimi nr.7002151 datë 13.09.2016, për objektin ndërtim për banim 4 kat, pronar i ndërtimit pa leje: R.M, me adresë Njësia Administrative Golem, ZK 2291, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 310 m², sipërfaqe e ndërtimit 140.7 m², sipërfaqe totale për banim 922 m², trualli arë konfirmuar nga ZVRPP.

-Në vet deklarin datë 03.10.2014 e qytetarit R.M i cilësohet se objekti ndërtimit është godine 4 katëshe. Aluizmi Kavaje me dokumentacionin për legalizimin e objektit bën fjalë për objekt me 4 kate nga të cilët 1 kat i nëndheshëm me sipërfaqe gjithsejt 922 m².

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 526 prot. datë 20.07.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 185/34 vol 34 faqe 59 ndodhur në Zk 2291, për zerin kadastral e llojit arë me sipërfaqe 400 në pronësi të z R.M.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët E.B dhe K.N dhe hartografi D.D nga ku:

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 11.07.2006, është firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. E.B, dhe K.N nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

Në dosje nuk gjendet shkresa e Bashkisë për pagesën e taksës së infrastrukturës.

Për sa sipër leja e legalizimit nuk duhet të jepej dhe për këtë mbajnë përgjegjësi specialistët E.B, K.N verifikuesi i kushteve të legalizimit G.T.

Dosjet nr. 6274, 6290, 6291, datë 31.01.2015, leje legalizimi nr.7002113, nr.7002114, nr. 7002115 datë 25.08.2016, për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje: për tre objekte nga B.S me adresë Njësia Administrative Luz i Vogël ZK 3817, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 345 m², sipërfaqe e ndërtimit 115.1 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 20/29,,nr 29/30, nr.29/31 vol 14 faqe 227,228,229 me sipërfaqe 1700 m² e llojit arë, konfirmuar nga ZVRPP.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 740 prot. datë 19.08.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në Zk 3817, zeri kadastral arë.

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga arë në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren nga speciaslistët A.K dhe L.K hartografi D.D nga ku:

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 24.06.2016, firmosur nga specialisti verifikimit në terren z. K.N është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë D.D.

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

-Në procesverbalin e vlersimit të dosjes së legalizimit mbajtur me datë 20.07.2006 dhe firmosur nga sektori i legalizimit F.M, B.Y dhe përgjegjësi i sektorit të përpunimit të dhënave D.D cilësohet se subjekti në dy raste ka më shumë se një ndërtim informal. Në dosjet tre



objekteve të legalizuara ka të njëjtën deklaratë noteriale të qytetarit B.S për përzgjedhjen e legalizimit vetëm të një objekti, veprim cka nuk është në përputhje me ligjin e legalizimit por, në dy rastet e tjera legalizimin e dy objekteve të tjera duhen plotësuar dhe vertetuar se detyrimet financiare janë zbatuar me cmimet e tregut.

Shqyrtuar me vemendje observacionin e paraqitur nga punonjësja B.Y, ku konstatojme se pretendimi i saj lidhur me sa ne kemi kërkuar pagesën për taksën e infrastruktures të parcelave ndërtimore nuk qendron pasi të tre objektet e legalizuara janë në tokë të vet pronarit. Ky pretendim është i drejtë, por nga auditimi konstatohet se pronari nuk ka paraqitur dokument pronësie të pronës së tij si psh AMTP të regjistruar në ZVRPP dhe marrjen e certifikates. Në se ky dokument na paraqitet pretendimi është i drejtë, dhe ne marrim në konsideratë.

1. Në 1 rast legalizimi i ndërtimit informal prek zbatimin e projektit infrastrukturës rrugore nacionale (autostradë), pasi nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga me të cilat kufizohet, leje legalizimi datë 22.11.2018, ndërtesë social-ekonomike 4-kat''', pasuria 429/3/1, ZK 3235, Rrogzhinë. Kështu, Aktkonstatimi dhe genplani datë 19.10.2018 nuk pasqyron distancat e objektit nga superstrada. Nuk ka bashkëpunim me pushtetin vendor, për ndërtimin informal që prek rrjetin rrugor kombëtarë. Gjithashtu mungon dokumenti për marrëdhëniet me truallin, pasi parcela ndertimore mbi te cilin eshte ngritur ndertimi informal përfshinë pasuritë 429/3 "kullote", pasurinë 704/1 "kanale" dhe pasurinë 703 "rruge", në pronesi shtet, vol 8, faqe 136 dhe 197, vol 5, faqe 173, ZK 3235, sipas shkreses ZVRPP 6973/1 datë 26.10.2018. Subjekti ka vazhduar procesin gjyqesor për legalizimin e objektit ku është rrezuar padia në dëm të tij, sipas vendimit datë 14.07.2015, ndërsa ALUIZNI ka kryer legalizimin.

2. Në 3 raste legalizimi i ndërtimit informal cënon rrugët brenda qytetit në studim, pasi nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga me të cilat kufizohet, konkretisht:

- leje legalizimi datë..08.2019, "godinë social ekonomike 1-kat", pasuria 3/322, Kavajë,
- leje legalizimi datë 29.07.2019, "ndërtesë kombinuar 1-kat", pasuria 4/515/1, ZK 8551, Kavajë,

- leje legalizimi datë 27.02.2019, "godinë 1-kat, parukeri", pasuria 456/33/4, Rrogzhinë,

3. Në 3 raste se nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore lidhur me respektimin e distancave nga brezi hekurudhor, konkretisht:

a. pasuria 18/544/1, ZK 8552, Kavajë, ndërtesë e kombinuar 2-kat, me leje legalizimi datë07.2019, objekti ndodhen në një distancë prej 11,3 ml nga brezi i linjës hekurudhore.

b. pasuria 2/371/1, ZK 8551, Kavajë, ndërtesë e kombinuar 2-kat, leje legalizimi datë05.2019, rezulton se: objekti ndodhet mes rruges nacionale dhe hekurudhes në mos respektim të distancave sipas përcaktimeve ligjore, konkretisht:

- *Sipa shkresës ALUIZNIT datë 07.05.2018 thuhet se: distanca e objektit është më pak se 25 metra.*

- *Sipas vetdeklarimit të subjektit 21.08.2006, distanca e objektit nga hekurudha eshte 4,5 m, ne vend 25 metra dhe 9 meter nga rruga nacionale ne vend 20 metra,*

c. pasuria 18/972/1, ZK 8552, Kavajë, ndërtesë social-ekonomike 1-kat, sipas aktkonstatimit terrenit 15.05.2019, distanca e objektit nga hekurudha eshte 5 m ose 13,5 m bashke me skrapaten e shinave, ne vend 25 metra.

4. Në 2 raste është kryer legalizimi në kushtet kur ndërtimet informale paraqiten të pa përfunduara, duke i lënë mundësi subjektit për vazhdimin e ndërtimit të kateve tjera në të ardhmen, duke lejuar informalitet mbi informalitet, çka bie ndesh me misionin e legalizimit të zonave informate, në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe ligjin 62/2015, neni 3, shkronja "a", konkretisht:



- leje legalizimi 7002128, datë 16.09.2016, “*godinë banimi 1-kat*”, Golem, pasuria 38/26/1. Përveç legalizimit të parcelës ndërtimore shtet 399 m², subjekti ka të zaptuar dhe e posedon edhe pjesën e parcelës ndërtimore të pa legalizuar 250 m² (650-399), pa asnjë detyrim financiar, qiraje,

- leje legalizimi 7002138, datë 16.09.2016, “*godinë banimi 1-kat*”, pasuria 49/5, ZK 1791, Golem.

5. Në 5 raste shtesat e ndertimeve informale të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi prekin pjesërisht rrugën dhe sheshin publik, konkretisht:

a. Leje legalizimi 7002061, datë 31.08.2016, *shtesë godinë banimi 2-kat*, mbi godinën ekzistuese 2-kat (*gjithsej godinë banimi 4-kat*), **pasuria 16/148/1**, ZK 8551, Kavajë, rezulton se: ndertimi informal krahas shtesës në lartësi 2-kat paraqet dhe **zgjerim 30 m²** (126-96), shtesë e cila prek rrugën, e cila nuk kthehet në truall, sipas shkresës ZVRPP nr. 4613/1 datë 21/07/2016,

b. Leje legalizimi 7002117, datë 26.08.2016, *shtesë godinë banimi 2-kat*, e ngritur mbi ndertesën e vjeter 82 m² (*prishur*), **pasuria 4/154**, ZK 8552, Kavajë, rezulton se: ndertimi informal ka pjesërisht probleme me truallin për diferencën **27 m²** (109-82= 27 m² *rruge*), sepse ndertimi informal ka baze ndertimi sipërfaqen 109 m² nga 82 m² që ishte ekzistuesi.

c. leje legalizimi datë 16.09.2016, *ndërtesë banimi 2-kat*, **pasuria 3/312**, ZK 8552, Kavajë, rezulton se ndertimi informal 2-kat me 123 m² është ngritur mbi ndertimi ekzistues (*prishur*) me 109 m², pra paraqet shtesë të baze së ndertimit prej **14 m²**, madje shkallet janë jashtë objektit mbi trotuare, për pasojë kjo shtesë dhe shkallët kanë ndikuar në hapsirën publike,

d. leje legalizimi datë 24.04.2019, *ndërtesë 1-kat* për aktivitet social-ekonomik, pasuria 8/182, ZK 8551, Kavajë, rezulton se: objektit 1-kat prek sheshin publik, sipas shkresës ZVRPP 3322/1 datë 28.04.2019.

e. leje legalizimi..08.2019 *godinë shërbimi 4- kat+podrum*, ZK 1791, Golem, **pasuria 21/38/1** me, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 226,5 m² (*sipërfaqe ndërtimi 226,5 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 1242,1 m² për aktivitet*), rezulton se: paraqet problem statusi juridik i pasurisë, pasi parcela ndërtimore ose truall 300 m², mbi të cilin është ngritur ndertimi informal, përfshinë pasuri tjera, konkretisht peme dhe *rruge e kanal* në emer shtet, sipas shkresës ZVRPP nr. 1515/1 datë 28/02/2019,

6. Në 4 raste ndertimet informate të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndertimi informal përfshinë edhe pasuri të tretëve, të cilët kanë certifikate pronësie.

7. Në 2 raste, nuk janë sistemuar sipërfaqet tepër 541,5 m² të zënë në mënyrë të paligjshme por të palegalizuara dhe që posedohen padrejtësisht nga pronarët, konkretisht:

a. leje legalizimi datë...08.2019, për “*shtesën anësore 2-kat + ngritje 1-kat në godinën ekzistuese ish-dekori, argjila dhe qeramika ose poceria Kavajë*”, **pasuria nr. 2/304/2 dhe 2/304/1**, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 93 m² (*sipërfaqe ndërtimi 85 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi e shtesës 161,7 m² për banim dhe 170 për aktivitet*), rezulton se: Nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin për **diferencën 514 m²** (*blerë 2040 m²-2554m² LN*), e cila duhej të kalonte “shtet”.

8. Në 1 rast tek pasuria nr. 1/89/1, ZK 8551 nuk janë zbatuar procedurat administrative në përpilimin e akteve të ndërmjetme procedurale sipas afateve ligjore, **nuk është respektuar afati prej 60 ditësh** nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren datë 13.03.2017 deri në marrjen e vendimit për kualifikimin të objektit datë 23.04.2019, në kundërshtim me VKM 280, datë 1.4.2015 “*Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje*”, pika 8,



ALUIZNI ka dërguar pushtetit vendor shkresën 1717 datë 21.06.2019 nëse objekti e cënon rrugën në studim, pasi objekti është kualifikuar, sipas vendimit nr. 3244 datë 18.06.2019, për pasurinë 6/187/1, ZK 8552.

9. Mangësi janë konstatuar në punën e inspektorëve të terrenit, pasi në disa raste akt konstatimet paraqesin mangësi, nuk plotësohen me gjitha të dhënat, paraqesin kontradikta të dhënash me dokumentet tjera, nuk pasqyrohen distancat e objektit nga kufitarët, mungon pamja vizuale e objektit dhe kufitarëve dhe nuk pasqyrohet data e fotografimit, për efekt të respektimit të afatit ligjor të përfundimit të objektit informal, etj. Skicat fushore, proces verbalet e konstatimit dhe genplanet paraprahe janë plotësuar në disa raste pa përgjegjësi, me laps dhe me korrigjime, pa u plotësuar distancat me kufitarët dhe të dhëna tjera. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për arkivat*", VKM 515, datë 13.15.2009 "*Për përcaktimin e afateve, mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë proceduarve të legalizimit të objekteve informale*", urdhrin nr. 291 datë 1.9.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t "*Për miratimin e manualit "Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri) të objektit që legalizohet" pika 1 „Procedurat për hartimin e materialeve grafike"*", konkretisht:

- Inspektorët e terrenit kane vepruar me dy standarte, pasi ku respektohet distanca ajo pasqyrohet, ndërsa kur nuk respektohet ajo nuk pasqyrohet, Skicat nuk i pasqyrojnë distancën e pasurisë 14/389, ZK 8551, Kavajë, nga rruga (*veri*), ndryshe nga pasuria nr. 1/89/1 dhe nr. 211/114/1, ZK 8551, te cilat janë pasqyruar. Po kështu, proces verbali i konstatimit datë 27.02.2018 nuk pasqyron pasuritë kufitare dhe distancat e tyre nga pasuria e legalizuar.

- Dokumentacioni, paraqet mospërputhje të dhënash, lidhur me distancat e objektit me kufitarët tek pasuria 12/347, ZK 8552, Kavajë, konkretisht: sipas aktkonstatimit terrenit datë 31.08.2016, distanca e objektit nga rruget pasqyrohet 8,6 m dhe 12,8 m, sipas vetdeklarimit subjektit datë 04.05.2006, distanca e objektit deklarohet 03 m nga aksi i rruges, kjo distancë pasqyrohet më e madhe se e pasqyron vetë subjekti i interesuar. Sipas hartës dixhitale, genplanit, HTR dhe fotove qartësohet vendodhja e objektit informal midis 2 rrugeve.

- Tek pasuria 142/33/1, ZK 2292, Kryevindh, akt konstatimi në terren datë 05.02.2019 është i parregullt, pasi është bosh duke u mjaftuar vetem me datën dhe emrin e subjektit. Nisur nga verifikimi i kryer rezultoi se edhe skica fushore dhe genplani paraprahe janë plotësuar me stilolaps dhe me korrigjime. Gjithashtu mungon pamja vizuale e objektit, mungon data e fotografimit për efekt të kohës së përfundimit të objektit informal, mungon pasqyrimi i objektit me kufitarët, rruget, hapësirën publike etj, duke u mjaftuar me fotografimin e 4 faqeve të objektit pa pamjen rreth e qark të terrenit. Njëkohësisht objekti nuk identifikohet, sepse ai pasqyrohet si godina e ish-komunës kryevindh, pasi në katin e parë të fotos lexohet "*Bar-kafe Komuna*".

- tek pasuria nr. 1/89/1, ZK 8551 nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara procesverbali i verifikimit në terren datë 13.03.2017, pasi është mjaftuar vetëm me emertimin e pronarit, objektit e nenshkrimit e inspektorëve terrenit.

11. Dokumentacioni i dosjeve paraqet mungesa dhe parregullsi, pasi në disa raste mungon statusi juridik (*pasuria nr. 1/378/1, ZK 8551*), korrespondenca me pushtetin vendor (*pasuria 6/187/1, ZK 8552*), ortofotot digjitale si dhe disa shkresa e dokumente janë jo origjinale (fotokopje) etj.

12. dosjet e legalizimit rezultojnë të inventarizuara, por nëtë gjitha rastet nuk kanë numerizim sipas fletëve dhe dokumentave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*".



1/3- (Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale për periudhën 2016 deri 8-mujorin 2019).

1. Nga auditimi i dosjes I.M me leje legalizimi datë 01.08.2016, *godinë banimi 1-kat*, Synej, për parcelën ndërtimore të tij me sipërfaqe 171,6 m², sipërfaqe totale ndërtimi 171,6 m², në ZK 3554, pasuria 73/1/1, rezultoi se:

a. distanca e ndërtimit informal me rrugën nuk saktësohet, pasi sipas inspektorëve të terrenit (genplanit) paraqitet 21,5 m, ndërsa sipas HTR pasqyrohet ngjitur me rrugën. Në asnjë dokument nuk pasqyrohet kategoria e rrugës, përfshirë dhe dokumentet e inspektorëve terrenit, madje edhe 4 fotot nuk e pasqyrojnë. Mangësi u konstatuan në punën e inspektorëve terrenit, pasi aktkonstatimi datë 06.06.2016 nuk plotësohet me gjitha të dhënat, ka kontradikta të dhënash me dokumentet tjera si HTR, nuk pasqyrohen distancat e objektit nga kufitarët, pasuritë nuk saktësohen me përshkrimin e tyre, mungon pamja vizuale e kufitarëve ngjitur objektit dhe nuk pasqyrohet data e fotografimit. Inspektorët e terrenit A.K dhe D.D.

b. mungon dokumentacioni për arkëtimin e taksës ndikimit të infrastrukturës, në procesin e legalizimit të ndërtimit informal, në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, neni 27, pika ç, dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146, datë 28.9.2009 "*Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore*".

d. Dosja e legalizimit rezultoi të inventarizuar, por nuk ka marrës dhe dorëzues, nuk ka numerizim sipas fletëve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", për rrjedhojë është e domosdoshme numerizimi sipas dokumenteve dhe fletëve nga përpiluesja e dosjes M.Xh.

2. Dosja 665 S.Gj me leje legalizimi nr. 7002128, datë 16.09.2016, "*godinë banimi 1-kat*", Golem, *zonë bregdetare*, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 399 m² (*sipërfaqe ndërtimi 133,1 m²*, në ZK 1791, pasuria 38/26/1, e kufizuar V. 38/26, J. 38/26, P 38/26 dhe Lindja 38/27. Statusi juridik i pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti është sipërfaqja 650 m² arë "shtet", pasurisë 38/24, vol 6, faqe184, ZK 1791, rezultoi se:

a. Ndërtimi informal 1-kat paraqitet i pa përfunduar.

b. Përveç legalizimit të parcelës ndërtimore shtet 399 m², subjekti ka të zaptuar dhe e posedon edhe pjesën e parcelës ndërtimore të pa legalizuar 250 m² (650-399), pa asnjë detyrim financiar apo qiraje. Kështu,

Mungon deklarata noteriale nga subjekti që pranon ose refuzon blerjen sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore, mbi 3- fish dhe nën 500 m². Sipërfaqja e pa legalizuar duhet të ishte bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprim në kundërshtim me urdhrin e drejtorit përgjithshëm 30, datë 15.01.16 "*Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)*", i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar. ALUIZNI për sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit nuk ka marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore, për vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike.

c. mungon dokumenti për pagesën e parcelës ndërtimore dhe taksës ndikimit infrastrukturës,

3. Dosja A.H me leje legalizimi nr. 7002138, datë 16.09.2016, "*godinë banimi 1-kat*", pasuria 49/5, ZK 1791, Golem, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 345 m² (*sipërfaqe*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

ndërtimi 181 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi përbanim 250 m². Statusi juridik i pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti është sipërfaqja 390 m² arë në emër të A.H, përfituar me kontratë shitje në vitin 2002. Nga auditimi, rezulton se:

a. Objekti informal 1-kat paraqitet i pa përfunduar.

b. mungon dokumenti për pagesën e parcelës ndërtimore dhe për pagesën e taksës ndikimit infrastrukturës.

Me të njëjtat probleme paraqitet leja e legalizimit nr. 7002173, datë 22.09.2016, "godinë banimi 1-kat", pasuria 9/107/1, ZK 1791, Golem, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 300 m² (sipërfaqe ndërtimi 113,3 m². Statusi juridik i pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti është sipërfaqja 564 m² arë në emër të F.Ii, përfituar me kontratë shitje në vitin 1999.

4. Dosja e H.Rr, leje legalizimi datë 16.09.2016, ndërtesë banimi 2-kat, pasuria 3/312, ZK 8552, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 123 m² me sipërfaqe ndërtimi 123 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 263,4 m², rezulton se:

a. ALUIZNI Kavajë nuk ka bashkepunuar dhe nuk ka dërguar shkresë pushtetit vendor, nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të qendrës qytetit, ka zënë hapësirën publike, shkel distancat nga rruga dhe pallati si dhe kufitarët, ndryshe nga pasuria 14/389, ZK 8551 dhe 6/187/1 ZK 8552, për të cilat ka dërguar shkresat nr. 1008 datë 05.06.2019 dhe nr.1717 datë 21.06.2019, pra janë aplikuar 2 standarte.

b. Ndërtimi informal 2-kat me 123 m² është ngritur mbi ndërtimi ekzistues (prishur) me 109 m², pra paraqet shtese të bazes së ndërtimit prej 14 m², madje shkallet janë jashtë objektit mbi trotuare, për pasojë kjo shtesë dhe shkallët kanë ndikuar në hapsirën publike, probleme të cilat nuk janë prekur nga inspektorët e terrenit. Kështu sipas akt verifikimit, genplanit në terren datë 03.08.2016 nënshkruar nga inspektorët E.B, D.K dhe K.N nuk pëcaktjnë distancat e ndërtimit informal me kufitare, përveç 1 rasti të pasqyruar (1,57 m). Po kështu dhe 3 fotot e objektit nuk pasqyrojnë objektet kufitare dhe sheshin, pasi janë mjaftuar me fotografimin e faqeve të ndërtimit.

c. Në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, neni 27, pika ç dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146, datë 28.9.2009 "Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore", nuk disponohet asnjë dokument për pagesën e taksës ndikimit të infrastrukturës në vlerën 41,815 lekë për godinën banimi 2-kat me sipërfaqe totale ndërtimi 263,4 m² (263,4 m² x 31750 leke/m² x 0.5 %) pranë Bashkisë Kavajë.

5. Në 2 raste u konstatua se ndërtimet informate të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, konkretisht:

a. Leje legalizimi 7002061, datë 31.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, mbi godinën ekzistuese 2-kat (gjithsej godinë banimi 4-kat), pasuria 16/148/1, ZK 8551, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 126 m² me sipërfaqe ndërtimi 126 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 294,2 m², rezulton se:

- ndërtimi informal krahas shtesës në lartësi 2-kat paraqet dhe zgjerim 30 m² (126-96), shtesë e cila prek rrugën dhe nuk kthehet në truall, siipas shkresës ZVRPP nr. 4613/1 datë 21/07/2016 (bashkëngjitur 2 KPP dhe HTR përkatëse), ku thuhet: parcela ndërtimore 126 m², mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal 126 m², përfshinë pasuri tjera, konkretisht:

* pasurinë 16/143, rrugë, vol 7, faqe 146, ZK 8551, në emër shtet,

* pasurinë 16/148, truall 273 m² (nga kjo 96 m² ndërtesë) vol 10, fq 55, ZK 8551, emër pronarit.

Titulli i pronësisë mbi tokën 126 m² (ndërtesë) justifikohet me vertetimin hipotekor datë 31.08.2016, në vend të çertifikatës pronësisë.

b. Leje legalizimi 7002117, datë 26.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, e ngritur mbi ndërtesën e vjetër 82 m² (prishur), pasuria 4/154, ZK 8552, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

parcelës ndërtimore 109 m² me sipërfaqe ndërtimi 109 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 255 m², rezulton se: ndërtimi informal ka pjesërisht probleme me truallin për diferencën me sipërfaqe 27 m² (109-82= 27 m² rrugë), pasi ndërtimi informal ka baze ndërtimi sipërfaqen 109 m² nga 82 m² që ishte ekzistuesi. ALUIZNI ka kërkuar pushtetit vendor, nëse ka studim për zonën e qendrës qytetit, pasi objekti bie në këtë zonë, sipas shkresës nr. 458 datë 12.07.2016, ndërsa përgjigjja është kthyer se është në proces (*anulluar për momentin e hartimit PPV*), sipas shkresës Bashkisë Kavajë nr. 1927/1 datë 12.07.2016. Specialistët e terrenit dhe hartografia E.I nuk kanë përcaktuar kufitarin nga perëndimi në genplanin paraprak, duke u mjaftuar me distancën 0,73 m nga rruga, bazuar në ortofoton dhe HTR.

Specialistët A.K dhe D.D, G.T.

6. Leje legalizimi datë 23.09.2016, *godinë banimi 3-kat+garazhd*, pasuria 12/347, ZK 8552, lagje 5, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² me sipërfaqe ndërtimi 156 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 646 m² për banim, rezulton se: Dokumentacioni, aktkonstatimi i terrenit datë 31.08.2016 dhe vetdeklarimi i subjektit 04.05.2006, paraqet mospërputhje të dhënash, lidhur me distancat e objektit me kufitarët, konkretisht:

- sipas aktkonstatimit terrenit datë 31.08.2016, distanca e objektit nga rruget pasqyrohet 8,6 m dhe 12,8 m, sipas përcaktimeve ligjore, pamvartësisht se nuk përcaktohet kategoria dhe lloji i rrugës.

- sipas vetdeklarimit subjektit datë 04.05.2006, distanca e objektit deklarohet 03 m nga aksi i rruges, në vend të kufirit saj.

Pra matjet nuk janë të sakta, pasi kjo distancë pasqyrohet më e madhe se e pasqyron vetë subjekti i interesuar.

Sipas hartës dixhitale, genplanit, HTR dhe fotove qartësohet vendodhja e objektit informal midis 2 rrugëve.

Miratimi 500 m² i parcelës ndërtimore rrethuar me mure është në mosrespektim të distancave, pasi i shkurton më shumë ato.

Mungon rakordimi me pushtetin vendor, nëse objekti cënon zgjerimin e rrugëve dhe pengon studimin.

Specialistët e terrenit A.K, hartografia D.D dhe E.I.

Observacioni 6106/4 datë 11.11.2019 i F.Mt qëndron pjesërisht dhe u reflektua në Projektraport.

7. Dosja e M.S, leje legalizimi me numër serie 7010383 datë 24.04.2019, *ndërtesë 1-kat* për aktivitet social-ekonomik, pasuria 8/182, ZK 8551, lagjja nr.1 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 21 m² me sipërfaqe ndërtimi 21 m² për aktivitet, rezulton se: legalizimi i objektit informal 1-kat prek dhe cënon sheshin publik, sipas shkresës ZVRPP 3322/1 datë 28.04.2019, ku thuhet: *Parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë pasurinë 8/321 e llojit truall dhe pasurinë 8/83 e llojit "shesh" në emër "shtet" vol 8 ,faqe 7.* Akt konstatimi i terrenit datë 19.04.2019 i mbajtur nga inspektorët M.D dhe E.B nuk pasqyron distancat me kufitarët, ndërsa genplani i pasqyron të korrigjuara, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36, ku thuhet:*

dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime ,

Veprime në kundërshtim me: nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" ndryshuar ligjin nr. 50/2014,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

me nenin 62 të Rregullores së Urbanistikës të ligjit urbanistikës nr. 8405 17.9.1998 i ndryshuar me ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", ku thuhet:

KRRT-të e qarqeve, të bashkive të qyteteve të kategorisë së parë, dhe KRRTSH nuk kanë të drejtë të miratojnë asnjë ndërtim të përhershëm ose provizor..., në territore pronë publike të tilla si:

- sheshe dhe hapësira ndërmjet blloqeve të ndërtuara të banesave;

8. Në 1 rast legalizimi i ndërtimit informal prek zbatimin e projektit infrastrukturës rrugore, pasi nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga me të cilat kufizohet, në kundërshtim:
- me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar ligjin nr. 50/2014, me VKM nr. 756 datë...10.2016 pika 2 /i dhe gj,

Sa sipër, konkretisht: *Dosja nr. 2164, E.P, leje legalizimi datë 29.07.2019, titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM, "ndërtesë kombinuar 1-kat", pasuria 4/515/1, ZK 8551, lagjja nr. 2 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 239,3 m² me sipërfaqe ndërtimi 106,9 m², 82,6 m² për banim dhe 24,3 për aktivitet, aktkonstatimit në terren datë 17.04.2019 (genplani Arif Daja dhe M.D) dhe shkresës të ALUIZNIT nr. 1923 datë 28.06.2019 në adresë pushtetit vendor (shkresa nr. 2177/1 datë 09.07.2019 e bashkisë Kavajë është e parregullt, pasi është fotokopje, pa sqarim, pa firmën e titullarit).*

9. Dosja nr. 1145, A.A, leje legalizimi datë 27.08.2019, titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM, "ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik", pasuria 14/389, ZK 8551, lagjja nr. 2 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 34,5 m² me sipërfaqe ndërtimi 34,5 m², rezulton se:

-Vendimi i kualifikimit datë 26.05.2019 është nxjerre pa përgjigje të bashkisë Kavajë nr. 2929/1, datë 18.06.2019 brenda afatit ligjor, ku kërkohet: *nëse objekti që do legalizohet cënon rrugën në studim.*

10. Nga auditimi i dosjes K.ç me leje legalizimi datë...08.2019, për "shtesën anesore 2-kat + ngritje 1-kat në godinën ekzistuese ish-dekori, argjila dhe qeramika ose poceria Kavajë", pasuria nr. 2/304/2 dhe 2/304/1, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 93 m² (sipërfaqe ndërtimi 85 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi e shtesës 161,7 m² për banim dhe 170 për aktivitet), e kufizuar nga veriu "rruge", jugu "kufitarët Tare" 2/56, lindje "toke e tij" 2/304 dhe perëndim 2/54 "shtet", rezulton se:

a. ALUIZNI Kavajë ka përdorur 2 standarde, pasi në disa raste ka dërguar shkresë pushtetit vendor dhe në disa raste nuk ka dërguar, *nëse shtesa informale pengon planin rregullues të qytetit, ka zënë hapësirën publike, shkel distancat nga rruga, etj,* konkretisht: ka dërguar shkresë zyrtare pushtetit vendor për pasurinë e legalizuar nr. 2/304/2 dhe nr. 2/304/1, ZK 8551, pasuritë nr. 14/389, ZK 8551 dhe nr. 6/187/1, ZK 8552, për të cilat ka dërguar shkresat nr. 1008 datë 05.06.2019 dhe nr.1717 datë 21.06.2019. Për rrjedhojë nuk ka informacion dhe bashkëpunim me pushtetin vendor, pasi nuk disponon asnjë dokument për objektet nga bashkia e cila nuk i është përgjigjur Aluiznit.

b. Inspektorët e terrenit nuk kanë pasqyruar distancat saktë sipas skicave, konkretisht: skicat nuk i pasqyrojnë distancën e pronës nga rruga (veri), ndryshe nga pasuria nr. 1/89/1 dhe nr. 211/114/1, ZK 8551, të cilat janë pasqyruar. Po kështu, procesi verbal i konstatimit datë 27.02.2018 nuk pasqyron pasuritë kufitare dhe distancat e tyre nga pasuria e legalizuar. Inspektorët A.K dhe E.B.

c. Nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin për diferencën 514 m² (blerë 2040 m²-2554m² LN), e cila duhet të kalonte "shtet" si diferencë midis sipërfaqes blerjes truallit (1998) me LN (2017), pasuria 2/304 (2017) ZK 8551, vol 13, faqe 247, në emër të K.ç, sipas shkresës ZVRPP nr. 1362/1 datë 28.03.2018 (bashkëngjitur HTR dhe KPP), ku pasuria e legalizuar përfshinë pasuritë 2/304 "K.ç", 2/55 dhe 2/54 "shtet si dhe nr.2/56 "bashkëpronarët Tare".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Në dosje disponohen 2 KPP nga ZVRPP, ku njëra pasqyron vetëm sipërfaqen 2040 m2 truall me 4 kufizime hipoteke, ndërsa tjetra pasqyron sipërfaqen 2554 m2 sipas LN, vol 13, faqe 247.

11. Nga auditimi i dosjes 6 bashkëpronarëve "Gj" me leje legalizimi datë...05.2019, për "godinë e kombinuar 2-kat", pasuria nr. 1/89/1, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m2, sipërfaqe ndërtimi 392,5 m2 për banim dhe 410,6 m2 për aktivitet, rezulton se:

a. Dokumentacioni i dosjes për legalizim paraqet parregullsi dhe mangësi, konkretisht:

- mungon kthimi i përgjigjes nga ZVRPP për statusin juridik, HTR dhe KPP të pasurisë 1/89/1, ZK 8551, sipas shkresës nr. 309 datë 21.01.2019 me të cilën ALUIZNI kërkon të dhënat e sipërcituara.

- nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara procesverbali i verifikimit në terren datë 13.03.2017, pasi është mjaftuar vetëm me emertimin e pronarit, objektit dhe nenshkrimin e inspektorëve terrenit A.K, M.D, B.T.

- dëshmia e trashgimisë datë 26.03.2019 është e parregullt, pasi është fotokopje e panoterizuar.

- mungon vërtetimi ose shkresa e ALUIZNI në adresë bashkisë Kavajë, për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

- mungon VKM dhe dokumenti për detyrimin për parcelën ndërtimore.

- nuk janë zbatuar procedurat administrative në përpilimin e akteve të ndërmjetme procedurale sipas afateve ligjore, nuk është respektuar afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren datë 13.03.2017 deri në marrjen e vendimit për kualifikimin të objektit datë 23.04.2019, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", pika 8. c. dosja e legalizimit e përfunduar rezulton e inventarizuar, por nuk ka numerizim sipas fletëve dhe dokumentave, fenomen ky edhe për rastet tjera, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".

12. Nga auditimi i dosjes S.H me leje legalizimi datë 27.08.2019, për "godinë social-ekonomike 1-kat+podrum", pasuria nr. 1/378/1, ZK 8551, Lagje nr.2 Kavajë, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m2, sipërfaqe ndërtimi 364,5 m2 për aktivitet, rezulton se ALUIZNI Kavajë në vitin 2016 mënyrë të përsëritur ka kërkuar ZVRPP-së, statusin juridik të pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti dhe vënien në dispozicion HTR e KPP, sipas shkresave nr.528 date 20.07.2016 dhe nr. 738 datë 19.08.2016 si dhe nr. 791 datë 29.08.2016. Në përgjigje të këtyre shkresave, ZVRPP nuk ka sqaruar statusin juridik dhe ka cituar se HTR nuk është ne te njejten shkalle me HTR të hipotekës, për rrjedhojë nuk është kryer legalizimi i pasurisë deri në datën 27.08.2019. Plotësimi i lejes legalizimit datë 27.08.2019 për pasurinë 1/378/1, është bazuar tek informacioni i hartografes F.K, të cilat kanë bashkëngjitur HTR dhe KPP. Gjithashtu, në dosje disponohet vërtetimi hipotekor datë 08.07.2016 i shoqëruar me HTR, në vend të certikatës pronësisë për pasurinë 1/378/1, madje kjo hartë nuk rekordon me hartën e hipotekës.

13. Nga auditimi i dosjes A.G me leje legalizimi datë 23.08.2019, për "godinë e kombinuar 3-kat", pasuria 482/17/1, ZK 3235, Rrogzhinë, parcela ndërtimore 500 m2, për aktivitet 328 m2 dhe 585 m2 për banim, rezulton se: mungon pjesërisht marrëdhënia me truallin për pasurinë 482/17/1, pasi një pjesë e sipërfaqes "arë" mbi të cilin është ngritur objekti është pronë e një personi tjetër (akti 329, H.Q Q), sipas KPP pasuria 482/17, vol 10, faqe 224, ZK 3235. Theksojmë se Subjekti A.G ka në pronësi pasurinë 482/16, sipërfaqe 638 m2, arë, vol 3, faqe 100, ZK 3235, përfituar me KDH (me origjinë AMTP 198). Në seksionin "D" ose "E" të 2 KPP nuk citohet se: *ka ndërtim pa leje ose okupim mbi pasuritë 482/16 dhe 482/17. Hartografe F.K.*



14. Nga auditimi i dosjes Z.B me leje legalizimi datë 28.06.2019, për “*godinë e kombinuar 2-kat*”, pasuria 6/187/1, ZK 8552, Kavajë, parcela ndërtimore 148 m², për aktivitet 132 m² dhe 170.5 m² për banim, rezulton se: leja e legalizimit është dhënë në kushtet e mos paraqitjes së plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të parregullsisë së tij, në kundërshtim me nenin 33 “Dispozitë detyruese” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin 50/2014.

a. mungon shkresa e pushtetit vendor, nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të sistemit rrugor, për efekt të zgjerimit rrugëve me interes publik, pasi objekti ndodhet ngjitur dhe mbi trotuarin e rrugës, sipas fotove dhe genplanit të objektit të kryer nga inspektorët e terrenit. Kështu, ALUIZNI Kavajë ka dërguar shkresë pushtetit vendor, *nëse objekti e cënon rrugën në studim*, sipas shkresës nr. 1717, datë 21.06.2019, për të cilën nuk ka marrë përgjigje, ndërkohë ka kryer legalizimin.

b. ALUIZNI ka dërguar pushtetit vendor shkresën 1717 datë 21.06.2019 nëse objekti e cënon rrugën në studim, pasi objekti është kualifikuar, sipas vendimit nr.3244 datë 18.06.2019. Hartografe F.K.

c. dosja e legalizimit e përfunduar rezulton e inventarizuar, por nuk marrës dhe dorëzues si dhe nuk ka numerizim sipas fletëve dhe dokumentave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”.

15. Nga auditimi i dosjes B dhe A.L me leje legalizimi datë 28.08.2019, për “*godinë banimi 2-kat*”, pasuria 11/114/1, ZK 8551, Kavajë, parcela ndërtimore 154 m², rezulton se: Dokumentacioni tekniko-ligjor paraqet mangësi, konkretisht:

* parcela ndërtimore mbi të cilën është ngritur ndërtimi informal (nr.11/114/1=200 m², vol 9, faqe 223) i poseduar nga pronarët L. përfshinë edhe pasuritë 11/73 dhe 11/74 të personave tjerë, sipas shkresës 6328/1 datë 22.10.2018 të ZVRPP Kavajë. Pra nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin.

* mungon marrëveshja noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, pasi parcela ndërtimore prej 200 m² është pronë e 2 personave të B A.L dhe A.L, sipas KPP vol 9, faqe 223 dhe 2 certifikatave familjare, veprim në kundërshtim me nenin 28/ë të ligjit “*Dhënia e lejes së legalizimit*”

16. Nga auditimi i dosjes RR.K me leje legalizimi datë ...02.2019, për “*godinë e kombinuar 3-kat*”, pasuria 142/33/1, ZK 2292, Kryevidh, Kavajë, parcela ndërtimore 299,7 m², për aktivitet 99,9 m² dhe 240.6 m² për banim, rezulton se:

a. dosja e legalizimit e përfunduar rezulton e inventarizuar, por nuk ka marrës dhe dorëzues si dhe nuk ka numerizim sipas fletëve dhe dokumenteve, fakt është se mungojnë disa dokumente të cituara më sipër, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e nenit 29 të ligjit 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”.

17. Pasuria 18/544/1, ZK 8552, Kavajë, *ndërtesë e kombinuar 2-kat*, në emer të T.M, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 498,3 m² me sipërfaqe ndërtimi 108,7 m², sipërfaqe për aktivitet 85,3 m² dhe 165,6 m² për banim, me leje legalizimi datë ...07.2019, rezulton se: Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si harta dixhitale, aktkonstatimi i terrenit, genplani, objekti ndodhen në një distancë prej 11,3 ml nga brezi i linjës hekurudhore dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të Hekurudhës Shqiptare.

Shkresa Hekurudhave 523/1 datë 26.04.2019 nuk percakton distancën që kerkohet, madje eshte dokument i parregullt fotokopje, ndersa shkresa e ALUIZNIT 1155 datë 25.05.2018 e citon vetë se distanca është më pak se 25 metra ose me pak se percaktimet ligjore.

b. pasuria 2/371/1, ZK 8551, Kavajë, *ndërtesë e kombinuar 2-kat*, në emer të B dhe G. N., me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 511,1 m² me sipërfaqe ndërtimi 511,1 m², sipërfaqe për aktivitet 511,1 m² dhe 318,7 m² për banim, me leje legalizimi datë05.2019, rezulton se:



objekti ndodhet mes rruges nacionale dhe hekurudhes në mos respektim të distancave sipas përcaktimeve ligjore, konkretisht:

c. pasuria 18/972/1, ZK 8552, Kavajë, *ndërtesë social-ekonomike 1-kat*, në emer të H.I, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 334,2 m² me sipërfaqe ndërtimi 111,4 m², për aktivitet 111,4 m², me leje legalizimi datë ...05.2019. Sipas aktkonstatimit terrenit 15.05.2019, distanca e objektit nga hekurudha është 5 m ose 13,5 m bashke me skrapaten e shinave, në vend 25 metra.

Hartograf F.K..

Observacioni i subjektit qendron, pasi vërtetimi i hekurudhave flet se objekti i plotëson kondicionet lidhur me brezin hekurudhor.

18. Në 2 raste u konstatua se ndertimet informate të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi parcela ndërtimore mbi te cilin është ngritur ndertimi informal përfshinë edhe pasuri të tretëve, të cilët kanë certifikate pronësie, konkretisht:

a. Dosja e B.H dhe F.H, leje legalizimi datë ...08.2019, *ndërtesë social-ekonomike 3-kat*, pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² me sipërfaqe ndërtimi 262 m², sipërfaqe për aktivitet 795,2 m², rezulton se:

Për rrjedhojë miratimi i titullit pronësisë mbi një pjesë toke nuk mund të kryhet me VKM, siç thuhet në lejen e legalizimit, konkretisht pasuritë, sipas shkreses ZVRPP 3058/1 datë 03.05.2019:

- Pasuria 25/41 *pentore +truall me pronarë A.K, vol 14, faqe 198, ZK 3501.*

- Pasuria 25/40 *pentore me pronarë A.H, vol 14, faqe 197, ZK 3501.*

- Pasuria 25/16 *pentore +truall me pronarë R.H, ZK 3501.*

- Pasuria 25/8 *pentore +truall me pronarë F.H, vol 7, faqe 198, ZK 3501.*

b. Dosja e A.C ose "M." shpk, leje legalizimi datë ...01.2019, *ndërtesë social-ekonomike 2-kat*, pasuria 72/24/1, ZK 3554, Synej Kavajë, baxho qumështi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqe ndërtimi 2271,3 m² sipërfaqe për aktivitet 4542,6 m², për rrjedhojë miratimi i titullit pronësisë mbi një pjesë toke nuk mund të kryhet me VKM, siç thuhet në lejen e legalizimit, konkretisht pasuritë sipas shkreses ZVRPP 8202 datë 20.02.2018:

- Pasuria 72/24 *truall 2000 m2, me pronarë A.C , vol 4, faqe 107, ZK 3554.*

- Pasuria 72/23 *are me pronarë b/pronaret XH., vol 4, faqe 106, ZK 3554.*

- Pasuria 72/25/1 *are me pronarë b/pronaret XH., vol 4, faqe 108, ZK 3554.*

- Pasuria 72/25 *are me pronarë B. XH., vol 4, faqe 109, ZK 3554.*

- Pasuria 72/26 *are me pronarë D. XH., vol 4, faqe 110, ZK 3554.*

Përfundimisht, "M." shpk disponon prone te tij pasurinë 72/24, sipërfaqe 2000 m2 truall (nga kjo 380 m2, ndërtesë 3-kat ekzistuese ish-zyrat e konop. Synej), sipas certifikates pronësie 13.03.2007, ndersa per zgjerimin "shtese 2-kat në objektin ekzistues 3-kat" nuk ka dokument pronësie për diferencën e truallit me sipërfaqe 271,3 m² (2271,3-2000), pasi sipërfaqja e parcelës dhe ndërtimore është 2271,3 m² 2271,3 m², nga 2000 m² që ka pronën e tij.

19. Dosja e F.ç, leje legalizimi datë 31.01.2019, *ndërtesë e kombinuar 3-kat*, pasuria 5/385/2, ZK 8551, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 479,7 m² me sipërfaqe ndërtimi 289,5 m², sipërfaqe për aktivitet 185,3 m², rezulton se:

a Sipas shkreses ZVRPP 322 datë 17.01.2019, HTR dhe KPP, parcela ndertimore mbi te cilin është ngritur ndertimi informal përfshinë pasuri tjera private dhe shtet.

Informacioni nr. 409 datë 31.01.2019 i ALUIZNI ku thuhet: *zvogëlojmë nga jugu parcelen ndertimore prej 20,3 m2 (500-20,3=479,7 m2) sepse bie mbi pasurine 5/60 me status juridik "rruge e kanale", qëndron pjesërisht, pasi duhej zbritur edhe sipërfaqja e pasurisë 5/4 të J.K , pra gjithsej duhej zbritur 200 m2 (është zbritur 20,3 m2 "rruge+kanale" + duhej zbritur 179,7 m2 prone e J.K), kështu duke legalizuar 300 m2 parcelë ndertimore nga 479 m2 e legalizuar.*



20. Nga auditimi i dosjes A. SHPK, *godinë shërbimi 4- kat+podrum*, ZK 1791, Golem, pasuria 21/38/1 me leje legalizimi...08.2019, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 226,5 m² (*sipërfaqe ndërtimi 226,5 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 1242,1 m² për aktivitet*, rezulton se: paraqet problem statusi juridik i pasurisë, pasi:

a. në origjinë është pemë dhe jo truall, *siç thotë kontrata për dhënie trualli 21.08.1997*, lidhur midis urbanistikes rrethit dhe privatit, e cila është e pa rregullt nga forma dhe pëmbajtja .

b. Ndërtimi informal është ngritur ne vitin 2005-2006, me leje ndërtimi datë 08.03.2005 (*e cila nuk disponohet*), sipas deklarimit subjektit 16.01.2017, por paisja me leje legalizimi nuk argumentohet kur subjekti deklaroi se e kam ndërtuar me leje ndërtimi.

Pasuria 21/38/1 është rregjistruar 14.06.2018 truall 300 m², vol 15, faqe 21 (*ardhur nga vol 14, 13 dhe 12/ 242*).

d. vertetimi për pagesën e taksës ndikimit infrastrukturës është leshuar nga shefi kabinetit Kavaje ne vend te kryetarit bashkise.

e. inspektorët e terrenit M.D dhe E.B nuk kanë plotësuar të dhënat në akt konstatim 18.02.2019.

21. Dosja e F.H, leje legalizimi datë 22.11.2018, *ndërtesë social-ekonomike 4-kat*, pasuria 429/3/1, ZK 3235, Rrogozhinë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 434,3 m² me sipërfaqe ndërtimi 248,5 m², sipërfaqe për aktivitet 692,8 m², rezulton se:

a. Aktkonstatimi dhe genplani datë 19.10.2018 mbajtur nga inspektorët e terrenit M.D, K., K. T., nuk ka të plotësuar gjitha të dhënat, nuk pasqyrohet distancat e objektit nga superstrada. Nuk ka bashkëpunim me pushtetin vendor, për ndërtimin informal që prek rrjetin rrugor,

b. parcela ndërtimore mbi te cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë pasuritë 429/3 "kullote", pasurinë 704/1 "kanale" dhe 703 "rruge", në pronesi shtet, vol 8, faqe 136 dhe 197, vol 5, faqe 173, ZK 3235, Rrogozhinë, sipas shkresës ZVRPP 6973/1 datë 26.10.2018. Pra mungon dokumenti për marrëdhëniet me truallin.

c. Në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, neni 27 , pika ç dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146, datë 28.9.2009 "Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore", nuk disponohet asnjë dokument për pagesën e taksës ndikimit të infrastrukturës në vlerën 152,844 lekë për godinën 4-kat social-ekonomik me sipërfaqe ndërtimi 962,8 m² ($962,8\text{ m}^2 \times 31750\text{ leke/m}^2 \times 0.5\%$) pranë Bashkisë Rrogozhinë, nuk bëhet fjalë për pagesën e detyrimit të parcelës ndërtimore.

22. Nga auditimi i dosjes P.B.me leje legalizimi datë ...08.2019, për "godinë social ekonomike 1-kat", pasuria 3/322, ZK 8552, Kavajë, parcela ndërtimore 68,5 m², për aktivitet 68.5 m², rezulton se: legalizimi është kryer në kushtet e mos respektimit të distancës nga rruga urbane.

Kështu, me shkresën 1716 datë 21.06.2019 Aluizni kërkon informacion nga pushteti vendor nëse objekti e cënon rrugën, në përgjigje bashkia Kavajë me shkresën 2089/1 datë 28.06.2019, thotë: *verifikimet të bëhen nga juve, pasi është në sistem PPV*. Nga verifikimet e kryera ALUIZNI thotë: *objekti pjesërisht cënon rrugën në studim*.

23. Dosja e H.M., leje legalizimi datë07.2019, *ndërtesë e kombinuar 2-kat*, pasuria 50/18/1, ZK 1791, Golem, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 132,7 m² me sipërfaqe ndërtimi 90 m², sipërfaqe për aktivitet 92,9 m² dhe 144 m² për banim, rezulton se:

a. Objekti kufizohet në 4 anët me rruge, ndërsa akt konstatimi i terrenit datë 02.05.2019 si dhe genplani i mbajtur nga inspektorët M.D dhe A.D. nuk përcakton distancat.

c. Nuk ka bashkëpunim me pushtetin vendor, për ndërtimin informal nëse prek rrjetin rrugor, *pasi ai ne kater anet kufizohet me rruge e rrugica*. Disponohet shkresa e bashkisë Kavajë nr. 1954/1 datë 21.06.2019 ku thuhet *se nuk disponon dokumente për objektin 1-kat me leje ndërtimi nr.13 datë 04.03.1994, i cili është prishur duke u ngritur ndërtimi i ri 2-kat sipas deklaratës noteriale 30.04.2019*. Pra pushteti vendor nuk konfirmon lejen e ndërtimit.



26. Dosja e RR.C, leje legalizimi datë07.2019, *ndërtesë e kombinuar 3-kat*, pasuria 10/572/1, ZK 8552, lagjja nr.6 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 115,3 m² me sipërfaqe ndërtimi 83,7 m², 97m² për banim dhe 180,7 m² për aktivitet, rezulton se sipas HTR, Gen planit dhe fotove terrenit nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga kryesore e qytetit, me të cilat kufizohet objekti, **Observacionet për aktkonstatimet nr. 5, nr. 6 dhe nr. 9.**

Observacionet nr. 6105/10 dhe nr. 6110/4 datë 12.11.2019 të M.N qëndrojnë pjesërisht dhe u reflektuan ne Projetrabort.

Observacionet nr. 6105/1 dhe nr. 6110, datë 12.11.2019 i I.D qëndrojnë pjesërisht dhe u reflektuan ne Projetrabort.

Observacionet nr. 6105/2, nr. 6105/3, nr. 6105/6, nr. 6105/7, nr. 6105//8, nr. 6105/9, nr. 6105/10, nr. 6106/2 dhe nr. 6110/2 ,datë 12.11.2019 qëndrojnë pjesërisht dhe u reflektuan ne projetrabort.

konkretisht: për pikat e aktkonstatimet nr. 5, nr. 6 dhe nr. 9 eshte bërë sistemimi pjesor sipas argumenteve te pasqyruara ne vrejttet dhe dokumentacionin shoqerues te ALUIZNIT, ndërsa për 3 raste nuk ka rekomandime, pasi janë trajtuar si mangësi dhe shkelje teknike, mbështetur ne sugjerimet e subjektit të audituar. Gjithashtu merret parasysh pika 4 dhe 14, bazuar ne disa observacione të subjektit, gjithashtu është siguruar dokumentacioni tekniko-ligjor dhe nga institucionet tjera.

1/3-Auditimi në lidhje me regjistrimet e lejeve të legalizimit dhe pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë (për periudhën objekt auditimi).

Sipas informacioneve të dhëna në Drejtorinë e Aluiznit Kavajë kostatohet se nga viti 2016 deri në fund të tetorit 2019 kostatohet se janë legalizuar gjithsej **2950 objekte** dhe per likujdimine taksës së infrastrukturës janë nisur shkresat Bashkive Kavajë dhe Rogozhinë (shif.**Aneksi nr. 1** "Pasqyra e objekteve që janë legalizuar dërguar shkresat Bashkive viti 2017-2019 bashkagjitur ketij Projekt Raporti).

Sipas pasqyres se bashkagjitur projektraportit, se shkresat e nisura janë me shume vonesë dhe kjo ka ndikuar në mos arketimin e kësaj takse dhe konkretisht , në datën 21.01.2019 janë nisur shkresat brenda një date per 112 objekte,në daten 04.02.2019 janë nisur shkresat per reth 52 objekte brenda nje date , **pra dërgimi i tyre ka pa produktivitet (Shif datat dhe nr e prot.)** .

Pra, rezulton se taksa e ndikimit në infrastrukturë në Bashkinë Kavajë për vitin 2016 deri në gusht të vitit 2019 për **2950 objekte** për banim dhe social ekonomike e garazhe e veranda e cila rrezulton ne siperfaqe totale 725590 m², nga këto 659896 m² janë për banim dhe 65694 m² janë për aktivitet. Rezulton se per aktivitet është rreth 0.9 perqint e siperfaqeve ndërtuese ne Bashkitë Kavajë dhe Rogozhinë.

Në total janë **2950 objekte me sipërfaqe 725590 m²** e marrë me mesataren duhej të likujdohej taksa në infrastrukturë në vlerën në total **113,761,628 lekë** (725590 m² x 31,357 lekë për m²x 0.5%).

Sipas pasqyrës së lart përmendur konstatohet se janë nisur shkresat për 2127 objekte nga 2950 që janë në total, me një diference -823 objekte,por e marë me mesatare për një objekt është 38,563 lekë dhe kostatohet se nuk janë nisur shkresat për vlerën **31,737,349 lekë**(-823 objekte x38,563 lekë).

Nga auditimi i dosjeve të legalizimit për objektet informale të pajisur me lejët e legalizimit konstatohet se mungojnë vërtetimet e likuidimit të taksës së infrastrukturës në dosje veprime në kundërshtim me nenet 27 dhe 37 të ligjin 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe VKM 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar.

Sipas pasqyrës se marë nga ish/Drejtorja e Aluiznit Kavaje ,”Agjensia Shtetore e Kadastrës (Drejtorja Vendore Kavajë) “, rezulton se Bashkia Kavajë sipas shkresës me nr.3000/1 kavaje me 24 .09.2019 rezulton ne taksat vendore te kësaj Bashkie kane likujduar si me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT “DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË”

poshte(Pasqyra)

Nr.	VITI	Vlera e Likujduar (lekë)
1	2016	5,052
2	2017	4,112
3	2018	1,188,458
4	2019	23,118,000
	TOTALI	24,315,622

Nga Bashkia Kavajë ka të legalizuara gjithsej 2578 objekte dhe Bashkia Rrogozhinë 372 të legalizuara, sipas pasqyres duhej te likujdonin taksen e infrastruktures në vlerën 99,415,414 lekë (2578 objekte x 38,563 lekë) në fakt ka likujduar 24,315,622 lekë me diferencë - **75,099,792 lekë, të pa arketuara në Taksat Vendore të Bashkisë Kavajë.**

Sipas shkresë me nr.4435 Prot nga Bashkia Rrogozhine është likujduar taksa e ndikimit në infrastrukture (si me poshtë Pasqyra).

Nr.	Vitet	Nr.Lejve	Vlera ne lekë
1	2016	16	860,174
2	2017	14	841,989
3	2018	81	2.546335
4	2019	138	6,257,007
	Shuma	249	10,505,503

Pra nga të dhënat e Bashkive Kavaje dhe Rrogozhine kostatohet se janë likujduar në total **34,821,125 lekë** (Bashkia Kavaje 24,315,622 dhe Bashkia Rrogozhinë 10,505,503 lekë) .

Në total duhet të likujdonin taksen e infrastrukturës në te dyja Bashkitë për 2950 objekte sipërfaqe 725,590 m² e marrë me mesataren duhej të likujdohej taksa në infrastrukturë në vlerën në total **113,761,628 lekë** (725,590 m² x 31,357 lekë për m² x 0.5%) por kane likujduar 34,821,125 leke me diference mos likuditeti ne vleren **78,940,503 leke** te pa arketuara ne buxhetin e shtetit.

Pra sa me sipër me veprime e mos veprime bien në kundërshtim me ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar neni 3 pika (i), neni 23, si dhe neni 27 “Dokumentacioni tekniko- ligjor për legalizimin e objektit” pika (ç) ku përcaktohet se mugeon vertetimi i likujdimit te taksës se infrastrukturës nga viti 2016 e në vazhdim:

“Vërtetim për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa sipas legjislacionit ne fuqi dhe legjislacionit ne fuqi”,si dhe VKM 580 datë 10.12.2014 pika (5), mbajnë përgjegjasi përfaqësuesve të subjektit të auditimit në Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Kavajë” Agjensia Shtetore e Kadastrës“.

Pika nr.2 e Raportit të Auditimit; “Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”.

Për trajtimin e çështjeve të programit të auditimit lidhur me përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në:

Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;

U përdorën kriteret ligjore si më poshtë:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nën ligjore për zbatimin e tij.

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore për zbatimin e tij.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Respektimi i procedurave ligjore për hartimin dhe miratimin e buxhetit për vitin 2016 - 6 muhori I 2019

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, lidhur me planifikimin e projekt buxheteve afatmesëm dhe atyre vjetore për periudhën 2016 – 6 muhori 2019 u, dokumentacionit financiar për zbatimin e buxhetit, u konstatuan disa veprime në mospërputhje me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit:

Viti 2016 (hartimi dhe miratimi i buxhetit)

Projekt-buxhetet janë hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-it, Tiranë sipas kërkesave të dërguara nga Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë (në vijim DRAK), dhe janë miratuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për periudhën 2016-2017 dhe Ministria e Drejtësisë për periudhën 2018-2019, referuar përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave.

Fondet e buxhetit të DRAK kanë dy burime:

1.Nga buxheti i shtetit;

2.Nga transferimi i masës 30% të të ardhurave të realizuara nga parcela ndërtimore.

Këto dy burime të ardhurash përdoren nga DRAK për mbulimin e shpenzimeve korrente (paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime operative).

Për buxhetin e vitit 2016, në zbatim të Ligjit nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit me shkresën nr. 2266/4 prot., datë 11.05.2016 ka dërguar miratimin e rialokimit të fondeve për shpenzimet korrente, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.

Nëpërmjet shkresës nr.4062/1 prot., dt.17.05.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është bërë rialokimi i fondeve për DRAK në llogaritë ekonomike:

600-3,050,000 lekë;

601-520,000 lekë;

602-1,000,000 lekë.

TOTAL=4,570,000 lekë

Nëpërmjet shkresës nr.4382 prot., dt.19.05.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është përcjellë normativa mujore për treguesit e ecurisë së procesit të legalizimit, e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1

DREJTORIA	Nr. i përditësimeve në terren	Nr. i objekteve që do të kualifikohen	Normativa mujore e arkëtimeve		Normativa e lejeve të legalizimit
			Nr. faturash	Vlera (30% e të ardhurave nga parcela ndërtimore, lekë)	
Kavajë	170	140	40	1,260,000	130

Burimi: DRAK

Nëpërmjet shkresës nr.4304/1 prot., dt 24.05.2016 nga MZHUT është dërguar miratimi i limitit mujor për DRAK.

Me anë të shkresës nr.5126/1 prot. dt 23.06.2016 nga MZHUT është bërë rialokim i fondeve për investime në llogaritë ekonomike, si më poshtë:

231-240,000 lekë (blerje pajisje zyrash);

231-480,000 lekë (blerje pajisje elektronike).

Me shkresën 6144/1 prot., datë 24.08.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, është dërguar detajimi i buxhetit të rishikuar për vitin 2016, sipas Aktit Normativ nr.1, datë 29.06.2016, ku janë pakësuar fondet në llogaritë ekonomike “231” investime, dhe me shkresën 4411/7 prot., datë 31.08.2016 fondet e mësipërme janë bërë në vlerat, si më poshtë:

231-182,000 lekë (blerje pajisje elektronike);



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

231-41,500 (blerje pajisje zyresh).

Me shkresën nr.7290/1 prot. dt. 14.10.2016 është dërguar miratimi i riallokimit të fondeve në llogarinë ekonomike "231" vlera e të cilës bëhet 182,400 lekë (për blerjen e pajisjeve elektronike).

Në muajin Shtator të vitit 2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t për DRAK, është bërë transferim i pjesës takuese 30% të vlerës së të ardhurave të realizuara nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore, në vlerën 1,400,000 për tu përdorur në llogarinë ekonomike 600 dhe 601.

Nëpërmjet kërkesës nr.113 prot., datë 15.11.2016 për rritje buxhetore jashtë limitit është miratuar fondi në vlerën 259,378 lekë (nga të ardhurat e krijuar nga institucioni nga tarifat e legalizimit dhe penalitete) në Kap.6, për tu përdorur në llogaritë ekonomike si më poshtë:

600-216,062 lekë;

601-43,316 lekë.

Me shkresën nr.8250 prot., dt. 24.11.2016 është bërë kërkesa për tranferimi fondi nga pjesa takuese të ardhurave të realizuara nga transferimi i parcelës ndertimore në masën 30% të tyre, ku për DRAK janë alokuar 500,000 lekë për tu përdorur në llogarinë ekonomike 600 dhe 601. Me shkresën nr. 6819/5 prot., dt 29.12.2016 të MZHU është dërguar detajimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2016, në zbatim të aktit normativ, nr.2 dt 16.12.2016, ku për DRAK është bërë shtesë në fondi në llogaritë ekonomike si më poshtë:

600-150,000 lekë;

601-37,000 lekë;

602-157,100 lekë.

TOTAL=344,100 lekë

Viti 2017 (hartimi dhe miratimi i buxhetit)

Për buxhetin e vitit 2017, në zbatim të Ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit me shkresën nr. 205/2 prot., datë 17.01.2017, ka dërguar detajimin e fondeve për shpenzimet korrente, për vitin 2017, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, dhe më pas është përcjellë me shkresën nr.365/1 prot., datë 23.01.2017, pranë DRAK, i ndarë në llogaritë ekonomike si më poshtë vijon:

600-5,000,000 lekë;

601-1,000,000 lekë;

602-1,000,000 lekë.

TOTALI=7,000,000 lekë. (në krahasim me vitin 2016, janë miratuar 2,430,000 lekë më tepër, si pasojë e shtimit të numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme).

Nëpërmjet shkresës nr.744/1 prot., dt 06.02.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është dërguar miratimi i kërkesës për transferim fondesh buxhetore për DRAK (për likuidimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore të muajit Dhjetor 2016), në llogaritë ekonomike, si më poshtë vijon:

600-122,000 lekë;

601-120,000 lekë.

TOTAL=242,000 lekë

Nëpërmjet shkresës nr.549/1 prot., dt 07.02.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është dërguar miratimi i limitit mujor për DRAK, për shpenzimet korente në llogaritë ekonomike 600 dhe 602, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2

Limiti mujor i shpenzimeve për vitin 2017				
Nr.	Muaji	Llogaria Ekonomike		Total në lek
		600	602	
1	Janar	516.000	100.000	616.000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

2	Shkurt	516.000	100.000	616.000
3	Mars	516.000	100.000	616.000
4	Prill	516.000	100.000	616.000
5	Maj	516.000	100.000	616.000
6	Qershor	516.000	100.000	616.000
7	Korrik	484.000	100.000	584.000
8	Gusht	484.000	100.000	584.000
9	Shtator	484.000	50.000	534.000
10	Tetor	484.000	50.000	534.000
11	Nëntor	484.000	50.000	534.000
12	Dhjetor	484.000	50.000	534.000
TOTAL BUXHETI				7.000.000

Burimi: DRAK

Nëpërmjet shkresës nr.557/4 prot., dt 09.02.2017 nga MZHU-t është dërguar miratimi i kërkesës për transferim fondesh buxhetore për DRAK (për kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore, për punonjësit me kontratë të përkohshme), në llogaritë ekonomike, si më poshtë vijon:

600-3,465,000;

601-579,000.

TOTAL=4,044,000 lekë

Nëpërmjet shkresës nr.1593/4 prot., dt 24.04.2017 nga MZHU-t është dërguar miratimi i fondeve buxhetore për shpenzime kapitale për DRAK (për blerjen e pajisjeve për zyrat dhe pajisjeve elektronike), në llogarinë ekonomike, si më poshtë vijon:

231-1,200,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.1781 prot., datë 03.07.2017 nga DRAK është bërë kërkesë për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 826,098 lekë për tu përdorur për llogaritë ekonomike 600 dhe 601, e cila është miratuar nëpërmjet shkresës nr.5232 prot., datë 03.07.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t.

Në datën 29.06.2017 është njoftuar DRAK nëpërmjet rrugëve elektronike (email) për transferimin e fondeve në masën 30% të të ardhurave të realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore për periudhën Janar-Maj, për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 500,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.2077 prot., datë 31.07.2017 nga DRAK është bërë kërkesë për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 684,313 lekë për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600, e cila është miratuar nëpërmjet shkresës nr.6195 prot., datë 31.07.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t.

Nëpërmjet shkresës nr.6321 prot., datë 07.08.2017 është bërë transferimi i fondeve në masën 30% të të ardhurave të realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore për periudhën Korrik, për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 500,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.4208/3 prot., datë 10.08.2017 nga MZHUT është bërë miratimi i transferimit të fondeve për pagesën e pagave të punonjësve të DRAK në vlerën 200,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.4446/1, datë 24.08.2017 është bërë detajimi i Aktit Normativ nr.2, datë 16.08.2017, për shpenzimet korrente, për shtesat e bëra në llogaritë ekonomike 600 dhe 601 të DRAK, si më poshtë vijon:

600-400,000 lekë;

601-401,000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Nëpërmjet shkresës nr.6937 prot., datë 12.09.2017 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 316,409 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600.

Nëpërmjet shkresës nr.7286/1 prot., datë 02.10.2017 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 206,209 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600.

Nëpërmjet shkresës nr.8129/1 prot., datë 01.11.2017 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 228,000 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600.

Nëpërmjet shkresës nr.16148/81 prot., datë 05.12.2017 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është dërguar detajimi i fondeve për shpenzimet kapitale, në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 06.11.2017 për blerje pajisje zyresh dhe elektronike në vlerën 1,200,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.170 prot., datë 19.12.2017 është bërë kërkesa DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 144,548 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600.

Observacion: Me observacionin e bërë, nga z.Y.N (Drejtor i DRAK) dhe znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunës zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019), janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

DRAK është krijuar në datën 01.05.2016, dhe ka qenë e pamundur që të përgatitej projekt-buxheti për vitin 2017, i cili duhet të përgatitej në muajin Prill të vitit 2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit e merrë në konsideratë komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

Viti 2018 (hartimi dhe miratimi i buxhetit)

Për buxhetin e vitit 2018, në zbatim të Ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018" Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 1317/1 prot., datë 06.02.2018, ka dërguar detajimin e fondeve për shpenzimet korrente, për vitin 2018, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, dhe më pas është përcjellë me shkresën nr.1195 prot., datë 13.02.2018, pranë DRAK, i ndarë në llogaritë ekonomike si më poshtë vijon:

600-6,300,000 lekë;

601-880,000 lekë;

602-1,200,000 lekë.

TOTALI=8,380,000 lekë. (në krahasim me vitin 2017, janë miratuar 1,380,000 lekë më tepër, si pasojë e shtimit të shpenzimeve për paga dhe shpenzime operative).

Me shkresën nr.10/3 prot., datë 06.03.2018 dërguar nga Ministria e Drejtësisë është bërë detajimi i limitit mujor të cilin e kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3

Limiti mujor i shpenzimeve për vitin 2018				
Nr.	Muaji	Llogaria Ekonomike		Total në lek
		600	602	
1	Janar	900.000	100.000	1.000.000
2	Shkurt	600.000	100.000	700.000
3	Mars	550.000	100.000	650.000
4	Prill	550.000	100.000	650.000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

5	Maj	550.000	100.000	650.000
6	Qershor	550.000	100.000	650.000
7	Korrik	550.000	100.000	650.000
8	Gusht	550.000	100.000	650.000
9	Shtator	600.000	100.000	700.000
10	Tetor	600.000	100.000	700.000
11	Nëntor	600.000	100.000	700.000
12	Dhjetor	580.000	100.000	680.000
TOTAL BUXHETI				8,380,000

Burimi: DRAK

Nëpërmjet shkresës nr.2570/1 prot., datë 04.04.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 230,000 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6026100-200,000 lekë (shpenzime për qiramarrje ambjentesh);

6021007-30,000 lekë (shpenzime për libra dhe publikime profesionale).

Nëpërmjet shkresës nr.809 prot., datë 11.04.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 270,584 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6026100-270,584 lekë (shpenzime për qiramarrje ambjentesh).

Nëpërmjet shkresës nr.2927/1 prot., datë 17.04.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, transferimi i fondit për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë të përkohshme, si më poshtë vijon:

600-4,290,000 lekë;

601-720,000 lekë.

TOTAL=5,010,000 lekë

Nëpërmjet shkresës nr.3518/1 prot., datë 02.05.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 114,000 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6020900-200,000 lekë (shpenzime për furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme).

Me shkresën nr.5337 prot., datë 26.06.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, është përcjellë normativa e rishikuar, të cilën e kemi pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4

DREJTORIA	Nr. i përditësimeve në terren	Nr. i objekteve që do të kualifikohen	Normativa mujore e arkëtimeve		Normativa e lejeve të legalizimit
			Nr. faturash	Vlera (30% e të ardhurave nga parcela ndërtimore, lekë)	
Kavajë	170	150	40	1,260,000	150

Burimi: DRAK

Nëpërmjet shkresës nr.5510 prot., datë 03.07.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.1819, datë 29.06.2018, për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 200,000 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6020300-200,000 lekë (shpenzime për materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës).

Nëpërmjet shkresës nr.7135/1 prot., datë 13.09.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.2970, datë 11.09.2018, për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 200,000 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 601, si më poshtë vijon:

601-200,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.7624/1 prot., datë 03.10.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.2207, datë 01.10.2018, për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 925,169 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 600, si më poshtë vijon:

600-925,169 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr.9155/1 prot., datë 26.11.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.4066, datë 21.11.2018, për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 130,823 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6025800-12,000 lekë (Shpenzime për mirëmbajtjen e paisjeve të zyrave);

6029099-35,000 lekë (Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime speciale);

Nëpërmjet shkresës nr.9896/1 prot., datë 20.12.2018 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.4541, datë 18.12.2018, për rritje fondi nëpërmjet autorizimit buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 48,200 lekë, për tu përdorur për llogarinë ekonomike 602, si më poshtë vijon:

6021007-13,200 lekë (Shpenzime për njoftime);

6021099-10,000 lekë (Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative);

6022004-50,000 lekë (Shpenzime për postën dhe shërbimin korrier);

6026100-58,823 lekë (Shpenzime për qiramarrje ambjentesh).

Nga sa më sipër konstatohet se:

Në ish Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë nuk administrohet dokument mbi përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2018, duke mos siguruar edhe gjurmët e auditimit, në kundërshtim me Kap. I, pika 1.2, shkronja "a" dhe Kap. II, pika 2.1.2 dhe 2.1.3 të Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", me përcaktimet e bëra në Kap. 2, pika 7 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.3.2018 "Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin sistemin informatik financiar të qeverisë", si dhe me nenin 12, pika 2 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Pra nga DRAK nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar mbi planifikimin e nevojave për fonde buxhetore për vitin 2018.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.A.ç (Drejtor i ish DRAK, njëkohësisht edhe Nëpunësi autorizues i institucionit për periudhën 04.05.2017-16.11.2017), si dhe znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunësi zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019).

Viti 2019 (hartimi dhe miratimi i buxhetit)

Për buxhetin e vitit 2019, në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019" dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për dijeni të Ministris së Drejtësisë, me shkresën nr.22760/200 prot., datë 29.01.2019 është dërguar detajimin i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente për DRAK, i ndarë në llogaritë ekonomike si më poshtë vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

600-6,160,000 lekë;

601-1,030,000 lekë;

602-1,200,000 lekë.

TOTALI=8,390,000 lekë. (në krahasim me vitin 2018, buxheti i alokuar për DRAK për vitin 2019 ka rritje me 10,000 lekë).

Me shkresën nr.1878/1 prot., datë 22.02.2019 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.685 prot., datë 18.02.2019, për miratim rritje autorizim buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 111,954 lekë, për tu përdorur në llogaritë ekonomike si më poshtë vijon: 6022001-56,000 lekë (Shpenzime për energjinë elektrike); 6022004-55,954 lekë (Shpenzime për postën).

Me shkresën nr.2652/1 prot., datë 25.03.2019 është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, kërkesa e bërë nga DRAK me shkresën me nr.1064 prot., datë 13.03.2019, për miratim rritje autorizim buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet në vlerën 218,561 lekë, për tu përdorur në llogaritë ekonomike si më poshtë vijon: 6026100-218,561 lekë (Shpenzime për qiramarrje ambjentesh).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për vitin 2019 lidhur me planifikimin e buxhetit konstatohet se:

Në ish Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë nuk administrohet dokument mbi përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2019, në kundërshtim me Kap. I, pika 1.2, shkronja "a" dhe Kap. II, pika 2.1.2 dhe 2.1.3 të Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", si dhe me përcaktimet e bëra në KREUN 2, pika 2.5/2/5 shkronja "a-l" pikën 2.7/1-6 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", ku nga drejtuesi i ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë, nuk janë marrë masat për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programit buxhetor që drejton si dhe nuk janë respektuar procedurat ligjore për përgatitjen e kërkesave buxhetore për programin që drejton.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.Y.N (Drejtore i ish DRAK, njëkohësisht edhe Nëpunësi autorizues i institucionit për periudhën 29.01.2018-vazhdim), si dhe znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunës zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019).

Observacion: Me observacionin e bërë, nga znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunës zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019), janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

Për kërkesat buxhetore të vitit 2019, nga DRAK më datë 24.04.2018 është dërguar me email drejtuar sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, kërkesa e bërë për fonde buxhetore në artikullin 602.

Gjithashtu ish nëpunësi zbatues i DRAK, shprehet se në rregulloren e brendshme të miratuar me Urdhrin nr.117, datë 11.07.2015, përgjegjësinë për përgatitjen e projekt-buxhetit e ka Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merr në konsideratë komentin e bërë, për arsye se:

Në rradhë të parë aktet ligjore dhe nënligjore kanë një hierarki për sa i përket nivelit të zbatimit, ku në asnjë rast një rregullore e brendshme nuk ka fuqi ligjore mbi një Udhëzim, për më tepër për në rastin konkret ku Udhëzimi i referuar është i detyrueshëm për tu zbatuar për të gjithë nëpunësit autorizues dhe zbatues të të gjitha niveleve në institucionet publik, qofshin këto institucione qendrore apo në varësi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT “DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË”

Gjithashtu në asnjë prej dy Udhëzimeve të referuara në konstatimin e mësipërm nuk parashikohet në asnjë rast komunikimi apo pasqyrimi i kërkesave buxhetore nëpërmjet email-it, për më tepër të email-eve private, të nëpunësve të administratës publike.

Mbi zbatimin e buxhetit u konstatua:

Në vija të përgjithshme për periudhën 2016- 6 mujori I 2019 konstatohet se fondet e miratuara nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Drejtësisë, dhe të çelura nga thesari, janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh. Mbi bazën e të dhënave të DRAK është rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara për çdo muaj gjatë periudhës 2016- 6 mujori I 2019.

Sipas të dhënave nga DRAK, Sektori i Financës, rezulton se nga lejet e legalizimit të dhëna në vitet 2016 – Gusht 2019 dhe të rakorduar me thesarin, të ardhurat për:

Vitin 2016 janë në vlerën 13,459 mijë lekë dhe në vlerën 4,755 mijë bono privatizimi;

Vitin 2017 në vlerën 22,488 mijë lekë dhe bono thesari në vlerën 1,930 mijë lekë;

Vitin 2018 të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore janë në vlerën 38,831 mijë lekë dhe bono thesari në vlerën 1,030 mijë lekë;

Periudhën Janar-Gusht 2019 të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore janë në vlerën 3,642 mijë lekë.

Në tabelën e mëposhtme vërehet se të ardhurat nga tarifat e shërbimit të legalizimit, penalitete të ndryshme kanë patur vlera të larta në vitin 2017 dhe në periudhën Janar-Gusht 2019.

Tabela nr. 5

Të Ardhurat e DRAK për periudhën 2016 - Gusht 2019 (000 lekë)						
0	1	2	3	4	5	6
VITI	Parcela ndertimore		Tarifa Sherbimi	Penalitet	Penalitet për Leg. e shtesave	Të ardhurat (3+4+5)
	LEKE	BONO				
2016	13,459	4,755	336	158	0	494
2017	22,488	1,930	1,904	616	0	617,904
2018	38,831	1,030	3,684	219	367	589,684
01.01.19-31.08.19	3,642		1,112	388	251	640,112
TOTALI	78,420	7,715	7,036	1,381	618	1,848,194

Burimi: DRAK

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar buxhetin e alokuar dhe të realizuar nga DRAK, për periudhën 2016- 6 mujori I 2019, si dhe raportin e mbulimit të shpenzimeve të institucionit nga fondet e buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e realizuara nga institucioni, ku konstatohet se, nga shqyrtimi i korrespondencës shkresore midis Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t dhe DRAK, mbi alokimin e fondeve buxhetore (buxheti i shtetit + të ardhurat e aktivitetit të DRAK) për periudhën e mësipërme, kemi rritje të ndjeshme të buxhetit nga viti 2016 në vitin 2017, kjo për faktin se DRAK filloi të funksionojë si strukturë me buxhet më vete në muajin Qershor të vitit 2016, ku është bërë edhe transferimi i fondeve buxhetore dhe fondeve për shpenzime kapitale, si dhe nivel të ulët të realizimit të fondeve të alokuara për DRAK në vitin 2017 dhe 2018, në krahasim me periudhën tjetër.

Gjithashtu theksojmë se në asnjë prej viteve të mësipërme nuk janë përgatitur kërkesat për fonde buxhetore, si dhe artikulli me realizim të ulët është llogaria ekonomike 602 “shpenzime operative”.

Në mënyrë të detajuar në artikullin 602, peshën kryesore të fondeve për:

Vitin 2016 e zënë shpenzimet për materiale për zyrat (kancelari, bojë printeri, etj) në vlerën 448.834 lekë ose 54%, si dhe shpenzimet për mirëmbajtje të zakonshme për pajisjet e zyrave në vlerën 328.460 lekë ose rreth 40%;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Vitin 2017 e zënë e zënë shpenzimet për materiale për zyrat (kancelari, bojë printeri, etj) në vlerën 457.272 lekë ose 75%;

Vitin 2018 e zënë shpenzimet për materiale për zyrat (kancelari, bojë printeri, etj) në vlerën 883.217 lekë ose 43%, si dhe shpenzimet për qiramarrje ambjentesh për zyra në vlerën 520,584 lekë ose 25% të fondit të alokuar për llogarinë ekonomike 602;

Periudhën Janar-Qershor 2019 e zënë shpenzimet për materiale për qiramarrje ambjentesh për zyra në vlerën 420,588 lekë ose 52%, si dhe shpenzimet për energji elektrike, ujë, posta në vlerën 218,180 lekë ose 27% të fondit.

Tabela nr.5 Buxheti i DRAK plan-fakt në nivel artikulli (lekë)

Buxheti Plan-Fakt viti 2016				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2016			
				Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Emertimi	Plan	Fakt	%				
Paga shperblime (600)	7.016.105	7.006.452	99,9%	2.890.347	41%	4.119.105	59%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	1.071.499	1.071.272	100,0%	482.773	45%	588.499	55%
Mallra dhe sherbime te tjera (602)	842.900	836.952	99,3%	836.952	100%	0	0%
Shuma 600+601+602	8.930.504	8.914.676		4.210.072	47%	4.707.604	53%
INVESTIME 231	678.500	655.200	96,6%	655.200	100%	0	0%
Totali	9.609.004	9.569.876	99,6%	4.865.272	51%	4.707.604	49%

Viti 2017				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2017			
				Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Emertimi	Plan	Fakt	%				
Paga shperblime (600)	15.216.673	14.873.520	97,7%	9.243.847	62%	5.629.673	38%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	2.839.198	2.454.203	86,4%	1.714.005	70%	740.198	30%
Mallra dhe sherbime te tjera (602)	1.000.000	633.092	63,3%	633.092	100%	0	0%
Shuma 600+601+602	19.055.871	17.960.815		11.590.944	65%	6.369.871	35%
INVESTIME 231	1.200.000	807.600	67,3%	807.600	100%	0	0%
Totali	20.255.871	18.768.415	93%	12.398.544	66%	6.369.871	34%

Viti 2018				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2018			
				Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Emertimi	Plan	Fakt	%				
Paga shperblime (600)	14.905.169	13.346.985	89,5%	10.052.516	75%	3.295.469	25%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	2.300.000	2.217.151	96,4%	1.600.000	72%	617.151	28%
Mallra dhe sherbime te tjera (602)	2.193.607	2.060.480	93,9%	1.117.649	54%	942.831	46%
Shuma 600+601+602	19.398.776	17.624.616		12.770.165	72%	3.912.620	22%
INVESTIME 231	0	0		0		0	
Totali	19.398.776	17.624.616	91%	12.770.165	72%	3.912.620	22%

Janar-Qershor 2019				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2019			
				Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Emertimi	Plan	Fakt	%				
Paga shperblime (600)	6.590.000	4.983.916	75,6%	4.983.916	100%	0	0%
Kontributi i sigurimeve	1.320.000	1.001.469	75,9%	1.001.469	100%	0	0%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

shoqerore (601)							
Mallra dhe shërbime të tjera (602)	929.779	812.528	87,4%	482.749	59%	329.779	41%
Shuma 600+601+602	8.839.779	6.797.913		6.468.134	95%	329.779	5%
INVESTIME 231	0	0		0		0	
Totali	8.839.779	6.797.913	77%	6.468.134	95%	329.779	5%

Burimi: DRAK

Për vitin 2016 mbi zbatimin e buxhetit konstatohet se:

-Në urdhër shpenzimin nr.51, datë 29.12.2016 është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve për blerje centrali dhe telefoni analog, ku është përdorur llogaria ekonomike 602, ndërkohë që në këtë rast kemi të bëjmë me shtimin e aktiveve të institucionit, dhe shpenzimet duhet të ishin klasifikuar në llogarinë ekonomike 231.

-Në urdhër shpenzimin nr.54, datë 30.12.2016 është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve për riparim objekti, ku është përdorur llogaria ekonomike 602, ndërkohë që në këtë rast kemi të bëjmë me përmirësimin e vlerës së aktivitetit (mureve ndarës të zyrave) e cila është e matëshme, dhe shpenzimet duhet të ishin klasifikuar në llogarinë ekonomike 231.

-Në urdhër shpenzimin nr.42, datë 15.11.2016 është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve për riparimin e kompjuterit, ku është përdorur llogaria ekonomike 602, ndërkohë që në këtë rast kemi të bëjmë me përmirësimin e vlerës së aktivitetit (riparimin e bordit të PC) e cila është e matëshme, dhe shpenzimet duhet të ishin klasifikuar në llogarinë ekonomike 231.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra për SKK 5 të përmirësuara (trajtimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale) bazuar në Urdhrin nr.65, datë 5.5.2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar", i ndryshuar, me Kreun III, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.D.M (Nëpunës autorizues për periudhën 01.05.2016-12.12.2016), z.SH.D (Nëpunës autorizues për periudhën 12.12.2016-04.05.2017) dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Observacion: Me observacionin e bërë nga z.Y.N (Drejtor i DRAK) dhe znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunës zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019), janë bërë komente mbi konstatimet e mësipërme të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

DRAK nuk ka kompetencë për ndryshim apo tjetërsimin e fondeve buxhetore, por as të kalojë fonde nga të ardhurat detyësore në llogarinë 231. Gjithashtu në bazë të manualit "Për klasifikimin buxhetor ekonomik" dhe strukturës së shpenzimeve të miratuara nga Ministria e Financave, llogaria 602 "Furnizime dhe materiale të tjera zyre", ku përfshihen shpenzimet për blerjen e materialeve të zyrës, të cilat nuk janë të përfshira në llogaritë e tjera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merrë në konsideratë komentin e bërë, për arsye se:

DRAK si institucion varësie i Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNIT për periudhën e mësipërme, nëpërmjet kërkesës që drejtohet nga Nëpunësi Autorizues i institucionit, në këtë rast Drejtori i DRAK (Nëpunës Autorizues i nivelit të dytë) ndaj Nëpunësit Autorizues të nivelit më lartë sipas hierarkisë, mund të kërkohet që fondet buxhetore nga buxheti i shtetit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

alokuara në llogarinë ekonomike 602, të përdoren në një llogari tjetër ekonomike, pas marrjes së miratimit, referuar nenit 70, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Ky koment i bërë nga grupi i auditimit vlen edhe për obesrvacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.

-Nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit, në kundërshtim me:

- nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- pikën 256 të Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",
- nenin 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.SH.D në cilësinë e Nëpunësit autorizues të DRAK dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Procedura e marrjes në përdorim të ambjenteve të Pallatit të Kulturës për zyra për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë:

-Më datë 04.07.2016 ndërmjet Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë përfaqësuar nga Drejtori i Institucionit z.D.M dhe Bashkisë Kavajë përfaqësuar nga Kryetari i Institucionit z.E. Rr, është lidhur kontrata nr.1871 prot., me objekt "HUAPËRDORJE" të ambjenteve në Pallatin e Kulturës, pronësi e Bashkisë Kavajë, 4 zyra me sipërfaqe 161.3 m² në total, për përdorim të përkohshëm (01.05.2016-31.12.2016) të këtyre ambjenteve për zyra për Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë.

Në nenin 2, pika 5 e kësaj kontratë përcaktohet se huamarrësi ka detyrimin që të paguajë detyrimet e faturave të ujit dhe të energjisë elektrike përkatëse.

-Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar (urdhër shpenzimet, situacionin shpenzimeve për vitin 2016) të vënë në dispozicion nga DRAK për grupin e auditimit, rezulton se për periudhën (01.05.2016-31.12.2016) ose 8 muaj, nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë nuk janë paguar detyrimet për ujin dhe energjinë elektrike të konsumuar, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt dëm ekonomik.

Theksojmë se në këtë rast për arsye të mungesës së dokumentacionit që tregon sasinë e ujit dhe energjisë elektrike të konsumuar përgjatë kësaj periudhe, grupi i auditimit e ka të pamundur përllogaritjen e vlerës së dëmit të shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit, për të cilën do t'i kërkojë Drejtorit aktual të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kavajë z.Y.N, marrjen e masave për përllogaritjen e vlerës së dëmit të shkaktuar dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Përsa më sipër, bazuar në nenin 9 dhe 12 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe pikës 48 të Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", mbajnë përgjegjësi ligjore z.D.M në cilësinë e Nëpunësit autorizues të DRAK për periudhën 01.05.2016-12.12.2016, z.SH.D në cilësinë e Nëpunësit autorizues të DRAK për periudhën 12.12.2016-04.05.2017 dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Viti 2017 (zbatimi i buxhetit)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

-Për vitin 2017 është konstatuar se nuk janë realizuar të ardhurat nga transferimi i parcelës ndërtimore për muajin Janar, Korrik, Gusht, Shtator dhe Dhjetor, si dhe për muajin Nëntor nuk administrohet asnjë dokument mbi rakordin e të ardhurave me Degën e Thesarit Kavaj, sipas normativës së përcjellë me shkresën nr.4382 prot., dt.19.05.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, më konkretisht realizimin e të ardhurave për muajt e mësipërm, e kemi pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.6

Të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore (lekë)					
Nr.	Muaji	Të ardhurat e realizuara	Të ardhurat e përcaktuara sipas normativës	Diferenca	Realizimi në %
1	Janar	145.080	1.260.000	1.114.920	12%
2	Korrik	461.493	1.260.000	798.507	37%
3	Gusht	1.100.300	1.260.000	159.700	87%
4	Shtator	147.760	1.260.000	1.112.240	12%
5	Dhjetor	0	1.260.000	1.260.000	0%

Burimi: DRAK

Për mos realizimin e të ardhurave nga transferimi i parcelës ndërtimore sipas normativës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t për DRAK, mbajnë përgjegjësi z.SH.D (Drejtori i DRAK për periudhën 12.12.2016-04.05.2017), z.A.ç (Drejtori i DRAK për periudhën 04.05.2017-16.11.2017) dhe z.G.M (Drejtori i DRAK për periudhën 24.11.2017-29.01.2019).

-Në dy raste është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve në llogarinë 602, ndërkohë që duhet të ishte përdorur llogaria ekonomike 231, pasi kemi të bëjmë me shpenzime për riparimin e aktiveve të institucionit të DRAK, të cilat ndikojnë në përmirësimin e funksionimit dhe rritjen e jetëgjatësisë së tyre, konkretisht në urdhër shpenzimin nr.16, datë 16.03.2017 dhe urdhër shpenzimin nr.76, datë 12.12.2017.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra për SKK 5 të përmirësuara (trajtimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale) bazuar në Urdhrin nr.65, datë 5.5.2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar", i ndryshuar, me Kreun III, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore, z.SH.D (Nëpunës Autorizues për periudhën 12.12.2016-04.05.2017), z.G.M (Nëpunës Autorizues i DRAK për periudhën 24.11.2017-29.01.2019) dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-Nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit, në kundërshtim me:

- nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- pikën 256 të Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",
- nenin 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.G.M në cilësinë e Nëpunësit autorizues të DRAK dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Viti 2018 (zbatimi i buxhetit)

-Për vitin 2018 është konstatuar se nuk janë realizuar të ardhurat nga transferimi i parcelës ndërtimore për muajin Maj dhe Dhjetor, sipas normativës së rishikuar përcjellë me shkresën nr.5337 prot., datë 26.06.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, më konkretisht realizimin e të ardhurave për muajt e mësipërm, e kemi pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.7

Të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore (lekë)					
Nr.	Muaji	Të ardhurat e realizuara	Të ardhurat e përcaktuara sipas normativës	Diferenca	Realizimi në %
1	Maj	1.009.948	1.260.000	250.052	80%
2	Dhjetor	416.452	1.260.000	843.548	33%

Burimi: DRAK

Për mos realizimin e të ardhurave nga transferimi i parcelës ndërtimore sipas normativës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t për DRAK, mban përgjegjësi z.Y.N (Drejtore i DRAK).

-Në urdhër shpenzimit nr.106, datë 19.12.2018 është konstatuar keqklasifikim i shpenzimeve për riparim kompjuteri, ku është përdorur llogaria ekonomike 602, ndërkohë që në këtë rast kemi të bëjmë me përmirësimin e vlerës së aktivitetit të institucionit, dhe shpenzimet duhet të ishin klasifikuar në llogarinë ekonomike 231. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet e bëra për SKK 5 të përmirësuar (trajtimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale) bazuar në Urdhrin nr.65, datë 5.5.2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar", i ndryshuar, me Kreun III, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.Y.N (Nëpunës autorizues i DRAK) dhe Nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-Në dy raste është vepruar në kundërshtim me pikën nr.151, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe pikës 3, Kreu I, të Udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", për mosrespektimin e prioritetit të radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit, konkretisht janë konstatuar fatura të mbërritura në DRAK, për shpenzimet e energjisë elektrike, konkretisht:

- Fatura nr.253079441 në datë 28.05.2018-energji elektrike në vlerën 12968,80 lekë energji + 218,77 lekë kamatvornesë lekë, likujduar në datën 25.07.2019;
- Fatura nr.252068766 në datë 28.04.2018-energji elektrike në vlerën 11927,20 lekë energji + 555,88 lekë kamatvornesë lekë, likujduar në datën 25.07.2019;

Përsa më sipër mban përgjegjësi znj.B.Y Nëpunës zbatues.

-Për vitin 2018 nga DRAK janë drejtuar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t 6 kërkesa për fonde për miratim rritje autorizim buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifata e shërbimit dhe penalitetet, për kryerjen e shpenzimeve operative, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me nenin 45, të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe me pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-Nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit, në kundërshtim me:

- nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- pikën 89 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",
- nenin 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

-Në urdhër shpenzimin nr.109, datë 28.12.2018, për pagesën e pagave të punonjësve me kontratë, konstatohet se listë-pagesa nuk është e plotë me të dhënat e nevojshme, konkretisht për dy punonjësit znj.F.K dhe z.A.M, nuk janë pasqyruar numrat e llogarisë bankare, duke mos siguruar gjurmët e auditimit, për kryerjen e pagesës së këtyre punonjësve. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 69 dhe 71 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Procedura e marrjes me qira të ambjenteve në pronësi të personit privat për zyra për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë:

-Me Urdhër të brendshëm të Drejtorit të DRAK z.Y.N me nr.20 prot., datë 20.02.2018, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, me afat funksionimi 20.02.2018-31.12.2018, me përbërje:L.Ki, Kryetar,M.XH, Anëtar dhe F.M, Anëtar

-Nëpërmjet shkresës nga Përgjegjësja e sektorit të financës pranë DRAK, znj.B.Y, drejtuar Drejtorit të DRAK z.Y.N, më datë 21.03.2018, është bërë kërkesa për fillimin e procedurave për marrjen me qira të ambjenteve për zyra.

-Me Urdhër të Drejtorit të DRAK, nr.34 prot., datë 21.03.2018 është ngritur komisioni për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qira të ambjenteve për ecurinë normale të punës për Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, me përbërje:I.D, Kryetar, K.K, Anëtar dhe K.N, Anëtar

-Në dokumentin që mban datën 21.03.2018, i hartuar nga anëtarët e komisionit të ngritur me Urdhër nr.34 prot., datë 21.03.2018, janë hartuar kriteret e konkurimit si më poshtë:

- a) Objekti të jetë i përshtatshëm për ambjente zyre pa pasur nevoja që të kërkohen ndërhyrje të mëtejshme për punime rikonstruksioni dhe përshtatje nga ana e qiramarrësit.
- b) Objekti të jetë brenda territorit që mbulon Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë.
- c) Sipërfaqja që kërkohet do të jetë 200-250 m² . Është vendosur kjo sipërfaqe duke u bazuar në numrin e punonjësve që punojnë aktualisht, 21 punonjës.
- d) Objekti të ketë ambjente higjieno-sanitare.
- e) Qiradhënësi të disponojë dokument pronësie mbi objektin.
- f) Ambjenti të jetë me kushte të favorshme për ruajtjen e arkivës.
- g) Afati i marrjes me qira do të jetë nga data 03.04.2018-31.12.2018 me të drejtë ripërtëritje.
- h) Njoftimi do të publikohet në shtyp, në faqen eeb të Drejtorisë si dhe pranë Bashkisë Kavajë.
- i) Të interesuarit duhet të paraqesin ofertën ekonomike si dhe dokumentat që provojnë pronësinë e objektit deri më datë 27.03.2018, deri në orën 14.00 pranë zyrës së arkivës në adresën Sheshi Demokracia, Pallati i Kulturës Kavaljon, kati i dytë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

-Me Urdhrin e brendshëm të Drejtorit të DRAK nr.35 prot., datë 21.03.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra, me përbërje: B.Y, A.K dhe K.S.

Njoftimi është publikuar në gazetën "Panorama", në datën 23.03.2018 me përmbajtje si më poshtë:

- a) Objekti të jetë i përshtatshëm për ambjente zyre pa pasur nevoja që të kërkohen ndërhyrje të mëtejshme për punime rikonstruksioni dhe përshtatje nga ana e qiramarrësit.
- b) Objekti të jetë brenda territorit që mbulon Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë.
- c) Sipërfaqja që kërkohet do të jetë 200-250 m² . Është vendosur kjo sipërfaqe duke u bazuar në numrin e punonjësve që punojnë aktualisht, 21 punonjës.
- d) Objekti të ketë ambjente higjeno-sanitare.
- e) Qiradhënësi të disponojë dokument pronësie mbi objektin.
- f) Ambjenti të jetë me kushte të favorshme për ruajtjen e arkivës.
- g) Afati i marrjes me qera do të jetë nga data 03.04.2018-31.12.2018 me të drejtë ripërtëritje.
- h) Njoftimi do të publikohet në shtyp, në faqen ëeb të Drejtorisë si dhe pranë Bashkisë Kavajë.
- i) Të interesuarit duhet të paraqesin ofertën ekonomike si dhe dokumentat që provojnë pronësinë e objektit deri më datë 27.03.2018, deri në orën 14.00 pranë zyrës së arkivës në adresën Sheshi Demokracia, Pallati i Kulturës Kavaljon, kati i dytë.

-Në procesverbalin nr.1 të mbajtur më datë 27.03.2018, ora 14.00 nga anëtarët e KVO znj.B.Y, z.A.K dhe z.K.S, është bërë verifikimi dhe hapja e ofertave, ku rezulton vetëm një ofertues, personi privat z.E.K, dhe dokumentat e dorëzuar në këtë ofertë janë:

1. Oferta Financiare
2. Kopje e certifikatës së pronësisë, e lëshuar për z.E.K më datë 07.02.2016 nr.187 për pasurin me nr. 4/233 në zonën kadastrale 8552, e llojit truall me sipërfaqe 110 m² , nga kjo ndërtesa me sipërfaqe 110 m² .
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Planimetria e Objektit

-Në procesverbalin nr.2, i mbajtur më datë 27.03.2018 nga anëtarët e KVO znj.B.Y, z.A.K dhe z.K.S, është bërë shpallja e fituesit të kësaj procedure z.E.K.

-Më datën 03.04.2018 është bërë lidhja e kontratës së qirasë me nr.603 Rep., nr.327 Kol., ndërmjet palëve për dhënie qira pasurinë me sipërfaqe 211.6 m² , kundrejt pagesës nga ana e qiramarrësit të çmimit të qirasë **58,823 lekë** (50,000 lekë pagesa neto e qirasë + 8,823 lekë tatimi mbi fitimin në masën 15%), për një afat 8 muaj me të drejtë rinovimi, pra në total nga DRAK për ambjentet e marra me qera do të paguhet **470,584 lekë**.

-Bashkangjitur kësaj kontrate gjendet dokumentacioni: 1.Planimetria e katit të dytë; Vërtetimi i lëshuar nga DRAK më datë 23.03.2018, ndaj shtetases A.K, e cila ka aplikuar për legalizimin e objektit pa leje me vetëdeklarimin nr.2222 prot., datë 10.11.2006 me funksion social-ekonomik të ndodhur në Kavajë.

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme dhe dokumentacionit që administrohet nga DRAK për marrjen me qira të ambjenteve nga shtetasi z.E.K, konstatohet se:

-Urdhri i brendshëm i Drejtorit të DRAK, nr.34 prot., datë 21.03.2018 për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qera të ambjenteve për ecurinë normale të punës për Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë dhe Urdhri i brendshëm i Drejtorit të DRAK, nr.35 prot., datë 21.03.2018 për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra, nuk kanë bazë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

ligjore mbështetëse, dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 99, pika 2, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", mbi kërkesat e formës që duhet të plotësojë akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik.

-Ofertuesi i shpallur fitues nga anëtarët e komisionit të ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.35 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra" është bërë në kundërshtim me kriteret e hartuara në dokumentin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 34 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qera", pasi shtetasi z.E.K, disponon dokument pronësie vetëm për sipërfaqen 110 m² dhe jo për sipërfaqe 200-250 m² siç përcaktohet në kriteret fituese, ndërkohë që kontrata e lidhur ndërmjet palëve të cituara më sipër, në datën 03.04.2018 me nr.603 Rep., nr.327 Kol, përfshin edhe ambjentin me sipërfaqe 101.6 m², pasuri për të cilën nuk disponohet dokument pronësie, dhe si pasojë e këtyre veprimeve fondet e shpenzuara për hapsirën 101.6 m² (58,823 lekë fondi total i kontratës për 8 muaj / 211.6 m² sipërfaqe = 277.9 lekë për m² * 101.6 m² = 28,234 lekë * 8 muaj = 225,872 lekë) në vlerën **225,872 lekë** do të konsiderohen mospërdorim me efektivitet i fondeve publike.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të ngritur me Urdhrin e brendshëm të Drejtorit të DRAK, nr.35 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra", znj.B.Y, z.A.K dhe z.A.K.

Observacion: *Me observacionin e bërë me shkresën nr.6100/3/5, shkresën 6104/6, datë 13.11.2018, administruar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga z.Y.N (Drejtor i DRAK), znj.B.Y (Përgjegjëse e komanduar e sektorit të financës pranë ish DRAK dhe njëkohësisht Nëpunës zbatues i institucionit për periudhën 10.05.2016-15.08.2019), shkresën nr.6104/2, datë 12.11.2019 nga z.K.S, shkresën nr.6104/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D, z.K. N dhe z.K.K, janë bërë komente mbi konstatimet e mësipërme të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:*

Z.Y.N është shprehur se kjo procedurë nuk është bazuar në Ligjin nr.9634, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe se konstatimet të cilat i janë referuar këtij ligji nuk qëndrojnë. Gjithashtu është shprehur se ofertuesi i shpallur fitues disponon dokument pronësie për sipërfaqen 110 m² dhe për pjesën tjetër prej 101.6 m² nuk ka dokument pronësie por ka qenë i pajisur me vërtetimin që është në proces legalizimi dhe posedon këtë objekt, si dhe në bazë të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, deklaruesi njihet si posedues i objektit ku ka të drejtën e dhënies me qera dhe tjetërsimin e pronës.

Realizimi i procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra është në kopetencë të zyrës sonë, referohu dispozitave të Kodit Civil për qeran e pasurive të paluajtshme dhëe me ankand.

Znj.B.Y është shprehur se kjo procedurë nuk është bazuar në Ligjin nr.9634, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe se konstatimet të cilat i janë referuar këtij ligji nuk qëndrojnë. Gjithashtu është shprehur se ofertuesi i shpallur fitues disponon dokument pronësie për sipërfaqen 110 m² dhe për pjesën tjetër prej 101.6 m² nuk ka dokument pronësie por ka qenë i pajisur me vërtetimin që është në proces legalizimi dhe posedon këtë objekt, si dhe në bazë të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, deklaruesi njihet si posedues i objektit ku ka të drejtën e dhënies me qera dhe tjetërsimin e pronës. Realizimi i procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra është në kopetencë të zyrës sonë, referohu dispozitave të Kodit Civil për qeran e pasurive të paluajtshme.



Z.K.S është shprehur se kjo procedurë nuk është bazuar në Ligjin nr.9634, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe se konstatimet të cilat i janë referuar këtij ligji nuk qëndrojnë. Gjithashtu është shprehur se ofertuesi i shpallur fitues disponon dokument pronësie për sipërfaqen 110 m² dhe për pjesën tjetër prej 101.6 m² nuk ka dokument pronësie por ka qenë i pajisur me vërtetimin që është në proces legalizimi dhe posedon këtë objekt, si dhe në bazë të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, deklaruesi njihet si posedues i objektit ku ka të drejtën e dhënies me qera dhe tjetërsimin e pronës. Realizimi i procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra është në kompetencë të zyrës sonë, referohu dispozitave të Kodit Civil për qeran e pasurive të paluajtshme.

Znj. I.D, z.K.N dhe z.K.K janë shprehur se në lidhje me urdhrat nr.34 dhe nr.35, datë 21.03.2018 nuk janë përpiluar nga specialistja I.D por nga punonjës tjetër (Bashkangjitur kopje e librit të protokollit).

Në lidhje me procedurën e marrjes me qera, me urdhrin nr.34, datë 21.03.2018 si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, komisioni hartoi kriteret e konkurimit, proceverbalin e fondit limit, si dhe publikimin e njoftimit të procedurës. Përsa i përket personave përgjegjës për procedurën janë ata të ngritur me Urdhrin nr.35, datë 21.03.2018. Ky trajtim është bërë edhe për ripërsëritjen e kësaj procedure në vitin 2019.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit e merrë në konsideratë pjesërisht komentin e bërë, për arsye se:

Si fillim theksojmë se nga observacionet e bëra nga personat e mësipërm, vihet re mungesë koordinimi, sepse 3 prej tyre e përmendin kuadrin rregullator të prokurimeve publike si referencë dhe 3 të tjerë e përjashtojn atë. Ndodhur në kushtet ku në asnjë prej urdhërave të nxjerrë nga titullari i institucionit nuk ka bazë ligjore mbështetëse për kryerjen e kësaj procedure, grupi i auditimit e gjykon që konstatimet e tij, të cilat kanë si referencë ligjore kuadrin rregullator të prokurimit publik, mos ti pasqyrojë në auditimin e çështjes përkatëse.

Lidhur me kuadrin ligjor të cituar nga 3 prej punonjësve të DRAK (Kodi Civil, Ligji për legalizimin), theksojmë se, grupi i auditimit në nxjerrjen e konkluzioneve nëse procedura e mësipërme është krijuar dhe zbatuar në përputhje me kuadrin ligjor, i referohet vetëm dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe përmbajtjes së tij, çka do të thotë se në kriteret e përcaktuar për shpalljen e fituesit të kësaj procedure, dhe që më pas do të nënshkruhej kontrata, në pikën 5, nga 9 kriteret në total, thuhet shprehimisht: "Qiradhënësi të disponojë dokument pronësie mbi objektin".

Nga sa më sipër theksojmë se referenca ligjore e përdorur nga 3 punonjësit nuk është e plotë, për arsye se nuk citohet konkretisht neni dhe pika përkatëse e Kodit Civil dhe Ligjit për legalizimin, si dhe në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur që ky institucion nuk ka të drejtën që të zhvillojë procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra, gjë të cilën e kanë përmendur si kompetencë të zyrës sonë.

Viti 2019 (zbatimi i buxhetit)

Ripërsëritja e Procedurës së marrjes me qira të ambjenteve për zyra

-Procedura e marrjes me qira të ambjenteve për zyra nga DRAK, është ripërsëritur edhe dy herë të tjera pas përfundimit të kontratës së parë, por në këtë rast është bërë ndryshimi i vlerës së kontratës, ku cmimi i mëparshëm 58,823 lekë për sipërfaqen 211.6 m², bëhet 82,353 lekë (70,000 lekë pagesa neto e qirasë + 12,353 lekë tatimi mbi fitimin në masën 15%), konkretisht:

-Më datë 19.11.2018 ndaj DRAK është dërguar kërkesa nga shtetasi z.E.K, e protokolluar pranë zyrës së protokollit në DRAK me nr.4027 prot., datë 19.11.2018, në të cilën, kërkohet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

rritja e çmimit të qirasë së ambjenteve të marra për zyra, dhe vlera e mëparshme prej 58,823 lekë për sipërfaqen 211.6 m², të bëhet 82,353 lekë po për të njëjtën sipërfaqe.

-Më datë 21.11.2018 nga DRAK është drejtuar shkresa me nr.4067 prot., ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t me lëndë "Kërkesë për miratim", ku nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë, kërkohet që të miratohet fondi për ripërsëritjen e procedurës së marrjes me qira të ambjenteve për zyra, por në këtë rast me ndryshimin e çmimit të kontratës.

-Me shkresën nr.4067/1 prot., datë 06.12.2018 pranë zyrave të protokollit të DRAK, është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, ku miratohet ripërsëritja e procedurës së mëparshme për marrjen me qira të ambjenteve për zyra.

-Nëpërmjet shkresës "MEMO" nga Përgjegjësjë e sektorit të financës pranë DRAK, znj.B.Y, drejtuar Drejtorit të DRAK, më datë 10.12.2018, është bërë kërkesa për rifillimin e procedurave për marrjen me qira të ambjenteve për zyra.

-Në këtë dosje administrohet një shkresë me lëndë "Njoftim" e cila nuk ka datë, as vulën e institucionit, si dhe nuk tregohet se ku është vendosur ky njoftim, ka përmbajtjen si më poshtë vijon:

- a) Objekti të jetë i përshtatshëm për ambjente zyre pa pasur nevoja që të kërkohen ndërhyrje të mëtejshme për punime rikonstruksioni dhe përshtatje nga ana e qiramarrësit.
- b) Objekti të jetë brenda territorit që mbulon Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë.
- c) Sipërfaqja që kërkohet do të jetë 200-250 m².
- d) Objekti të ketë ambjente higjeno-sanitare.
- e) Qiradhënësi të disponojë dokument pronësie mbi objektin.
- f) Ambjenti të jetë me kushte të favorshme për ruajtjen e arkivës.
- g) Afati i marrjes me qera do të jetë nga data 01.01.2019-31.12.2019 me të drejtë ripërtëritje.
- h) Njoftimi do të publikohet në shtyp, në faqen eeb të Drejtorisë si dhe pranë Bashkisë Kavajë.
- i) Të interesuarit duhet të paraqesin ofertën ekonomike si dhe dokumentat që provojnë pronësinë e objektit deri më datë 18.12.2018, deri në orën 14.00 pranë zyrës në adresën Sheshi Demokracia, Bulevardi Kryesor, kati i dytë (pranë zyrave të ZVRPP Kavajë).

-Në datën 14.12.2018 nga shtetasi z.E.K, është drejtuar oferta për çmimin e ambjenteve për zyra për marrjen me qira nga DRAK, në vlerën 82,353 lekë, e cila është protokolluar pranë zyrës së protokollit të DRAK me nr.4602 prot., datë 17.12.2018.

-Në procesverbalin nr.1 të mbajtur më datë 20.12.2018 me nr.4067/4 prot., ora 14.00 nga anëtarët e KVO znj.B.Y, z.A.K dhe z.K.S, është bërë verifikimi dhe hapja e ofertave, ku rezulton vetëm një ofertues, shtetasi z.E.K, dhe dokumentat e dorëzuar në këtë ofertë janë:

1. Oferta Financiare
2. Kopje e certifikatës së pronësisë, e njëjta më çertifikatën e dorëzuar në procedurën e parë.
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Planimetria e Objektit

-Në procesverbalin nr.2, të mbajtur më datë 20.12.2018 me nr.4067/4 prot., nga anëtarët e KVO znj.B.Y, z.A.K dhe z.K.S, është bërë shpallja e fituesit të kësaj procedure, shtetasit z.E.K.

-Më datën 04.01.2019 është bërë lidhja e kontratës së qirasë me nr.21 Rep., nr.18 Kol., ndërmjet palëve për dhënien qira pasurinë me sipërfaqe 211.6 m², kundrejt pagesës nga ana e qiramarrësit të çmimit të qirasë **82,353 lekë** (70,000 lekë pagesa neto e qirasë + 12,353 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

tatimi mbi fitimin në masën 15%), për një afat 3 muaj me të drejtë rinovimi, pra në total nga DRAK për ambjentet e marra me qera do të paguhet **247,059 lekë**.

-Më datën 03.04.2019 është bërë lidhja e kontratës së qirasë me nr.830 Rep., nr.453 Kol., ndërmjet palëve, për dhënien qira pasurinë me sipërfaqe 211.6 m², kundrejt pagesës nga ana e qiramarësit të çmimit të qirasë 82,353 lekë (70,000 lekë pagesa neto e qirasë + 12,353 lekë tatimi mbi fitimin në masën 15%), për një afat 1 muaj me të drejtë rinovimi.

Nga shqyrtimi i procedurës së mësipërme dhe dokumentacionit që administrohet nga DRAK për marrjen me qira të ambjenteve nga shtetasi z.E.K, konstatohet se:

-Ofertuesi i shpallur fitues nga anëtarët e komisionit të ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.35 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumentave dhe cmimeve mbi marrjen me qira të ambjenteve për zyra" është bërë në kundërshtim me kriteret e hartuara në dokumentin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr.34 prot., datë 21.03.2018 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumentave dhe kriterëve për marrjen me qera", pasi shtetasi z.E.K, disponon dokument pronësie vetëm për sipërfaqen 110 m² dhe jo për sipërfaqe 200-250 m² siç përcaktohet në kriteret fituese, ndërkohë që kontratat e lidhura ndërmjet palëve të cituara më sipër, në datën 04.01.2018 me nr.21 Rep., nr.18 Kol dhe datën 03.04.2019 me nr.830 Rep., nr.453 Kol, përfshin edhe ambjentin me sipërfaqe 101.6 m², pasuri për të cilën nuk disponohet dokument pronësie, dhe si pasojë e këtyre veprimeve fondet e shpenzuara për hapsirën 101.6 m² (82,353 lekë fondi total i kontratës për 4 muaj / 211.6 m² sipërfaqe = 389.1 lekë për m² * 101.6 m² = 39,532 lekë * 4 muaj = 158,128 lekë) në vlerën **158,128 lekë** do të konsiderohen mospërdorim efektiv të fondeve publike.

-Për periudhën Janar-Qershor 2019 është konstatuar se nuk janë realizuar të ardhurat nga transferimi i parcelës ndërtimore për muajt Janar-Korrik, me përjashtim të muajit Gusht, ku është tejkualuar realizimi i të ardhurave nga parcela ndërtimore, sipas normativës së rishikuar përcjellë me shkresën nr.5337 prot., datë 26.06.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, më konkretisht realizimin e të ardhurave për muajt e mësipërm, e kemi pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.7

Të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore (lekë)					
Nr.	Muaji	Të ardhurat e realizuara	Të ardhurat e përcaktuara sipas normativës	Diferenca	Realizimi në %
1	Janar	0	1.260.000	1.260.000	0
2	Shkurt	652,104	1.260.000	607,896	52%
3	Mars	0	1.260.000	1.260.000	0
4	Prill	378,692	1.260.000	881,308	30%
5	Maj	0	1.260.000	1.260.000	0
6	Qershor	487,344	1,260,000	772,656	29%
7	Korrik	831,107	1,260,000	428,893	65%
8	Gusht	1,292,832	1,260,000	32,832	102.6%

Burimi: DRAK

Pika nr.3 e Raportit të Auditimit;; "Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës".

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr.577/1, datë 13.08.2019 ndryshuar me programin 577/2, datë 24.09.2019, u shqyrtua dokumentacioni që lidhet me:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

- Strukturën dhe organikën e miratuar për punonjësit definitiv të DRAK, si dhe VKM për përcaktimin e numrit të punonjësve të përkohshëm për vitet 2016/17/18/ 6 mujori I – 2019;
- Urdhër shpenzimet si dhe dokumentacionin justifikues (listë-pagesat, prezenca), për pagesën e pagave dhe të sigurimeve shoqërore, shëndetësore si dhe tatimit mbi të ardhurat;
- Përputhjen e llojit dhe nivelit të arsimimit të punonjësve definitiv të DRAK, me kërkesat e pozicionit të punës.
- Vendime të komisionit të shërbimit civil dhe të gjykatave me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet e publike për një pozicion pune paguhen njëkohësisht dy persona.

Në vija të përgjithshme, nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm për periudhën 2016-Gusht 2019, rezultoi:

Nga krahasimi që ju bë listë-pagesave, urdhër shpenzimeve, nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga për periudhën e audituar. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listë-prezencat si dhe urdhrat e veçantë të titullarit. Janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listë-prezencat dhe urdhër-shpenzimet për paga, si dhe urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga Dega e Thesarit Kavajë.

Për gjithë punonjësit me kontratë janë hapur dosje me të dhënat e domosdoshme për arsimin, kualifikimet, CV, certifikatat personale, librezat e punës, kontratat e lidhura me punëdhënësin, shkresat e emërimit sipas periudhave si dhe dokumentet e tjera plotësuese të dosjes sipas VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes së personeli".

Kontratat për punonjësit me afat të caktuar dhe të atyre pa afat janë lidhur në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Marrja në punë dhe përcaktimi i pozicionit dhe nivelit të pagës të punonjësve si me kontratë më kohë të pacaktuar dhe me kontratë të përkohshme është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t.

Në përlllogaritjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të përballuara nga punëmarrësi dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7770, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Tabela nr.1 Numri i punonjësve për DRAK gjatë periudhës 2016-Qershor 2019

Nr.	Emërtimi	2016		2017		2018		2019	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Punonjës me kontratë pa afat	7	7	7	7	7	6	7	6
2	Punonjës me kontratë me afat të caktuar	16	13	20	15	17	17	11	11
	Gjithsej	23	20	27	22	24	23	18	17

Burimi: DRAK

Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së ALUIZNI-t Kavajë

Drejtorja e ALUIZNI-t Kavajë organizohet dhe funksionon në zbatim të VKM nr. 289, datë 17.5.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të zonave/Ndërtimeve informale (ALUIZNI)", të ndryshuar, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t si dhe Drejtorive Rajonale të saj përcaktohen me rregulloren e brendshme miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Zhvillimit Urban nr.117, datë 14.07.2015. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e DRAK rregullohen sipas Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Për vitin 2016 Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë ka në strukturën e miratuar me Urdhrin nr.58, datë 05.04.2016, të Kryeministrit, gjithsej 7 punonjës me kontratë me afat të pacaktuar, me përbërje si më poshtë:

Tabela nr.2

Organika e DRAK 2016	
Pozicioni	Numri
Drejtor	1
Spektori i Legalizimit dhe Planifikimit Urban	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Hartografisë, përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	(2)
<i>Specialist</i>	1
<i>Arkivist Protokollist</i>	1
Punonjës gjithsej	7

Burimi: DRAK

Për punonjësit me kontratë me afat të pacaktuar niveli i pagës dhe kategoria në të cilën bëjnë pjesë përcaktohet në Kreun I, pika 13/4, lidhja 9/4 e VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Nëpunësve civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë (2) prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave/kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si më poshtë:

Tabela nr.3

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në Drejtorinë Rajonale, të ALUIZNI-t			
Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Drejtor i Drejtorisë	III-B	1	16.500
Përgjegjës Spektori	IV-a	1	10.000
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3	10.000

Burimi: DRAK

Për vitin 2016 me shkresën 5127/1, datë 29.06.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është dërguar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për periudhën prill-dhjetor 2016, në zbatim të VKM nr.23, datë 20.01.2016 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2016, në njësitë e qeverisjes qendrore", i ndryshuar, ku për DRAK është përcaktuar numri 8 total i punonjësve, 7 specialist dhe 1 teknik i mesëm.

Gjithashtu me shkresën nr.5205/1, datë 29.06.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është dërguar shtesë në numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme, gjithsej 8 punonjës (7 specialist dhe 1 teknik i mesëm). Në total numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 është 16, dhe të punësuar efektivisht janë 13.

Në pikën 6 të VKM nr.23 përcaktohet se efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për paga për punonjësit e përkohshëm përballohen pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga të ardhurat që realizon institucioni.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT “DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË”

Për punonjësit me kontratë të përkohshme, me pozicionin specialist, niveli i pagave është përcaktuar në kategorinë IV-b sipas VKM nr. 589, datë 17.7.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurime së përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit”.

Për teknikët e mesëm të punësuar me kontratë të përkohshme, niveli i pagës është bazuar në përcaktimin e bërë në VKM nr. 610 datë 24.07.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” pika 1/b, kategorisë VI të lidhjes II.

Në total për vitin 2016 në organikën e DRAK të punësuar efektivisht kanë qenë **20** punonjës, **7** punonjës me kontratë me afat të pacaktuar, si dhe **13** punonjës me kontratë të përkohshme nga 16 të miratuar.

Nga verifikimi i listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve për pagat për vitin 2016 rezulton se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve me kontratë pa afat si dhe të atyre me kontratë të përkohshme, referuar organikës së miratuar të DRAK dhe shkresave nr.5127/1 dhe 5205/1 për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve si dhe akt-rakordimet e shpenzimeve me degën e thesarit Kavajë, rezulton se shpenzimet për paga janë mbuluar në masën 41% nga buxheti i shtetit dhe 59% nga të ardhurat që ka realizuar DRAK, në përputhje me pikën 6 të VKM nr.23, datë 20.01.2016 “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2016, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar (pasqyruar në tabelën nr.6)

Për vitin 2017 me shkresën 6974/3, datë 23.01.2017 nga Ministria e Zhvillimit Urban është dërguar numri i punonjësve me kontratë me afat të pacaktuar, i cili nuk ka ndryshuar nga viti 2016, ku numri i punonjësve është 7.

Tabela nr.4

Organika e DRAK 2017	
Pozicioni	Numri
Drejtor	1
Spektori i Legalizimit dhe Planifikimit Urban	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Hartografisë, përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	(2)
<i>Specialist</i>	1
<i>Arkivist Protokollist</i>	1
Punonjës gjithsej	7

Burimi: DRAK

Me shkresën nr.1063/1, datë 17.02.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t është dërguar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në zbatim të VKM nr.7, datë 11.01.2017 “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, ku për DRAK është përcaktuar numri i punonjësve, 18 në total, 14 specialist, 3 teknik të mesëm dhe 1 sanitar.

Gjithashtu me shkresën nr.2807/1, datë 24.05.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, në zbatim të VKM nr.251, datë 29.03.2017 për disa ndryshime në VKM nr.7, datë 11.01.2017 “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore”, është dërguar shtesë në numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

konkretisht është shtuar 1 specialist dhe 1 teknik i mesëm, pra në total 15 specialist, 4 teknik të mesëm dhe 1 sanitar.

Në pikën 5 të VKM nr.7 përcaktohet se efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për paga për punonjësit e përkohshëm përballohen pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga të ardhurat që realizon institucioni.

Për vitin 2017 të punonjës me kontratë të përkohshme, rezultojnë efektiv 15 nga 20 të parashikuar.

Për periudhën Mars-Dhjetor 2017 për punonjësit me kontratë me afat të pacaktuar niveli i pagës dhe kategoria në të cilën bëjnë pjesë përcaktohet VKM nr.187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Nëpunësve civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë (2) prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave/kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit".

Në total për vitin 2017 në organikën e DRAK të punësuar efektivisht kanë qenë 22 punonjës, 7 punonjës me kontratë me afat të pacaktuar, si dhe 15 punonjës me kontratë të përkohshme nga 20 të miratuar.

Nga verifikimi i listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve për pagat për vitin 2017 rezulton se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve me kontratë pa afat si dhe të atyre me kontratë të përkohshme, referuar organikës së miratuar të DRAK dhe shkresave nr. 1063/1 dhe 2807/1 për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve si dhe akt-rakordimet e shpenzimeve me degën e thesarit Kavajë, rezulton se shpenzimet për paga janë mbuluar në masën 62% nga buxheti i shtetit dhe 38% nga të ardhurat që ka realizuar DRAK, në përputhje me pikën 5 të VKM nr.7, datë 11.01.2017 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore", i ndryshuar (pasqyruar në tabelën nr.6).

Për vitin 2018 me shkresën 17911/1, datë 20.02.2018 nga Ministria e Drejtësisë është dërguar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në zbatim të VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në njësitë e qeverisjes qendrore", i ndryshuar, ku për DRAK është përcaktuar numri 14 total i punonjësve, 11 specialist, 2 teknikë të mesëm dhe 1 sanitar.

Për periudhën Janar-Mars 2018 referuar pikës 7 të VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në njësitë e qeverisjes qendrore", efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për pagat për punonjësit me kontratë të përkohshëm do të mbulohet pjesërisht nga fondet e buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e realizuara nga DRAK.

Për periudhën Prill-Qershor 2018 referuar Kreut II të VKM Nr. 209, datë 20.4.2018 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në njësitë e qeverisjes qendrore", efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për pagat për punonjësit me kontratë të përkohshëm do të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit.

Për periudhën Korrik-Dhjetor 2018 referuar pikës 2 të VKM nr.463, datë 26.07.2018 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2018, në njësitë e qeverisjes qendrore", hyrë në fuqi më datë 01.08.2018, efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për pagat për punonjësit me kontratë të përkohshëm do të mbulohen plotësisht nga të ardhurat e realizuara nga DRAK.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Observacion: Me shkresën nr.6108/4 prot., datë 13.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga z.Y.N (Drejtor i DRAK), si dhe nga znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht pagesat e mësipërme janë kryer duke përdorur fondin e celur me anë të shkresës nr.2927/1, datë 17.04.2018, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, (bashkëlidhur shkresa).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

Në total për vitin 2018 në organikën e DRAK të punësuar efektivisht kanë qenë 23 punonjës, 6 punonjës me kontratë me afat të pacaktuar, si dhe 17 punonjës me kontratë të përkohshme nga 17 të miratuar.

Për periudhën Janar-Gusht 2019 me shkresën 833/2, datë 21.02.2019 nga Ministria e Drejtësisë është dërguar numri i punonjësve me kontratë me afat të pacaktuar për vitin 2019, ku për DRAK është përcaktuar numri 7 total i punonjësve, duke mos patur ndryshime në krahasim me vitin e mëparshëm.

Tabela nr.4

Organika e DRAK Janar-Maj 2019	
Pozicioni	Numri
Drejtor	1
Spektori i Legalizimit dhe Planifikimit Urban	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Hartografisë, përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë	(2)
<i>Specialist</i>	2
Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	(2)
<i>Specialist</i>	1
<i>Arkivist Protokollist</i>	1
Punonjës gjithsej	7

Burimi: DRAK

Gjithashtu me shkresën nr.21060/90, datë 07.02.2019, në zbatim të VKM nr.16, datë 16.01.2019 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore" nga Ministria e Financave është dërguar numri i punonjësve me kontratë me afat të përkohshëm, ku për DRAK është përcaktuar numri 12 në total, me përbërje 9 specialist, 2 teknik të mesëm dhe 1 sanitar.

Në zbatim të pikës 6 të VKM nr.16, datë 16.01.2019 "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore", efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për pagat për punonjësit me kontratë të përkohshëm do të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore, të punonjësve të DRAK me kontratë të përkohshme, për periudhën Janar-Maj rezulton se efektet financiare për shpenzimet e pagave, janë mbuluar nga fondet e buxhetit të shtetit.

Nga verifikimi i listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve për pagat për periudhën Janar-Maj 2019 rezulton se nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve me kontratë pa afat si dhe të atyre me kontratë të përkohshme, referuar organikës së miratuar të DRAK dhe shkresave nr. 833/2 dhe 21060/90 për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Në total për periudhën Janar-Qershor të punësuar efektiv në DRAK, rezultojnë **18** punonjës.

Me shkresën nr.4830 prot., datë 13.05.2019, është përcjellë Urdhri i Kryeministrit nr.84, datë 02.05.2019, për miratimin e strukturës dhe organikës, si dhe me VKM nr.245, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

24.04.2019 është bërë miratimi i nivelit të pagave dhe shtesave për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kavajë me përbërje si më poshtë vijon:

Tabela nr.5

Organika e DRASHK Maj-Vazhdim 2019		
Pozicioni	Kategoria	Numri
Drejtor	III-a	1
Zv.Drejtor	III-a/1	1
Sektori i Legalizimit dhe Planifikimit Urban		(5)
<i>Përgjegjës sektori</i>	III-b	1
<i>Specialist</i>	IV-b	4
Sektori i Çështjeve Juridike dhe të Pronësisë		(4)
<i>Specialist</i>	IV-b	4
Sektori i Shërbimeve të Sportelit dhe Kadastrës		(5)
<i>Përgjegjës sektori</i>	III-b	1
<i>Specialist</i>	IV-b	4
Sektori i Kadastrës dhe Hartografisë		(5)
<i>Përgjegjës sektori</i>	III-b	1
<i>Specialist</i>	IV-b	4
Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse		(4)
<i>Përgjegjës</i>	III-b	1
<i>Specialist</i>	IV-b	3
Punonjës gjithsej		25

Burimi: DRAK

Tabela nr.6 Raporti i mbulimit të shpenzimeve të DRAK, (Buxheti i shtetit+Të ardhurat e veta) për periudhën 2016 - Qershor 2019

Buxheti Plan-Fakt viti 2016				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2016			
Emertimi	Plan	Fakt	%	Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Paga shperblime (600)	7.016.105	7.006.452	99,9%	2.890.347	41%	4.119.105	59%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	1.071.499	1.071.272	100,0%	482.773	45%	588.499	55%
Shuma 600+601							
Viti 2017				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2017			
Emertimi	Plan	Fakt	%	Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Paga shperblime (600)	15.216.673	14.873.520	97,7%	9.243.847	62%	5.629.673	38%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	2.839.198	2.454.203	86,4%	1.714.005	70%	740.198	30%
Shuma 600+601							
Viti 2018				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2018			
Emertimi	Plan	Fakt	%	Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Paga shperblime (600)	14.905.169	13.346.985	89,5%	10.052.516	75%	3.295.469	25%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	2.300.000	2.217.151	96,4%	1.600.000	72%	617.151	28%
Shuma 600+601							
Janar-Qershor 2019				Raporti i mbulimit të shpenzimeve 2019			
Emertimi	Plan	Fakt	%	Buxheti i Shtetit	Në % ndaj totalit	Të ardhurat	Në % ndaj totalit
Paga shperblime (600)	6.590.000	4.983.916	75,6%	4.983.916	100%	0	0%
Kontributi i sigurimeve shoqerore (601)	1.320.000	1.001.469	75,9%	1.001.469	100%	0	0%
Shuma 600+601							

Burimi: DRAK



Mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (data-bazës të administruar nga sektori juridik pranë DRAK) mbi proceset gjyqësore të përfunduara për të cilat ka dalë vendimi i formës së prerë rezultoi se për periudhën 2016-Gusht 2019 nuk ka patur asnjë proces gjyqësor nga të larguarit nga puna, apo vendim gjykatë të formës së prerë për përfitimin e pagave, si pasojë e largimit nga puna, jo në përputhje me përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor.

Pika nr.4 e programit të auditimit; "Mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e asetve dhe aktiveve".

Për trajtimin e çështjes së programit të auditimit lidhur me përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në: Administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e qarkullimit të asetve të DVASHK Kavajë, u përdor kriteri ligjor si më poshtë:

-Udhëzimi nr. 30, datë. 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar

Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

Administrimi vlerave monetare në arkë:

Ky institucion për periudhën objekt auditimi nuk ka kryer asnjë veprim me arkë pasi veprimet likuiduese dhe transaksionet financiare janë kryer nëpërmjet bankës.

Administrimi vlerave monetare në bankë 2016-Gusht 2019

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore, si dhe tabelave të thesarit, rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin.

Lidhur me të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe vlerën e parcelave ndërtimore, gjendja e llogarive disponibël në Thesar e rakorduar është e njëjtë me evidencat e këtyre të ardhurave për çdo muaj të nxjerra nga ALUIZNI Kavajë.

Administrimi vlerave materiale, magazinimi dhe qarkullimi i tyre 2016-Gusht 2019

Për vitin 2016:

-Në muajin Maj të vitit 2016 Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë, si rrjedhojë e krijimit si strukturë më vete, ka përfituar grante të brendshme në natyrë në vlerën 179,344 lekë, nga Drejtoria e përgjithshme e ALUIZNI-t, konkretisht:

1. Printer INKJET-1 copë-7,300 lekë
2. Monitor-1 copë-23,608 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

3. Pc-1 copë-92,364 lekë
4. Program Ëindoës-1 copë-18,375 lekë
5. Tastier-1 copë-730 lekë
6. Maus optik-1 copë-487 lekë
7. Karriqe-1 copë-16,800 lekë
8. Kartë grafike-2 copë-19,680 lekë

për të cilat është vetëm dokumentacioni fletë-hyrje i magazinës së DRAK. Procedura për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e këtyre aktiveve nuk është kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 42, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Konkretisht për këtë procedurë mungon: Aktmarrëveshja midis DRAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t për dhurimin e këtyre pajisjeve; Mungon Akti i marrjes në dorëzim të aktiveve; Mungon shkresa e njësisë (Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t) për transferimin e aktivitetit; Nga titullari i institucionit në atë periudhë z.D.M nuk është nxjerrë urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve; Mungon urdhri i përbashkët i titullarëve të DRAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, për kalim kapitali; Mungon aktkonfirmimin nga DRAK brenda datës 20 të muajit pasardhës, për marrjen në dorëzim të aktiveve.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.D.M, larguar nga detyra në datën 12.12.2016.

Për vitin 2018

-Në datën 17.01.2018 DRAK ka përfituar grante të brendshme në natyrë nga Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t, konkretisht Desk Printer A30KIC833 dm, me vlerë 82,620 lekë. Për këtë procedurë dhurimi, grupi i auditimit ka konstatuar se është kryer në kundërshtim me pikat 42, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Konkretisht për DRAK, nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim, por vetëm nëpërmjet një autorizimi me nr.248, datë 17.01.2018 të nxjerrë nga titullari i DRAK për atë periudhë z.G.M, ku është ngarkuar specialisti i sektorit të legalizimit z.L.Ki për marrjen në dorëzim të këtij aktivi. Gjithashtu Mungon Akti i marrjes në dorëzim të aktiveve; Mungon shkresa e njësisë (Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t) për transferimin e aktivitetit; Nga titullari i institucionit në atë periudhë z.G.M nuk është nxjerrë urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve; Mungon urdhri i përbashkët i titullarëve të dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, për kalim kapitali;

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.G.M, larguar nga detyra në datën 29.01.2018.

-Në datën 31.10.2018 DRAK ka përfituar grante të brendshme në natyrë nga Drejtorja e ALUIZNI-t Tirana Rurale, konkretisht tavolina pune, gjithsej 11 copë në vlerën 108,900 lekë. Për këtë procedurë grupi i auditimit ka konstatuar se për marrjen në dorëzim të këtyre aktiveve, nga DRAK është vepruar në kundërshtim me 42, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Konkretisht për këtë procedurë mungon: Aktmarrëveshja midis DRAK dhe Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Rurale për dhurimin e këtyre pajisjeve; Mungon Akti i marrjes në dorëzim të aktiveve; *Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N, Drejtor i DVASHK Kavajë.*

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, është kryer inventarizimi i aktiveve të institucionit, në fund të çdo viti. Për të 3 vitet 2016, 2017, 2018 kanë dalë urdhrat e brendshëm "Për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale dhe fillimin e procedurës së inventarizimit", me anëtar:

- z.L.Ki Kryetar, z.K.T anëtar dhe z.B.T për vitin 2016;
- znj.B.Y Kryetar, znj.E.B anëtar dhe znj.Ë.N anëtar për vitin 2017;
- znj.L.Ki Kryetar, znj.B.Y anëtar dhe z.K.N anëtar për vitin 2018.

Gjatë auditimit të raporteve të inventarit për vitet 2015/16/17/18, kryqëzuar me vlerat e aktiveve të pasqyruara në Pasqyrat financiare për këtë periudhë, grupi i auditimit konstatoi diferenca si më poshtë:

Viti 2016

Grupi i auditimit ka konstatuar se vlera e aktiveve të institucionit, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2016, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2016, rezulton me diferencë në vlerën 410,139 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 834,544 lekë ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre është 1,244,683 lekë (ku përfshihet llogaria 218 si dhe llogaritë 31, 32, klasa 3 "gjëndja e inventarit").

Viti 2017

Grupi i auditimit ka konstatuar se vlera e aktiveve të institucionit, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2017, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2017, rezulton me diferencë në vlerën 306,674 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 1,649,944 lekë ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre është 1,956,618 lekë (ku përfshihet llogaria 218 si dhe llogaritë 31, 32, klasa 3 "gjëndja e inventarit").

Viti 2018

Grupi i auditimit ka konstatuar se vlera e aktiveve të institucionit, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2018, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2018, rezulton me diferencë në vlerën 644,957 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 1,647,944 lekë në llogarinë 218, ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre në llogarinë 218 është 1,196,507 lekë.

Observacion: Me shkresën nr.6102/1/2 prot., datë 12.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.Ë.N, z.L.Ki dhe znj.B.Y, janë bërë komente mbi konstatimet e mësipërme të grupit të auditimit, konkretisht janë pranuar se rezultojnë diferenca e cila përbëhet nga shumat e llogarisë 32 dhe llogarisë 31, për vitet 2016/17/18.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë.

Nga sa më sipër rezulton se në asnjë prej viteve 2016/17/18, nga komisionet repsektive të inventarizimit të aktiveve të DRAK-së, nuk janë pasqyruar diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit, dhe më pas të mbaheshin proces-verbalet për diferencat e rezultuara, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja "b" dhe "c" të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Për këtë konstatim të grupi të auditimit mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisioneve sipas viteve përkatëse.

Për mbajtjen e kontabilitetit sipas planit kontabël



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Për trajtimin e çështjeve të programit të auditimit lidhur me përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në:

Organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

U përdorën kriteret ligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe akteve nën ligjore për zbatimin e tij.
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore për zbatimin e tij.
- Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore për zbatimin e tij.

Viti 2016

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2016, u konstatua:

-Vlera e detyrimeve të DRAK-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare klasa 4, llogaritë 42, 431, 435, 436 dhe 467, sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën 818,728 lekë (paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, kreditor të ndryshëm) me kundërparti llogaritë në klasën 4 "kërkesa arkëtimi mbi debitorët", nuk pasqyron vlerën reale dhe të saktë të detyrimeve të institucionit. Konkretisht sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit (testuar me urdhër shpenzimet e muajit Janar-Shkurt 2017 si dhe me listë-prezencën e muajit Dhjetor 2016), vlera totale e detyrimeve është 1,804,886 lekë, e detajuar si më poshtë:

- 421,970 lekë shpenzime për paga për punonjësit definitiv;
- 592,400 lekë shpenzime për paga për punonjësit me kontratë;
- 787,516 lekë shpenzime për sig.shoqërore, shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat (393,758 lekë për punonjësit definitive dhe 393,758 lekë për punonjësit me kontratë);
- 3,000 lekë (faturë për shpenzime telefonike)

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 61, shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i dytë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.SH.D dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-Grupi i auditimit të KLSH-së, konstaton se llogaria 720, klasa 7 "grant korent i brendshëm", në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2016, është e mbivlersuar në vlerën 9,733,404 lekë, duke kontabilizuar në këtë llogari edhe financimin e pritshëm nga buxheti i shtetit në vlerën 818,728 lekë, veprim i cili është në kundërshtim me me nenin 61, shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", pasi të ardhurat e institucionit njihen në çastin e arkëtitimit të tyre.

-Gjithashtu llogaria 720, klasa 7 "grant korent i brendshëm" është e mbivlerësuar edhe në krahasim me lëvizjet "CASH", pasqyra formati 5, kreu II, grupi 2, ku rezulton se të ardhurat e DRAK nga buxheti i shtetit janë 9,609,004 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i dytë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

varen prej tyre si dhe të njëjve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.SH.D dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-U konstatua se vlera e aktiveve në pasqyrën financiare nuk ishte pasqyruar drejtë, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2016, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2016, rezulton me diferencë në vlerën 410,139 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 834,544 lekë ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre është 1,244,683 lekë (ku përfshihet llogaria 218 si dhe llogaritë 31, 32, klasa 3 "gjëndja e inventarit"). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 7, 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njëjve që varen prej tyre si dhe të njëjve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.SH.D dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Viti 2017

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2017, u konstatua:

-Vlera e detyrimeve të DRAK-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare klasa 4, llogaritë 42, 431, 435, 436 dhe 467, sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën 768,576 lekë (paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, kreditor të ndryshëm) me kundërparti llogaritë në klasën 4 "kërkesa arkëtimi mbi debitorët", nuk pasqyron vlerën reale dhe të saktë të detyrimeve të institucionit. Konkretisht sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit (testuar me urdhër shpenzimet e muajit Janar-Shkurt 2018 si dhe me listë-prezencën e muajit Dhjetor 2017), vlera totale e detyrimeve është 1,457,721 lekë, e detajuar si më poshtë:

- 333,515 lekë shpenzime për paga për punonjësit definitiv;
- 689,145 lekë shpenzime për paga për punonjësit me kontratë;
- 425,719 lekë shpenzime për sig.shoqërore, shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat për punonjësit definitive dhe me kontratë);
- 3,000 lekë (faturë për shpenzime telefonike);
- 6,342 lekë (shpenzime për postën).

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 61, shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i dytë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njëjve që varen prej tyre si dhe të njëjve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-Grupi i auditimit të KLSH-së, konstaton se llogaria 720, klasa 7 "grant korent i brendshëm", në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2017, nuk pasqyron vlerën reale të të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

ardhurave të arkëtuara nga fondet e buxhetit të shtetit në krahasim me lëvizjet "CASH", pasqyra formati 5, kreu II, grupi 2, ku rezulton se të ardhurat e DRAK nga buxheti i shtetit sipas lëvizjeve CASH janë 20,255,871 lekë, ndërkohë në llogarinë 720, klasa 7 "grant korent i brendshëm" vlera e tyre është 17,910,663 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i dytë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-Është konstatuar përlllogaritje e gabuar nga DRAK të vlerës së amortizimit për aktivet e njësisë, konkretisht vlera e amortizimit e përlllogaritur nga DRAK është 287,183 lekë, ndërkohë vlera e amortizimit për aktivet e institucionit, përlllogaritur nga grupi i auditimit, është 130,942 lekë, për arsye se në amortizimin vjetor të aktiveve në llogaritë 214, 218 është përfshirë edhe vlera e amortizimit të vitit të mëparshëm, konkretisht:

- Amortizimi për llogarinë 214 "instalime teknike, makineri, pajisje kryesisht të laboratorit" në vlerën 4,242 lekë ku përfshihen shtesat dhe pakësimet gjatë vitit;
- Amortizimi për llogarinë pajisjet elektronike, si kompjuter, printer, etj., në vlerën 122,595 lekë;
- Amortizimi për llogarinë 218 "inventar ekonomik, pajisje zyre" në vlerën 4,104 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i katërt, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-U konstatua se vlera e aktiveve në pasqyrën financiare nuk ishte pasqyruar drejtë, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2017, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2017, rezulton me diferencë në vlerën 306,674 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 1,649,944 lekë ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre është 1,956,618 lekë (ku përfshihet llogaria 218 si dhe llogaritë 31, 32, klasa 3 "gjëndja e inventarit").

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 7, 9 dhe 10 të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Kreun II, pika 1, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.



Viti 2018

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2018, u konstatua:

-Vlera e detyrimeve të DRAK-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare klasa 4, llogaritë 42, 431, 435, 436 dhe 467, sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën 777,631 lekë (paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, kreditor të ndryshëm) me kundërparti llogaritë në klasën 4 "kërkesa arkëtimi mbi debitorët", nuk pasqyron vlerën reale dhe të saktë të detyrimeve të institucionit. Konkretisht sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit (testuar me urdhër shpenzimet e muajit Janar-Shkurt 2019 si dhe me listë-prezencën e muajit Dhjetor 2017), vlera totale e detyrimeve është 1,499,469 lekë, e detajuar si më poshtë:

- 292,049 lekë shpenzime për paga për punonjësit definitiv;
- 718,753 lekë shpenzime për paga për punonjësit me kontratë;
- 426,377 lekë shpenzime për sig.shoqërore, shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat për punonjësit definitive dhe me kontratë);
- 3,000 lekë (faturë për shpenzime telefonike);
- 21,410 lekë (shpenzime për postën);
- 8,823 lekë (shpenzime për tatimin mbi qiran e ambjenteve për zyra);
- 3,085 (shpenzime për energjinë elektrike për muajt Prill, Maj, Korrik, Gusht, Tetor 2018)
- 25,972 lekë (shpenzime për energjinë elektrike të muajit Dhjetor)

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 61, shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

-U konstatua se llogaria 7110 të ardhura nga tarifa administrative dhe rregullatore nuk pasqyron vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, konkretisht në pasqyrën financiare vlera e tyre është 1,267,023 lekë, ndërkohë sipas akt-rakordimit ajo është 1,920,000 lekë.

-U konstatua se llogaria 7115 të ardhura nga gjoba, kamatvonesa, sekuestrimet nuk pasqyron vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, konkretisht në pasqyrën financiare vlera e tyre është 965,753 lekë, ndërkohë sipas akt-rakordimit ajo është 1,192,995 lekë.

-U konstatua se llogaria 7116 të ardhura nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore nuk pasqyron vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, konkretisht në pasqyrën financiare vlera e tyre është 2,622,702 lekë, ndërkohë sipas akt-rakordimit ajo është 20,530,874 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT “DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË”

-U konstatua se vlera e aktiveve në pasqyrën financiare nuk ishte pasqyruar drejtë, sipas inventarizimit të bërë në fund të vitit 2018, dhe vlera e tyre në pasqyrat financiare për vitin 2018, rezultoi me diferencë në vlerën 644,957 lekë. Konkretisht sipas inventarizimit vlera e aktiveve të institucionit është 1,647,944 lekë ndërkohë sipas pasqyrës financiare formati nr.1, vlera e tyre është 1,196,507 lekë (ku përfshihet llogaria 218 si dhe llogaritë 31, 32, klasa 3 “gjëndja e inventarit”). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja “ë” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

-Grupi i auditimit të KLSH-së, konstaton se llogaria 720, klasa 7 “grant korent i brendshëm”, në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2018, nuk pasqyrojnë vlerën reale të të ardhurave të arkëtuara nga fondet e buxhetit të shtetit në krahasim me lëvizjet “CASH”, pasqyra formati 5, kreu II, grupi 2, ku rezultoi se të ardhurat e DRAK nga buxheti i shtetit sipas lëvizjeve CASH janë 13,390,000 lekë, ndërkohë në llogarinë 720, klasa 7 “grant korent i brendshëm” vlera e tyre është 12,778,220 lekë.

-Gjithashtu është konstatuar se llogaria 720, klasa 7 “grant korent i brendshëm”, në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2018, është e mbivlersuar në vlerën 9,733,404 lekë, duke kontabilizuar në këtë llogari edhe financimin e pritshëm nga buxheti i shtetit në vlerën 777,631 lekë, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 61, shkronja “a” dhe “b” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pasi të ardhurat e institucionit njihen në çastin e arkëtimit të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr.25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr.8, data 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja “ë” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Përsa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore nëpunësi autorizues z.Y.N dhe nëpunësi zbatues znj.B.Y.

Pika nr.5 e Raportit të Auditimit; “Për prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime”:

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr.577/1, datë 13.08.2019 ndryshuar me programin 577/2, datë 24.09.2019, u shqyrtua dokumentacioni mbi procedurat e prokurimit (blerjet me vlera nën 800,000 lekë) për vitet 2016/17/18/ 6 mujori I - 2019.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm për periudhën 2016-Qershor 2019, në vija të përgjithshme rezultoi:

Për periudhën Qershor-Dhjetor 2016 janë realizuar gjithsej 16 procedura prokurimi, ku 7 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 7 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj., Nga këto u audituan 6 procedura gjithsej, me fond 1,058,400 lekë ose 62% e fondit të shpenzuar për vitin 2016, për realizimin e procedurave të prokurimit.

PROTOKOLLI I PROKURIMEVE VITI 2016						
NR	DATA	EMËRTIMI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT (LEKE PA TVSH)	TVSH	Total	PROCEDURA E PËRDORUR
1	24.06.2016	Blerje Kancelarie	140.000	28.000	168.000	Blerje me vlere te vogel
2	27.07.2016	Blerje Kancelarie	60.000	12.000	72.000	Blerje me vlere te vogel
3	8.08.2016	Blerje metra lazer	67.000	13.400	80.400	Blerje me vlere te vogel
4	11.08.2016	Blerje Kompjuterash	300.000	60.000	360.000	Blerje me vlere te vogel



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

5	19.08,2016	Blerje pajisje zyresh	130.000	26.000	156.000	Blerje me vlere te vogel
6	17.10,2016	Shpenzim riparim pajisje zyresh	90.000	18.000	108.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
7	17,10,2016	Blerje Materiali për Funkionimin e Pajisjeve	165.000	33.000	198.000	Blerje me vlere te vogel
8	07.11,2016	Blerje Kancelarie	18.000	3.600	21.600	Blerje me vlere te vogel
9	07.11,2016	Shpenzim riparim pajisje zyresh	10.000	2.000	12.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
10	16,12,2016	Shpenzim blerje detergjentesh	16.600	3.320	19.920	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
11	16,12,2016	Blerje materiale elektronike	150.000	30.000	180.000	Blerje me vlere te vogel
12	28,12,2016	Shpenzim blerje materiale te tjera zyre	80.000	16.000	96.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
13	29,12,2016	Shpenzim lryje ambientesh	100.000	20.000	120.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
14	29,12,2016	Shpenzim riparim te tjera	100.000	20.000	120.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
TOTAL					1.711.920	

Për periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë realizuar gjithsej 9 procedura prokurimi, ku 3 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 7 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambientesh etj., Nga këto u audituan 4 procedura gjithsej, me fond 1,362,000 lekë ose 88% e fondit të shpenzuar për vitin 2017, për realizimin e procedurave të prokurimit.

PROTOKOLLI I PROKURIMEVE VITI 2017						
NR	DATA	EMËRTIMI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT (LEKE PA TVSH)	TVSH	Total	PROCEDURA E PËRDORUR
1	02,03,2017	Blerje kancelarie	130.000	26.000	156.000	Blerje me vlere te vogel
2	13,03,2017	Shpenzime riparime fotokopje	25.000	5.000	30.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
3	10,04,2017	Blerje Kancelarie	15.000	3.000	18.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
4	30,06,2017	Materiale pastrimi	16.660	3.332	19.992	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
5	30.06.2017	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyrove	100,000	20.000	120.000	Blerje me vlere te vogel
6	07,08,2017	Blerje kancelarie	110.000	22.000	132.000	Blerje me vlere te vogel
7	12,12,2017	Blerje pajisje elektronike	795.000	159.000	954.000	Blerje me vlere te vogel
8	21,12,2017	Blerje Metër lazer	70.000	14.000	84.000	Blerje me vlere te vogel
9	21,12,2017	Blerje Kancelarie	18.000	3.600	21.600	Blerje me vlere te vogel
TOTAL					1.535.592	

Për periudhën Janar-Dhjetor 2018 janë realizuar gjithsej 16 procedura prokurimi, ku 3 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 7 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambientesh etj., Nga këto u audituan 5 procedura gjithsej, me fond 880,620 lekë ose 62% e fondit të shpenzuar për vitin 2018, për realizimin e procedurave të prokurimit.

PROTOKOLLI I PROKURIMEVE VITI 2018						
NR	DATA	EMËRTIMI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT (LEKE PA TVSH)	TVSH	Total	PROCEDURA E PËRDORUR
1	16,02,2018	Blerje kancelarie	62.750	12.550	75.300	Blerje me vlere te vogel
2	16,02,2018	Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve	116.667	23.333	140.000	Blerje me vlere te vogel
3	26,02,2018	Blerje detergjentesh	29.417	5.883	35,300	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
4	22,03,2018	Shpenzime publikime	8.200	1.640	9.840	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
5	13,04,2018	Blerje kancelarie	70.799	14.159	84.958	Blerje me vlere te vogel
6	27,04,2018	Blerje pajisje te tjera zyre	92.083	18.417	110.500	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
7	27,04,2018	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrove	63.208	12.642	75.850	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
8	04,05,2018	Shpenzime të tjera operative	76.800	15.360	92.160	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
9	11,05,2018	Shpenzime publikime	17.000	3.400	20.400	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

10	21,06,2018	Blerje kancelarie	147.500	29.500	177.000	Blerje me vlere te vogel
11	21,06,2018	Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve	177.600	35.520	213.120	Blerje me vlere te vogel
12	23,08,2018	Blerje Detergjentesh	29.000	5.800	34.800	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
13	24,10,2018	Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve	200.000	40.000	240.000	Blerje me vlere te vogel
14	26,10,2018	Blerje kancelarie	72.150	14.430	86.580	Blerje me vlere te vogel
15	21,11,2018	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrove	35.000	7.000	42.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
16	13,12,2018	Shpenzime publike	7.200	1.440	8.640	Blerje me vlere te vogel nen 100 000leke
TOTAL					1.411.183	

Për periudhën Janar-Qershor 2019 janë realizuar gjithsej 3 procedura prokurimi, ku 3 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 7 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj., Nga këto u auditua 1 procedurë, me fond 172,080 lekë ose 76% e fondit të shpenzuar për periudhën Janar-Qershor 2019, për realizimin e procedurave të prokurimit.

PROTOKOLLI I PROKURIMEVE VITI 2019						
NR	DATA	EMËRTIMI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT (LEKE PA TVSH)	TVSH	Total	PROCEDURA E PËRDORUR
1	11,02,2019	Blerje Kancelarie	143.400	28.680	172.080	Blerje me vlere te vogel
2	22,02,2019	Shpenzime riparime zyresh	20.000	4.000	24.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
3	05,04,2020	Blerje dokumentacioni	25.000	5.000	30.000	Blerje me vlere te vogel nen 100 000 leke
TOTAL					226.080	

Nga auditimi i këtyre procedurave me zgjedhje, në vija të përgjithshme u konstatua se:

-Në të gjitha rastet e përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit ka qenë deri në 800,000 lekë pa TVSH. pra brenda kufirit monetar të përcaktuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, Udhëzimit nr 3, dt 08.01.2018 të APP “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimit nr. 11, dt 30.05.2018 të APP , Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, dt 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar.

-Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

-Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin faturat tatimore shitje të cilat rezultuan të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.

-Titullari i institucionit me urdhër të brendshëm ka urdhëruar ngritjen e komisionit të marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar për cdo vit veprimi. Nga komisionet marrjes në dorëzim janë mbajtur procesverbalet e marrjes në dorëzim për kontrollin fizik të mallrave në sasi dhe cilësi të cilat ndodheshin fletë hyrjet e magazinës me vlera të njëjta me faturat tatimore të shitjes.

Blerje Investime viti 2016

- Me Urdhër nr. 03, datë 21.06.2016 është krijuar “Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Aktiveve Materiale të Furnizuara dhe Shërbimeve të Kryera”, i përbërë nga:

1. F.M,
2. M.M,
3. S.H.



- Me Urdhër nr. 5, datë 21.01.2016 është krijuar “Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla”, i përbërë nga:

1. B.Y - Kryetare,
2. D.D – Anëtare,
3. M.P – Anëtar.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 7 datë 04.07.2016 në shumën 116,426 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik “E” shpk për “furnizimin me kancelari”. Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 1 datë 24.06.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 140,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, proces-verbali për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016”.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues “E.P” shpk, me vlerë me të vogël, 97,021 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 28.06.2016, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

Observacion: Me shkresën nr.6108/6 dhe 6108/5 prot., datë 18.11.2019 dhe datë 15.11.2019, janë paraqitur observacione znj.D.D ish specialiste hartografe dhe znj.M.P ish specialiste juriste, janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht për mungesën e proceverbalit të llogaritjes së fondit filimit dhe përcaktimit të fituesit, ku janë shprehur se komisioni me vlera të vogla ka llogaritur fondin limit duke marrë për bazë cmimet e mallrave pas studimit të tregut, dhe nuk i ka pasqyruar ato nëpërmjet mbajtjes së proceverbalit, por i ka përfshirë në Urdhrin e prokurimit. Gjithashtu për mungesën e proceverbalit për shpalljen e operatorit ekonomik fitues, nuk është mbajtur për arsye se është gjeneruar automatikisht nga sistemi, si dhe referon Udhëzimin nr.03, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”, në asnjë rast nuk përcaktohet mbajtja e proceverbalit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, nuk e merrë në konsideratë komentin e bërë, për arsye se në referencën ligjore të përmendur nga grupi i auditimit citohet VKM nr.914, e cila prevalon nga ana ligjore ndaj Udhëzimit. Gjithashtu në VKM përcaktohen rregulla të përgjithshme dhe të detajuara sipas rastit për çdo procedurë prokurimi, ku pjesë e tyre është edhe procedura me vlera të vogla, si dhe mënyrën e veprimit të punonjësve që angazhohen në këtë procedurë. Ky koment vlenë edhe për komentet e tjera të bëra në vijimësi, me të njëjtën përmbajtje.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 25 datë 13.09.2016 në shumën 59,998 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik “4.A” shpk për “furnizimin me kancelari”. Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 3 datë 27.07.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 60,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, proces-verbali për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016”.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues “4.A” shpk, me vlerë me të vogël, 49,999 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 04.08.2016, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 18 datë 25.08.2016 në shumën 76,800 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik “P.D” shpk për “furnizimin me metër lazer dhe metër shirit”. Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 4 datë 08.08.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 67,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, proces-verbali për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016”.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues “P.D” shpk, me vlerë me të vogël, 64,000 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 11.08.2016, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

- Me urdhër shpenzimi nr. 20 datë 25.08.2016 në shumën 297,600 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik “I.A” shpk për “furnizimin me kompjutera”. Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 6 datë 11.08.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 300,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016”.

Konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Me procesverbalin *nr.prot s’ka*, datë 17.08.2016 nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është s’kualifikuar operatori i renditur në vendin e parë “P.S” shpk, me vlerën më të ulët ekonomike 215,500 lekë, për arsye se mallrat e dorëzuara nga ky operator nuk ishin sipas kriterëve të përcaktuara, ndërkohë që specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit nuk ishin përcaktuar rast pas rasti, sic e kemi cituar edhe më sipër. Në këtë procedurë konstatohet se nuk ka asnjë dokument ose procesverbal për marrjen në dorëzim të mallrave nga OE “P.S”, verifikimin e tyre e më pas në arritjen në përfundimin se këto mallra nuk janë sipas përcaktimeve të bëra, duke mos siguruar gjurmët e auditimit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2/a-g, në nenin 12, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Nga komisioni me vlera të vogla, me proces verbalin *nr. prot s'ka*, datë 17.08.2016 është shpallur fitues "I.A" shpk, i renditur i dyti në procedurë me vlerën e ofertës 248,000 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 18.08.2016 *pa nr.prot*, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

Përsa më sipër, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara, për mospasqyrimin e plotë të skualifikimit të operatorit të parë P.S shpk, *ndaj buxhetit të shtetit është krijuar efekt negativ financiar në vlerën 32,500 lekë*, diferenca në lekë nga oferta e përzgjedhur fituese me ofertën e skualifikuar.

Për këtë mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të ngritur me Urdhrin nr.03, datë 21.06.2016.

Observacion: Me shkresën nr.6108/3 prot., datë 12.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.M.M, z.S.H dhe z.F.M, janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

Mbi mungesën e procesverbalit për marrjen në dorëzim të materialeve nga "P.S", bëjmë me dije se është mbajtur ky procesverbal (bashkëlidhur dokumenti përkatës).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, nuk e merrë në konsideratë komentin e bërë, për arsye se proceverbali i mbajtur është pa numër protokollit, nuk është i inventarizuar dhe numerizuar, për rrjedhojë vërtetësia e tij është e dyshimtë, referuar edhe nenit 24 dhe 36 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

- Me urdhër shpenzimi Nr. 37 datë 01.11.2016 në shumën 140,400 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "I.O" shpk për "furnizimin me materiale për zyrat". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 9 datë 17.10.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 165,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 5 neni 40 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Me procesverbalin *nr.01*, datë 26.10.2016 nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është s'kualifikuar operatori i renditur në vendin e parë K.D shpk, me vlerën më të ulët ekonomike 115,000 lekë, për arsye të tërheqjes nga oferta.

Nga komisioni me vlera të vogla, me proces verbalin nr. 01, datë 26.10.2016 është shpallur fitues "I.O" shpk, i renditur i dyti në procedurë me vlerën e ofertës 117,000 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 28.10.2016 *pa nr.prot*, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 53 datë 30.12.2016 në shumën 160,800 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "I.K" shpk për "furnizimin me kompjutera". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 12 datë 16.12.2016, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 150,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve



mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y; Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 5 neni 40 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, z.D.D dhe znj.M.P.

Me procesverbalet përkatëse 20.12.2016; datë 21.12.2016; datë 22.12.2016; datë 27.12.2016 janë bërë njoftimet e operatorëve ekonomik të shpallur fitues, ku në përfundim rezulton se pesë ofertuesit e parë janë tërhequr nga kjo procedurë, si dhe me procesverbalin e mbajtur më datë 27.12.2016, nga Komisioni i Prokurimit, është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

Me Urdhrin e Prokurimit nr.12/1, datë 21.12.2016 është urdhëruar përsëritja e procedurës së prokurimit, dhe me procesverbalin nr.4, datë 29.12.2016 është bërë shpallja e fituesit "I.K" shpk, i renditur i pesti me ofertën ekonomike në vlerën 134,000 lekë, për arsye të terheqjes nga procedura të 4 ofertuesve të parë.

Me proceverbalin e mbajtur më datë 30.12.2016 *pa nr.prot*, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 03, datë 21.06.2016.

Blerje Investime viti 2017

- Me Urdhër nr. 35, datë 09.05.2017 është krijuar "*Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Aktiveve Materiale të Furnizuara dhe Shërbimeve të Kryera*", i përbërë nga:

1. M.Xh,
2. B.H,
3. S.H.

Ndryshuar me Urdhrin nr.99, datë 19.12.2017, me përbërje si më poshtë:

1. L.Ki,
- 2.M.Xh,
3. S.H.

- Me Urdhër nr. 7, datë 28.02.2017 është krijuar "*Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla*", i përbërë nga:

1. B.Y - Kryetare,
2. I.D – Anëtare,
3. M.P – Anëtar.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 14 datë 16.03.2017 në shumën 117,120 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "I.O" shpk për "furnizimin me kancelari". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 01 datë 02.03.2017, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 156,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y;

Gjithashtu konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016".

Konstatohet se fatura tatimore e lëshuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues, nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, por vetëm nga kryetari i komisionit, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 7, neni 40 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Përsa më sipër, për mungesën e procesverbalit dhe nënshkrimin e faturës tatimore nga anëtarët e komisionit mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, znj.I.D dhe znj.M.P.

Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues "I.O" shpk, me vlerë me të vogël, 97,600 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 07.03.2017, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin 35, datë 09.05.2017.

Observacion: Me shkresën nr.577/3 prot., datë 13.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.M.P ish-specialiste pranë DRAK, shkresën nr.6108/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D, si dhe znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

Mbi konstatimin e mosadministrimit të procesverbalit për llogaritjen e fondit limit, bashkangjitur observacionit është proceverbali i llogaritjes së fondit limit me nr. s'ka, datë 02.03.2017 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla.

Lidhur me proceverbalin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, ish-specialistja e DRAK është shprehur se pikën 5 të nenit 40 VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", me ndryshimin e vitit 2016 me VKM nr. 823, datë 23.11.2016, nuk përcaktohet mbajtja e proceverbalit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla.

Gjithashtu për nënshkrimin e faturës tatimore nga komisioni me vlera të vogla, është shprehur se ajo është nënshkruar nga kryetari i komisionit të prokurimit publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë pjesërisht komentin e bërë, konkretisht vetëm për proceverbalin e llogaritjes së fondit limit nga komisioni me vlera të vogla.

Përsa i përket proceverbalit të përcaktimit të operatorit ekonomik fitues, është bërë ndryshimi i referencës ligjore, pra në pikën 2, neni 57 të VKM nr.914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr.823, datë 23.11.2016", ku përcaktohet se njësia e prokurimit ka përgjegjësi për administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti.

Lidhur me komentin e bërë për nënshkrimin e faturës tatimore, theksojmë se në pikën 7, neni 40 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr.823, datë 23.11.2016", përcaktohet se pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit dhe jo vetëm nga kryetari i komisionit.

Ky koment i grupit të auditimit vlen edhe për observacionet e tjera në vijim me të njëjtën përmbajtje, dhe janë bërë ndryshimet rast pas rasti.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 48 datë 08.08.2017 në shumën 114,000 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "R.2" shpk për "furnizimin me materiale për funksionimin e pajisjeve". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 06 datë 30.06.2017, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 100,000 lekë pa tvsh. Procedura e prokurimit është zhvilluar pas kërkesës së sektorit të financës me nr.1779 prot., datë 30.06.2017. Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues "R.2" shpk, i renditur i nënti me ofertën me vlerë, 93,900 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 26.07.2017, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr.35, datë 09.05.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Konstatohet se fatura tatimore e lëshuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues, nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, por vetëm nga kryetari i komisionit, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 7, të nenit 40 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr. 823, datë 23.11.2016".

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik, znj.I.D dhe znj.M.P.

Observacion: Me shkresën nr.577/3 prot., datë 13.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.M.P ish-specialiste pranë DRAK, shkresën nr.6108/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D, si dhe znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

Mbi konstatimin e mosadministrimit të procesverbalit për llogaritjen e fondit limit, bashkangjitur observacionit është proceverbali i llogaritjes së fondit limit me nr. s'ka, datë 30.06.2017 nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla.

Lidhur me konstatimin e bërë për efektin negativ të shkaktuar buxhetit të shtetit, janë bashkangjitur 5 proceverbalet e mbajtuara (në datat 06.07; 10.07; 12.07; 17.07 viti 2017) për operatorët ekonomik të shpallur fitues, të cilët janë tërhequr nga procedura e prokurimit, si dhe procesverbalin e mbajtur për anulimin e procedurës së parë të prokurimit të iniciuar me Urdhrin nr. 06 datë 30.06.2017. Gjithashtu janë bashkëlidhur ftesa e dytë për ofertë me nr.1779/3 prot., datë 18.07.2017, për rifillimin e procedurës së prokurimit, si dhe 4 proceverbalet e mbajtura nga komisioni me vlera të vogla (në datat 18.07; 21.07; 24.07; 26.07, viti 2017) për përcaktimin e fituesit "R.2", i renditur në vendin e katërt, për arsye se tre operatorët e parë janë tërhequr nga procedura e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë pjesërisht komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

- Me urdhër shpenzimi Nr. 51 datë 30.08.2017 në shumën 106,200 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "EG" shpk për "furnizimin me kancelari". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 7 datë 07.08.2017, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 110,000 lekë pa tvsh.

Procedura është kryer pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me nr., prot s'ka, datë 07.08.2017.

Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet proces-verbali për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me pikën 2, neni 57 të VKM nr.914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.05.2015 dhe VKM nr.823, datë 23.11.2016".

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore anëtarët e komisionit të prokurimit publik znj.B.Y, znj.I.D dhe znj.M.P.

Nga komisioni me vlera të vogla është shpallur fitues E.G shpk, me vlerë më të vogël 88,500 lekë. Me proceverbalin e mbajtur më datë 11.08.2016, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 35, datë 09.05.2017.

- Me urdhër shpenzimi nr.75 datë 28.12.2017 në shumën 807,600 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "I.A" shpk për "furnizimin me kompjutera". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr.8 datë 12.12.2017, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 795,000 lekë pa tvsh. Konstatohet se në këtë procedurë nuk administrohet kërkesa e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse me përgjegjëse sektori znj.B.Y;



Me procesverbalin nr.01, datë 19.12.2017 nga komisioni me vlera të vogla është bërë shpallja e fituesit të renditur i dyti në procedurë, pasi operatori i parë është tërhequr nga konkurrimi.

Me procesverbalin nr.02, datë 20.12.2017 nga komisioni i me vlera të vogla është bërë shpallja e fituesit të renditur i treti në procedurë, pasi operatori i dytë nuk është paraqitur sipas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë, konkretisht fitues është shpallur operatori ekonomik "F.E" shpk, me vlerën 673,000 lekë.

Me proceverbalin e mbajtur më datë 21.12.2017 *pa nr.prot*, është bërë marrja në dorëzim e mallrave si dhe verifikimi i tyre, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhër nr.99, datë 19.12.2016.

Blerjet e vogla Viti 2018

- Me Urdhër nr. 20, datë 20.02.2018 është krijuar "*Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Aktiveve Materiale të Furnizuara dhe Shërbimeve të Kryera*", i përbërë nga:

1. L.Ki,
2. M.Xh,
3. F.M.

- Me Urdhër nr. 16, datë 15.02.2018 është krijuar "*Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla*", i përbërë nga:

1. B.Y - Kryetare,
2. M.P- Anëtare,
3. I.D – Anëtar.

Ndryshuar me Urdhër nr.33, datë 19.03.2018 me përbërje:

1. B.Y - Kryetare,
2. A.K- Anëtar,
3. I.D – Anëtar.

Ndryshuar me Urdhër nr.05, datë 18.04.2018 me përbërje:

1. B.Y - Kryetare,
2. L.Ki- Anëtar,
3. F.M – Anëtar.

Observacion: Nga znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, si dhe është bashkangjitur regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

- Me urdhër shpenzimi nr.10 datë 27.02.2018 në shumën 113,500 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "C" shpk për "furnizimin me materiale për funksionimin e pajisjeve". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 02 datë 16.02.2018, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 116,667 lekë pa tvsh. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.542 prot., datë 16.02.2018.

Fondi limit është përlllogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin *nr. s'ka*, datë 15.02.2018.

Me procesverbalin *nr. s'ka*, datë 20.02.2018, nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është bërë shpallja e fituesit, "E.O" shpk, i renditur i dyti me ofertën ekonomike me vlerë 92,000 lekë, për arsye se operatori i parë është tërhequr nga procedura e prokurimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Me procesverbalin nr. s'ka, datë 21.02.2018 është bërë shpallja e fituesit, "C" shpk, i renditur i treti me ofertën ekonomike me vlerë 94,600 lekë, për arsye se operatori i dytë "E.O" shpk është tërhequr nga procedura e prokurimit.

Me proceverbalin nr.s'ka, datë 22.02.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të prokuruar, është bërë verifikimi dhe marrja në dorëzim e këtyre materialeve.

- Me urdhër shpenzimi nr.30 datë 04.05.2018 në shumën 109,200 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik R.T shpk për "furnizimin me materiale për zyrat". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr.07 datë 27.04.2018, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 92,083 lekë pa tvsh. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.935/1 prot., datë 27.04.2018.

Fondi limit është përllogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin nr. s'ka, datë 27.04.2018.

Nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është bërë shpallja e fituesit, R.T, me ofertën ekonomike me vlerë 109,200 lekë me TVSH.

Me proceverbalin nr. s'ka, datë 02.05.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të prokuruar, është bërë verifikimi dhe marrja në dorëzim e këtyre materialeve.

- Nuk administrohet procesverbali mbi përcaktimin e specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 23, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit, për pasqyrimin e informacionit për aktivitetin që ushtron ky person, nuk përputhet me objektin e prokuruar, në kundërshtim me pikën 1/a, të nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit, ngritur me Urdhrin nr. 05, datë 18.04.2018.

Observacion: Me shkresën nr.577/3 577/6 prot., datë 13.11.2019 dhe datë 21.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.M.P ish-specialiste pranë DRAK, z.A.K, shkresën nr.6108/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D, si dhe nga znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht nga ish-specialistja znj.M.P janë bashkangjitur Urdhrat e brendshëm të titullarit të institucionit për ndryshimin e anëtarëve të komisionit me vlera të vogla, si dhe znj.B.Y, z.A.K dhe znj.I.D janë shprehur se kjo procedurë është realizuar në mbështetje të nenit 40/4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 si dhe pikës 1 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018, dhe për këto arsye nuk është ftesa për ofertë. Gjithashtu bashkëlidhur këtij observacioni është edhe fletë-hyrja nr.07, datë 30.05.2018 e grilave në magazinën e DRAK

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë, konkretisht për ndryshimin e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, si dhe pjesërisht komentin e bërë nga znj.B.Y, z.A.K dhe znj.I.D, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse. Lidhur me ekstraktin e QKR-së bashkëlidhur për operatorin ekonomik fitues "R.T", përcaktohet se është i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë "Rrobaqepës" dhe jo tregtimin e materialeve të prokuruar në rastin konkret (grila vertikale).

- Me urdhër shpenzimi nr.46 datë 28.06.2018 në shumën 106,992 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "I.O" shpk për "furnizimin me kancelari". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 11 datë 21.06.2018, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.1712/1 prot., datë 21.06.2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

Fondi limit është përlogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin *nr. s'ka*, datë 21.06.2018.

Nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me procesverbalin nr.01, datë 25.06.2018, është bërë shpallja e fituesit, "SH.K", i renditur i dyti me ofertën ekonomike me vlerë 89,000 lekë, për arsye se operatori i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit.

Me procesverbalin nr.02, datë 26.06.2018, është bërë shpallja e fituesit, I.O, i renditur i treti me ofertën ekonomike me vlerë 89,160 lekë, për arsye se operatori i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit.

Me procesverbalin *nr. s'ka*, datë 27.06.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të prokuruar, është bërë verifikimi dhe marrja në dorëzim e këtyre materialeve.

- Me urdhër shpenzimi nr.51 datë 05.07.2018 në shumën 154,200 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "B.E" shpk për "furnizimin për materiale për funksionimin e pajisjeve". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 10 datë 21.06.2018, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.1711/1 prot., datë 21.06.2018.

Fondi limit 177,600 lekë është përlogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin *nr. s'ka, datë s'ka*.

Me procesverbalin *nr.01*, datë 26.06.2018 është shpallur fitues operatori ekonomik "B.E" shpk, i renditur i dyti, me ofertën me vlerë 154,200 lekë me TVSH, për arsye se operatori i parë "M.B" shpk është tërhequr nga gara.

Me procesverbalin *nr. s'ka*, datë 27.06.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të prokuruar, është bërë verifikimi dhe marrja në dorëzim e këtyre materialeve.

- Me urdhër shpenzimi nr.91 datë 07.11.2018 në shumën 180,000 lekë me tvsh, është paguar operatori ekonomik "B.E" shpk për "furnizimin për materiale për funksionimin e pajisjeve". Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 14 datë 24.10.2018, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.3605 prot., datë 14.10.2018.

Fondi limit 200,000 lekë është përlogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin *nr. s'ka*, datë 24.10.2018.

Me procesverbalin nr.01, datë 29.10.2018 është shpallur fitues operatori ekonomik "A." shpk, i renditur i dyti, me ofertën me vlerë 133,333 lekë, për arsye se operatori i parë P.O shpk është tërhequr nga gara.

Me procesverbalin nr.02, datë 30.10.2018 është shpallur fitues operatori ekonomik "B.E" shpk, i renditur i tretë, me ofertën me vlerë 150,000 lekë, për arsye se operatori "A." shpk është tërhequr nga gara, pasi nuk është paraqitur sipas ftesës për ofertë.

Me procesverbalin *nr. s'ka*, datë 31.10.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të prokuruar, është bërë verifikimi dhe marrja në dorëzim e këtyre materialeve.

Observacion: Me shkresën nr.6108/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D, z.A.K si dhe nga znj.B.Y, janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht janë shprehur se subjekti A. nuk është paraqitur brenda 24 orëve sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të nenit 12, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik "B.E" shpk.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

Blerjet e vogla Viti 2019

- Me Urdhër nr. 01, datë 04.01.2019 është krijuar "Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla", i përbërë nga:



1. B.Y, Kryetar
2. L.Ki, Anëtar
3. I.D, Aëtar

- Me Urdhër nr. 19, datë 12.02.2019 është krijuar “Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Aktiveve Materiale të Furnizuara dhe Shërbimeve të Kryera”, i përbërë nga:

- 1.M.K, Kryetar
- 2.A.M, Anëtar
- 3.M.D, Anëtar

Observacion: Nga znj.B.Y (Nëpunës zbatues i DRAK) janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, si dhe është bashkangjitur regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

- Me urdhër shpenzimi nr. 23, datë 07.03.2019 në shumën 119,760 lekë me tvsh dhe është paguar operatori ekonomik “4.D” shpk për “materiale për kancelari”. Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër Prokurimi nr. 01 datë 08.02.2019, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Procedura e prokurimit ka filluar pas kërkesës së bërë nga sektori i financës me shkresën me nr.577 prot., datë 08.02.2019.

Fondi limit 143,400 lekë është përllogaritur nga komisioni i prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, dokumentuar në procesverbalin nr. s’ka, datë 08.02.2019.

Observacion: Me shkresën nr.6108/2 prot., datë 12.11.2019 administruar pranë zyrës së protokollit të KLSH, nga znj.M.K, z.M.D dhe z.A.M, si dhe me shkresën nr.6108/1, datë 12.11.2019 nga znj.I.D dhe nga znj.B.Y, janë bërë komente mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, konkretisht në mënyrë të përmbledhur:

Mbi mungesën e procesverbalit për marrjen në dorëzim të materialeve nga “4.D”, bëjmë me dije se është mbajtur ky procesverbal (bashkëlidhur dokumenti përkatës), si dhe për procesverbalin për përzgjedhjen e operatorit fitues, bashkëlidhur është printimi nga sistemi elektronik për operatorin ekonomik të shpallur fitues.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë komentin e bërë, dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

Konkluzion:

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën 2016 - Qershor 2019, konstatohet se në shumë raste nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor të prokurimeve publike, kryesisht të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në administrimin e dokumentacionit të përcaktuar që duhet të ketë një procedurë prokurimi, mungesën e llogaritjes së fondit limit, etj.

Të ndryshme mbi bazueshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe respektimi i afatit ligjor për kthim përgjigje.

Nga viti 2016 deri në 31.08.2019, sipas pasqyrave të paraqitura për objektet informale, ankesat e qytetarve kanë qenë 32 gjithsej dhe në zgjidhjen e problematikave, ka pasur zvaritje dhe zgjatje të procesit. Sipas verifikimeve konstatohet ankesat kanë përgjigje të kthyera



qytetarve , por një pjese e tyre kanë mare zgjidhje me vonesa ,ose kanë marë lejet e legalizimit mbas 2 deri tre muaj si rasti qytetarve. R.M me vonesë 3 muaj ,rasti i H.M,rasti i G.Z zgjidhur ankesa mbas 4 muaj, ose G.L ku në përgjigjet pershkruhet se dosja është nxjerë per tu perpunuar me urdhërin nr 32 datë 13.03.2018 dhe nuk është dhena leja e legalizimit ,pra ka zgjatje dhe vonesa në mbarimin e procedurave ligjore qe bien ndesh me neni 28 të ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 me ndryshime.

Për përmirësimin e punës në të ardhmen për DVASHK Kavajë, rekomandojmë:

B-MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 61 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufirit të pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me nenin 2,pika 3,të ligjit nr. 8482 ,datë 03.04.20016 i ndryshuar dhe manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik si genplan, planimetri etj (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë të marrë masa për 61 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “*Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës si dhe ndërtime me leje*”, me të dhënat përkatëse, largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij sipas ligjit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në 18 raste nga ish/Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nuk është respektuar **afati 60 ditor** për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, ndërkohë që **në 5 raste** nuk është respektuar **afati 30 ditor** për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim me: VKM Nr.280, datë 1.4.2015 të “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar pika 8 si dhe VKM nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar, pika 2 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë të marrë masa për të N shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjorisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke ritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nga 2950 leje legalizimi të lëshuara, 1798 leje legalizimi vlerë **63,700,768 lekë** dhe Bono Privatizimi, janë **pa VKM** . Lejet e legalizimit janë vetëm për objektin e ndërtimit pa likuiduar parcelën ndërtimore. Në lejet e legalizuara është vendosur shënimi “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me



Vendim të Këshillit të Ministrave” referuar V.K.M. nr. 954, datë 25.11.2015 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015”, veprim në zgjatje të afateve ,në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17, pika 5 (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

-të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **1798 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin e vlerës së parcelave ndërtimore .

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në **27 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi:*

- Në **11 raste**, janë kryer legalizime të objekteve **pa respektuar distancat nga rrugët**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në **5 rast** është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar **në buzë të lumit, përroi, kanal dhe pa respektuar distancat nga brigjet** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, geramat: “dh”;

-Në **11 raste me sipërfaqe prej 6727 m²**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll, Ullishte”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, konkretisht :

5/1-Dosja me nr.2612 dhe nr.2613, me leje legalizimi nr 7002069 date 02.08.2016 dhe nr.7002053 datë 02.08.2016,

5/2-Dosja me nr.2141, me leje legalizimi nr.7002559 datë 10.04.2017.

5/3-Dosja me nr.419, me leje legalizimi nr.7008792 datë 27.12.2017.

5/4-Dosja me nr.2141, me leje legalizimi nr.7002659 datë 25.04.2017.

5/5-Dosja me nr.16 , me leje legalizimi nr. 7002667 datë 26.04.2017 .

5/6.Dosja me 381 , me leje legalizimi nr. 7006777 datë 21.12.2017.



- 5/7. Dosja me 1561, me leje legalizimi nr. 7006829 datë 15.01.2018 .
- 5/8. Dosja me 390 , me leje legalizimi nr. 7006835 datë 18.01.2018.
- 5/9- Dosja me nr. 8 me procedues M.A Sh.p.k, me leje legalizimi nr.7002672 datë 28.04.2017.
- 5/10 - Dosja me nr.1924, me leje legalizimi nr.7006915 datë 26.02.2018.
- 5/11 - Dosja me (pa numër), me leje legalizimi nr.7002079 datë 02.08.2016 .
- 5/12- Dosja me nr.2031 , me leje legalizimi nr.7002122 datë 13.09.2016.
- 5/13 - Dosja me nr. 1540 , me leje legalizimi nr. 7002211 datë 31.08.2016.
- 5/14 - Dosja me nr. 6 , me leje legalizimi nr. 7002142 datë 17.09.2016.
- 5/15 - Dosja me nr. 201/1 , me leje legalizimi nr. 7002064 datë 02.08.2016.
- 5/16 - Dosja me nr. 6051 me procedues, me leje legalizimi nr. 7002075 datë 02.08.2016.
- 5/17 - Dosja me nr. 3178 , me leje legalizimi nr. 7002170 datë 21.09.2016 .
- 5/18 - Dosja me nr. 1427 , me leje legalizimi nr. 7002051 datë 02.08.2016 .
- 5/19 - Dosja me nr. 1381, me leje legalizimi nr. 7002190 datë 23.09. 2018
- 5/20 - Dosja me nr. 629,
- 5/21 - Dosja me nr. 2118 , me leje legalizimi nr. 7002177 datë 22.09.2016.
- 5/22 - Dosja me nr. 60, me leje legalizimi nr. 7002030 datë 01.08.2016.
- 5/23 - Dosja me nr. 2070 , me leje legalizimi nr. 7002072 datë 02.08.2016.
- 5/24 - Dosja me nr. 6604, me leje legalizimi nr. 7002622 datë 24.04.2017.
- 5/25 - Dosja me nr. 45, me leje legalizimi nr. 7006836 datë 19.01.2018 konstatohet se objekti është në kufij të afërt me autostradën në distance 15.4 m linar nga objekti . Në dosje mungon dokumenti nga istucioni përkatës.
- 5/26 - Dosja me nr. 448 , me leje legalizimi nr. 7006852 datë 26.01.2018.
- 5/27 - Dosja me nr. 941, me leje legalizimi nr. 7002018 datë 24.04. 2018 (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë (DVASHK KAVAJE), për objektet informale të ndërtuara në kundërshtim me ligjin e legalizimit dhe të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara: **të marrë masa në të ardhmen që të mos lejojë legalizimin e ndërtimeve informale të ndërtuara pranë kanaleve rrugëve, si dhe objekte papërfunduara.**

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes me leje legalizimi datë 01.08.2016, *godinë banimi 1-kat*, Synej, për parcelën ndërtimore të tij me sipërfaqe 171,6 m², sipërfaqe totale ndërtimi 171.6 m², në ZK 3554, pasuria 73/1/1, rezultoi se: distanca e ndërtimit informal me rrugën nuk saktësohet, pasi sipas genplanit paraqitet 21.5 m, ndërsa sipas HTR pasqyrohet ngjitur me rrugën (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 73/1/1, ZK 3554, Synej**, për shkeljet e konstatuara të kërkojë nga subjekti **plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar, për saktësimin e distancës të ndërtimit informal nga rruga .**

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Dosja 665 S.GJ me leje legalizimi 7002128, datë 16.09.2016, *“godinë banimi 1-kat”*, **Golem**, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 399 m² (*sipërfaqe ndërtimi dhe totale 133,1 m²*, në **ZK 1791, pasuria 38/26/1**. Statusi juridik i pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur objekti është sipërfaqja 650 m² arë “shtet”, pasurisë 38/24, vol 6, faqe 184, ZK 1791, rezultoi se:

a. Përveç legalizimit të parcelës ndërtimore shtet 399 m², subjekti ka të zaptuar dhe e posedon edhe pjesën e parcelës ndërtimore të pa legalizuar 250 m² (650-399), pa asnjë



detyrim financiar apo qiraje. Veprim në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16, i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 38/26/1, Golem, ZK 1791**, për shkeljet e konstatuara:

- të marrë masa për sistemimin "*shtet*" të sipërfaqes të palegalizuar 250 m², ose për shitjen e saj poseduesit me çmimet e tregut apo dhënien me qira,
- të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar për pagesën e taksës infrastrukturës dhe parcelës ndërtimore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Dosja e H.RR , leje legalizimi datë 16.09.2016, **ndërtesë banimi 2-kat, pasuria 3/312, ZK 8552**, lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 123 m² me sipërfaqe ndërtimi 123 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 263,4 m², rezulton se:

a. Ish/ALUIZNI Kavajë nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka dërguar shkresë pushtetit vendor, nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të qendrës qytetit, ka zënë hapësirën publike, shkel distancat nga rruga dhe pallati si dhe kufitarët.

b. Ndërtimi informal 2-kat me 123 m² është ngritur mbi ndërtimi ekzistues (prishur) me 109 m², pra **paraqet shtesë të bazës së ndërtimit prej 14 m²**, madje shkallet janë jashtë objektit mbi trotuare, për pasojë kjo shtesë dhe shkallët kanë ndikuar në hapësirën publike, probleme të cilat nuk janë prekur nga inspektorët e terrenit (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria nr. 3/312, ZK 8552**, për shkeljet e konstatuara: **të marrë masa për kufizimin e pasurisë deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar në bashkëpunim me pushtetin vendor**, për shtesën e ndërtimit prej 14 m².

Brenda muajit Shkurt 2020

8. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) në marrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", në të gjitha rastet , nuk ka vërtetimin e likuidimit të taksës së infrastrukturës, për **1947 objekte** informale, në kundërshtim me nenin 27 pika "ç" "*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë*" "ligjin nr. 948 datë 03.04.2006 i ndryshuar "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" , duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 78,940,503 lekë** (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, të plotësoj dosjet me dokumentacionit tekniko-ligjor, të objekteve të legalizuara me mandat pagesat përkatëse për secilin objekt të likuiduar në Bashki të Kavajë dhe Rrogoshinë **në mos pasje të vërtetimit të taksës së infrastrukturës të vendosen masa për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda muajit Shkurt 2020

9. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste u konstatua se ndërtimet informale të legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, konkretisht:

a. Leje legalizimi 7002061, datë 31.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, mbi godinë ekzistuese 2-kat (*gjithsej godinë banimi 4-kat*), **pasuria 16/148/1, ZK 8551**, lagje 2, Kavajë,



me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 126 m² me sipërfaqe ndërtimi 126 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 294,2 m², rezulton se:

- ndërtimi informal krahas shtesës në lartësi 2-kat paraqet dhe **zgjerim 30 m²** (126-96), **shtesë e cila prek rrugën** dhe nuk kthehet në truall, sipas shkresës ZVRPP nr. 4613/1 datë 21/07/2016, ku thuhet: *parcela ndërtimore 126 m², mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal 126 m², përfshinë pasuri tjera, si: * pasurinë 16/143, rrugë, vol 7, faqe 146, ZK 8551, në emër shtet dhe * pasurinë 16/148, truall 273 m² (nga kjo 96 m² ndërtesë) vol 10, fq. 55, ZK 8551,*

b. Leje legalizimi 7002117, datë 26.08.2016, shtesë godinë banimi 2-kat, e ngritur mbi ndërtesën e vjetër 82 m² (prishur), **pasuria 4/154, ZK 8552,** lagje 3, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 109 m² me sipërfaqe ndërtimi 109 m² për banim dhe sipërfaqe totale ndërtimi 255 m², rezulton se: **ndërtimi informal ka pjesërisht probleme me truallin për diferencën me sipërfaqe 27 m²** (109-82= 27 m² rrugë), pasi ndërtimi informal ka bazë ndërtimi sipërfaqen 109 m² nga 82 m² që ishte ekzistuesi (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektet informale të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 16/148/1, ZK 8551 dhe pasuria 4/154, ZK 8552,** për shkeljet e konstatuara: **të kërkojë plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar, për dokumentin për marrëdhëniet pjesore me truallin (30 dhe 27m²).**

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Leje legalizimi datë 23.09.2016, **godinë banimi 3-kat+grazhd, pasuria 12/347, ZK 8552,** lagje 5, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² me sipërfaqe ndërtimi 156 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 646 m² për banim, rezulton se: **Dokumentacioni,** aktkonstatimi i terrenit datë 31.08.2016 dhe vetdeklarimi i subjektit 04.05.2006, **paraqet mospërputhje të dhënash, lidhur me distancat e objektit me kufitarët** në kundërshtim me nenin 2, pika 3, të ligjit nr. 8482, datë 03.04.2006 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 12/347, ZK 8552,** për shkeljet e konstatuara: **të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor, duke saktësuar distancat nga rrugët, më tej të rivlerësojë gjendjen tekniko ligjore nëse duhet kufizuar pasuria.**

Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2020

11. Gjetje nga auditimi: Dosja e M.S, leje legalizimi me numër serie 7010383 datë 24.04.2019, **ndërtesë 1-kat** për aktivitet social-ekonomik, **pasuria 8/182, ZK 8551,** lagja nr.1 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 21 m² me sipërfaqe ndërtimi 21 m² për aktivitet, rezulton se sipas shkresës ZVRPP 3322/1 datë 28.04.2019, ku thuhet: *Parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë pasurinë 8/321 e llojit truall dhe pasurinë 8/83 e llojit "shesh" në emër "shtet" vol 8 faqe 7.* Veprime në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, me nenin 62 të Rregullores së Urbanistikës të ligjit urbanistikës nr. 8405 17.9.1998 i ndryshuar me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit"(Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal **"ndërtesë 1-kat social-ekonomik"** të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara: **të marrë masa kufizimi për pasurinë nr. 8/182, ZK 8551,** deri në



plotësimin e dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të sigurojë dokumentin për marrëdhëniet pjesërisht me truallin, pasi ndërtimi informal prekë pjesërisht sheshin.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast legalizimi i ndërtimit informal prek zbatimin e projektit infrastrukturës rrugore, pasi nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga me të cilat kufizohet, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ndryshuar ligjin nr. 50/2014, me VKM nr. 756 datë...10.2016 pika 2 /i dhe gj, me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës të ligjit urbanistikës 8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, konkretisht:

Pasuria 4/515/1, ZK 8551 pasqyrohet e mbështetur në 2 pasuri, përkatësisht: pasuria 4/415, truall 156 m² me status juridik "shtet", e kufizuar në seksionin E, pasi është zënë në mënyrë të paligjshme nga 2 ndërtime pa leje, vol 20, faqe 51 si dhe pasuria 4/510 truall 1138 m² "shtet", ku ka okupim nga 2 ndërtesa pa leje (vol 20, faqe 48), çka lind e nevojshme deklarata noteriale e pronarëve kufitarë për pjesën e pasurisë së zënë në mënyrë të paligjshme, e cila mungon. Leja e legalizimit është e korrigjuar tek parcela ndërtimore, pasi nga 239,3 m² është korrigjuar 188,5 m², pra diferenca 50,8 m².

Vendimi i kualifikimit datë 12.06.2019 është nxjerrë para kthimit përgjigjes nëse ndërtimi cenon rrugën në studim, sipas shkresës të ish-ALUIZNI Kavajë nr. 1923, datë 28.06.2019, ku kërkohet (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për 2 ndërtimet informale **pasuritë nr. 4/515/1, ZK 8551**, të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara: **të sigurojë dokumentacionin tekniko ligjor** që nuk cenon infrastrukturën rrugore dhe që ka shlyer detyrimet në të kundërt të kufizohet pasuria.

Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2020

13. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 1145, A.A , leje legalizimi datë 27.08.2019, titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM, "ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik", pasuria 14/389, ZK 8551, lagjja nr. 2 Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 34,5 m² me sipërfaqe ndërtimi 34,5 m², rezulton se:

-Subjekti ka të legalizuar parcelën ndërtimore me sipërfaqe 34,5 m², por në fakt disponon sipërfaqen e zënë në mënyrë të paligjshme 62 m², sipas të dhënave të ZVRPP, për rrjedhojë diferenca tepër 27,5 m² e zënë në mënyrë të paligjshme (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për ndërtimin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria nr. 14/389, ZK 8551**, për shkeljet e konstatuara **të sistemohet në "shtet" diferenca tepër e sipërfaqes 27,5 m² e zënë në mënyrë të paligjshme.**

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes K.ç me leje legalizimi datë...08.2019, për "shtesën anësore 2-kat + ngritje 1-kat në godinën ekzistuese ish-dekori, argjila dhe qeramika ose poçeria Kavajë", pasuria nr. 2/304/2 dhe 2/304/1, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 93 m² (sipërfaqe ndërtimi 85 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi e shtesës 161,7 m² për banim dhe 170 m² për aktivitet), pasi nuk respektohet distanca, konkretisht: skicat nuk i pasqyrojnë distancën e pronës nga rruga (veri), po kështu, proces verbali i konstatimit datë 27.02.2018 nuk pasqyron pasuritë kufitare dhe distancat e tyre nga pasuria e legalizuar.



Nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin për diferencën 514 m² (blerë 2040 m²-2554m² LN), e cila duhej të kalonte "shtet" si diferencë midis sipërfaqes blerjes truallit (1998) me LN (2017), pasuria 2/304 (2017) ZK 8551, vol 13, faqe 247, në emër të K.Ç, sipas shkresës ZVRPP 1362/1 datë 28.03.2018, ku pasuria e legalizuar përfshinë pasuritë 2/304 "K. Ç", 2/55 dhe 2/54 "shtet" si dhe nr. 2/56 "bashkëpronarët" (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria nr. 2/304/2 dhe 2/304/1**, "shtesën anësore 2-kat + ngritje 1-kat në godinën ekzistuese poçeria Kavajë", ZK 8551, të marrë masa:

- të kalojë "shtet" sipërfaqen tepër 514 m², si diferencë midis sipërfaqes blerjes truallit (1998) dhe LN (2017), pasuria 2/304, ZK 8551, vol 13, faqe 247.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes 6 bashkëpronarëve "Gj" me leje legalizimi datë...05.2019, për "godinë e kombinuar 2-kat", **pasuria nr. 1/89/1**, ZK 8551, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², sipërfaqe ndërtimi 392,5 m² për banim dhe 410,6 m² për aktivitet, rezulton se:

- nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara procesverbali i verifikimit në terren datë 13.03.2017, pasi është mjaftuar vetëm me emërtimin e pronarit, objektit e nënshkrimin e inspektorëve terrenit.

- dëshmia e trashëgimisë datë 26.03.2019 është e parregullt, pasi është fotokopje e pa noterizuar.

- mungon vërtetimi ose shkresa e ALUIZNI në adresë bashkisë Kavajë, për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, mungon VKM dhe dokumenti për detyrimin për parcelën ndërtimore.

Në kushtet tilla është dhënë leja e legalizimit, në kundërshtim me nenin 33 "Dispozitë detyruese" të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin 50/2014, neni 33 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria nr. 1/89/1**, ZK 8551, "godinë e kombinuar 2-kat", për shkeljet e konstatuara të **plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar si me sipër.**

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes A.G me leje legalizimi datë 23.08.2019, për objektin "godinë e kombinuar 3-kat", **pasuria 482/17/1**, ZK 3235, Rrogozhinë, parcela ndërtimore 500 m², për aktivitet 328 m² dhe 585 m² për banim, rezulton se: **mungon pjesërisht marrëdhënia me truallin për pasurisë 482/17/1, pasi një pjesë e sipërfaqes "arë" mbi të cilin është ngritur objekti është pronë e një personi tjetër (akti 329, H Q), sipas KPP pasuria 482/17, vol 10, faqe 224, ZK 3235.** Subjekti ka në pronësi pasurinë 482/16, sipërfaqe 638 m², arë, vol 3, faqe 100, ZK 3235, përfituar me KDH (me origjinë AMTP 198). Në seksionin "D" ose "E" të 2 KPP nuk citohet se: *ka ndërtim pa leje ose okupim mbi pasuritë 482/16 dhe 482/17* (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 482/17/1**, ZK 3235, **Rrogozhinë**, për shkeljet e konstatuara, **të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, për marrëdhëniet pjesërisht me truallin**, pasi një pjesë e sipërfaqes "arë" mbi të cilin është



ngritur objekti është pronë e një personi tjetër, sipas KPP, pasuria 482/17, vol 10, faqe 224, ZK 3235.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

17. Gjetje nga auditimi: D.B me leje legalizimi datë 28.06.2019, për “godinë e kombinuar 2-kat”, pasuria 6/187/1, ZK 8552, Kavajë, parcela ndërtimore 148 m², për aktivitet 132 m² dhe 170.5 m² për banim, rezulton se:

a. leja e legalizimit është dhënë në kushtet e mos paraqitjes së plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të parregullsisë së tij, në kundërshtim me nenin 33 “Dispozitë detyruese” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin 50/2014, neni 33,

b. mungon shkresa e pushtetit vendor, nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të sistemit rrugor, për efekt të zgjerimit rrugëve me interes publik, pasi objekti ndodhet ngjitur dhe mbi trotuarin e rrugës, sipas fotove dhe genplanit të objektit të kryer nga inspektorët e terrenit. Në kundërshtim me kërkesat e nenit 39 “përjashtimi nga legalizimi” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me nenin 62 të Rregullores së Urbanistikës të ligjit urbanistikës nr. 8405 17.9.1998 i ndryshuar me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me pikën 4/b të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, me VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2 si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 kap II/a dhe VKM nr. 756 datë...10.2016 pika 2 /a/ii, kapitulli II (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë , për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 6/187/1, ZK 8552, Kavajë, për shkeljet e konstatuara, të rishikojë dhe të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit të dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

18. Gjetje nga auditimi: Leje legalizimi datë 28.08.2019, për “godinë banimi 2-kat”, pasuria 11/114/1, ZK 8551, Kavajë, parcela ndërtimore 154 m², rezulton se: **Dokumentacioni tekniko-ligjor paraqet mangësi**, konkretisht:

* **parcels ndërtimore mbi të cilën është ngritur ndërtimi informal** (nr.11/114/1=200 m², vol 9, faqe 223) **i poseduar nga pronarët L përfshinë edhe pasuritë 11/73 dhe 11/74 të personave tjerë**, sipas shkresës 6328/1 datë 22.10.2018 të ZVRPP Kavajë. **Pra nuk janë zgjidhur marrëdhëniet me truallin.** Veprim në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.50/2014, nenit 62 të rregullores së urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr. 8405 datë 17.09.1998 i ndryshuar me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin rregullores zhvillimit territorit” e ndryshuar.

* mungon marrëveshja noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, pasi parcela ndërtimore prej 200 m² është pronë e 2 personave të B. L dhe A. L, sipas KPP vol 9, faqe 223 dhe 2 certifikatave familjare, veprim në kundërshtim me nenin 28/ë të ligjit “Dhënia e lejes së legalizimit”(Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë , për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 11/114/1, ZK 8551, Kavajë, për shkeljet e konstatuara: të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, në të kundërt pasuria të kufizohet.

Menjëherë



19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes me leje legalizimi datë ...02.2019, për “*godinë e kombinuar 3-kat*”, pasuria **142/33/1, ZK 2292, Kryevidh**, Kavajë, parcela ndërtimore 299,7 m², për aktivitet 99,9 m² dhe 240.6 m² për banim, rezulton se:

- **Leja e legalizimit është dhënë në kushtet e mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të parregullsisë së tij**, në kundërshtim me nenin 33 “Dispozitë detyruese” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin 50/2014, neni 33.

- **mungon statusi juridik i pasurisë (HTR dhe KPP)**, në kundërshtim me nenin 27/d të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe nr. 62/2015.

Njëkohësisht objekti nuk identifikohet, sepse ai pasqyrohet si godina e ish-komunës kryevidh, pasi në katin e parë të fotos lexohet “*B.K.K (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*”.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 142/33/1, ZK 2292, Kryevidh**, për shkeljet e konstatuara, **të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar**, në të kundërt të kufizohet pasuria.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes T. R me leje legalizimi datë 27.02.2019, për “*godinë social-ekonomike 1-kat, parukeri*”, pasuria **456/33/4, ZK 3235, Rrogozhinë**, parcela ndërtimore 200 m², për aktivitet 104,9 m², rezulton se:

a. Nuk është respektuar distanca e ndërtimit informal nga rruga urbane, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, fotot në terren, rezulton se objekti ndodhet në një distancë prej **buzës rrugës qytetit me pak se përcaktimet ligjore**, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me kap II/a të VKM 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, me VKM 756 datë...10.2016 pika 2 /a/i, kapitulli II (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë , për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, **pasuria 456/33/4, ZK 3235, Rrogozhinë**, për shkeljet e konstatuara, **të rishikojë lejen e legalizimit, të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar**, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit .

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin 9317, datë 18.11.2004 “*Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë*”, neni 35 pika 2, ndryshuar 142/2016 neni 118 “*Kufizime në funksion të mbrojtjes së vijës hekurudhore*” pika 2, me VKM 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pikat 2 dhe 4, u konstatua **në 3 raste se nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore lidhur me respektimin e distancave nga brezi hekurudhor**, konkretisht:

a. pasuria 18/544/1, ZK 8552, Kavajë, *ndërtesë e kombinuar 2-kat*, në emër të T.M, me leje legalizimi datë07.2019,

b. pasuria 2/371/1, ZK 8551, Kavajë, *ndërtesë e kombinuar 2-kat*, në emër të B dhe G. B, me leje legalizimi datë05.2019,

c. pasuria 18/972/1, ZK 8552, Kavajë, *ndërtesë social-ekonomike 1-kat*, në emër të H. I, me leje legalizimi datë05.2019 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



21.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë , për shkeljet e konstatuara në **3 objektet** të pajisura me leje legalizimi, pasuria nr.18/544/1 dhe nr. 18/972/1, ZK 8552 si dhe pasuria 2/371/1, ZK 8551, të rikërkojë rivlerësim nga DP e Hekurudhave dhe në të ardhmen të mos kryej legalizime të ndërtimeve informale në kushtet e mos respektimit të distancave nga brezi hekurudhor.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste u konstatua se ndërtimet e legalizuara kanë pjesërisht probleme me truallin, pasi parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë edhe pasuri të tetëve, të cilët kanë certifikate pronësie:

a. Dosja e B.H dhe F.H, leje legalizimi datë ...08.2019, *ndërtesë social-ekonomike 3-kat, pasuria 25/41/1, ZK 3501*, Spille Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² me sipërfaqe ndërtimi 262 m², sipërfaqe për aktivitet 795,2 m²,

b. Dosja e A.C ose "M" shpk, leje legalizimi datë01.2019, *ndërtesë social-ekonomike 2-kat, pasuria 72/24/1, ZK 3554*, Synej Kavajë, baxho qumështi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqe ndërtimi 2271,3 m² sipërfaqe për aktivitet 4542,6 m²,

"M" shpk disponon prone të tij pasurinë 72/24, sipërfaqe 2000 m² truall (nga kjo 380 m², ndërtesë 3-kat ekzistuese ish-zyrat e konop. Synej), sipas certifikatës pronësisë 13.03.2007, ndërsa per zgjerimin "*shtesë 2-kat në objektin ekzistues 3-kat*" nuk ka dokument pronësie për diferencën e truallit me sipërfaqe 271,3 m² (2271,3-2000), pasi sipërfaqja e parcelës dhe ndërtimore është 2271,3 m² 2271,3 m², nga 2000 m² që ka pronën e tij (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për 2 objektet informale të pajisura me leje legalizimi, **pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille dhe pasuria nr. 72/24/1, ZK 3554**, Synej, për shkeljet e konstatuara: **të kufizohen pasuritë deri në zgjidhjen e marrëdhënieve për një pjesë me truallin**, pasi është pasuri e të tetëve.

Brenda 3 mujorit parë 2020

23. Gjetje nga auditimi: Dosja me leje legalizimi datë 31.01.2019, *ndërtesë e kombinuar 3-kat, pasuria 5/385/2, ZK 8551*, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 479,7 m² me sipërfaqe ndërtimi 289,5 m², sipërfaqe për aktivitet 185,3 m², rezulton se:

a Sipas shkresës ZVRPP 322 datë 17.01.2019, HTR dhe KPP, **parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë pasuri tjera private dhe shtet**, konkretisht:

- pasurinë 5/60 "rruge e kanale" në pronësi shtet, vol 8, faqe 1, ZK 8551.

- pasurinë 5/4 "are" , vol 17, faqe 80, ZK 8551. Veprimet janë në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" të ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe 62/2015, me VKM 280, datë 1.4.2015 "*Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe lartësi, në ndërtime me leje*" (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara për **pasurinë 5/385/2, ZK 8551**, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 479,7 m² me sipërfaqe ndërtimi 289,5 m², të marrë masa: **të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke përcaktuar 300 m² parcelën ndërtimore nga 479,7 m² që ishte legalizuar (479,7 m²-179,7), pasi diferenca e sipërfaqes 179,7 m² është pjesë e pasurisë 5/4.**

Menjëherë



24. Gjetje nga auditimi: Subjekti A SHPK, *godinë shërbimi 4- kat+podrum*, ZK 1791, Golem, pasuria 21/38/1 me leje legalizimi...08.2019, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 226,5 m² (sipërfaqe ndërtimi 226,5 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 1242,1 m² për aktivitet, rezulton se: **paraqet problem statusi juridik i pasurisë, pasi:**

a. në origjinë është pemë dhe jo truall, siç thotë kontrata për dhënie trualli 21.08.1997, lidhur midis urbanistikes rrethit dhe privatit, e cila është e pa rregullt nga forma dhe përmbajtja.

b. parcela ndërtimore ose truall 300 m², mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal, përfshinë pasuri tjera, konkretisht 21/75 peme dhe 150 rruge e kanal ne emër shtet, sipas shkresës ZVRPP nr. 1515/1 datë 28/02/2019 e cila është fotokopje bashkë me KPP dhe HTR përkatëse (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara për **pasurinë 21/38/1, ZK 1791, Golem**, të marrë masa: të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke verifikuar dhe siguruar dokumentacionin e duhur, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Dosja e F.H, leje legalizimi datë 22.11.2018, *ndërtesë social-ekonomike 4-kat*, pasuria 429/3/1, ZK 3235, Rrogozhinë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 434,3 m² me sipërfaqe ndërtimi 248,5 m², sipërfaqe për aktivitet 692,8 m², rezulton se:

a. parcela ndërtimore mbi të cilin është ngritur ndërtimi informal përfshinë pasuritë 429/3 "kullote", pasurinë 704/1 "kanale" dhe 703 "rrugë", në pronësi shtet, vol 8, faqe 136 dhe 197, vol 5, faqe 173, ZK 3235, Rrogozhinë, sipas shkresës ZVRPP 6973/1 datë 26.10.2018. Pra mungon dokumenti për marrëdhëniet me truallin (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara për **pasurinë 429/3/1, ZK 3235, Rrogozhinë, ndërtesë social-ekonomike 4-kat**, të marrë masa që:

- të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke verifikuar dhe siguruar dokumentacionin e duhur, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Dosja nr.1227 datë 31.08.2006, leje legalizimi nr. 7010051, datë 31.12.2018, për objektin ndërtim për aktivitet 1 kat, me pronar i ndërtimit pa leje: F.R, N.R, G.R dhe D.R, Objekti ka sipërfaqe të parcelës ndërtimore 181.6 m², sipërfaqe ndërtimit 45.1 m², trualli sipas statusit juridik të konfirmuar nga ZVRPP Kavajë si dhe pjesërisht do të miratohet me VKM.

-Nuk është plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit duke specifikuar në se është për banim apo aktivitet ekonomik.

-Nuk është plotësuar rubrika për pasuritë kufitare të saktësuara me përshkrim në metra dhe me fjalë.

-Nuk është firmosur nga specialisti i hartografisë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlerësimit të dosjes (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi nr. 7010051, datë 31.12.2018, për objektin ndërtim për aktivitet 1 kat, për shkeljet e konstatuara të marrë masa dhe të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke verifikuar dhe siguruar dokumentacionin e duhur, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit.



Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

27. Gjetje nga auditimi: Sipas vet deklarimit nr. 490 datë 20.06.2006 për leje legalizimi nr. 7010109, datë 31.01.2019, ndërtim 2 kat nga i cili për banim 49.9 m² dhe aktivitet ekonomik 36.5 m².

-Në përgjigjen e ZQVRPP datë 19.02.2018, mbi kërkesën e ALUIZNI-t Kavaje nr. 3769, prot datë 31.10.2018 për statusin juridik të objektit informal të qytetarit N.L sipas kartelës së pasurisë paluajtshme thuhet se objekti ndodhet në pasurinë nr. 3/174 vol 13 faqe 148 me sipërfaqe 101.50 m² ne pronësi "R.B dhe N.B" si dhe ne seksionin përshkrimi i veçantë është shënuar se për këtë pasuri ka rekurs në gjykatën e lartë sipas shkresës nr. 760/15 datë 10.01.2017 kundër vendimit gjyqësor 3997 dt 23.12.2016.

Në dosje nuk ka vendim të Gjykatës së Lartë, pra veprimi është kryer në kundërshtim me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c, si dhe pika 2 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi nr. 7010109, datë 31.01.2019, ndërtim 2 kat nga i cili për banim 49.9 m² dhe aktivitet ekonomik 36.5 m² me pronar i ndërtimit pa leje N.B, për shkeljet e konstatuara të marrë masa dhe të **administrojë vendimin e Gjykatës së Lartë dhe të rishqyrtojë lejen e legalizimit.**

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Dosja nr.1151 me leje legalizimi nr. 7009554, datë 20.09.2018, ndërtim 1 kat për aktivitet ekonomik sipërfaqe 98 m², sipërfaqe e parcelës ndërtimore 98.5 m² me pronar i ndërtimit pa leje A.Gj,

-Rubrika për pasuritë kufitare është e pa saktësuar me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

-Në dosje mungon procesverbali i vlerësimit të dosjes,

-Sipas gent planit bashkëlidhur procesverbalit të verifikimit në terren si dhe fotove që gjenden në dosje rezulton se pasuria bie mbi trotuar (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi nr. 7009554, datë 20.09.2018, ndërtim 1 kat për aktivitet ekonomik sipërfaqe 98 m², sipërfaqe e parcelës ndërtimore 98.5 m² me pronar i ndërtimit pa leje A.Gj, për shkeljet e konstatuara të marrë masa dhe të **kërkojë plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, duke i rishqyrtuar ato e proceduar në vazhdim.**

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

30. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 1561 sipas vet deklarimit datë 01.09.2006, leje legalizimi nr. 7009794, datë 31.10.2018, për objektin ndërtim 2 kat për aktivitet ekonomik sipërfaqe 747.42 m², me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², me pronar H.D.

- Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila përbën të ardhura për **fondin e kompensimit të pronarëve.**

-Në procesverbalin e verifikimit nuk është plotësuar rubrika për qëllimin e shfrytëzimit të objektit i cili është për banim dhe për aktivitet ekonomik.

-Rubrikat për pasuritë kufitare janë të pa saktësuar me distanca dhe me përshkrim me fjalë.

-Në dosje nuk gjendet përgjigja e ZVRPP Kavajë për statusin juridik të objektit informal të qytetarit H.D, sipas shkresës së ALUIZNI-t nr. 2178 datë 13.07.2018,. Kjo mangësi është cilësuar me shënimin "Nuk ka informacion" edhe në vendimin e kualifikimit nr. 2453, datë 24.09.2018 të Drejtorit të ALUIZNI-t Kavajë (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



30.1. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 49, datë 21.03.2017, leje legalizimi nr. 7010124 datë 31.01.2019, ndërtim për aktivitet social ekonomik, skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 06.08.2018, firmosur nga ish-specialistët e verifikimit në terren është pa miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë, ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, e konfirmuar për statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë bujqësore në truall, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban", pika 9 ku përcaktohet: *"Konvertimi nga tokë "Arrë" në tokë "Truall" për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.2. Gjetje nga auditimi - Dosja nr. 953 datë 16.10.2014, leje legalizimi nr. 7010218 datë 01.03.2019, ndërtim për aktivitet social ekonomik, pronar i ndërtimit pa leje: P. H me adresë fshati Spille, Njësia Administrative Kryevidh, ZK 35.01, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 17.5 m².

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 22.02.2019, bashkëlidhur rezulton se objekti është mbuluar me llamarinë si dhe në kufirin perëndimor ndodhet kanal në distancë 4 m nga 10 m që lejon vendimi nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me vkm nr. 756, datë 26.10.2016), ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje duke sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë bujqësore në truall, në mungesë të dokumentacionit në zbatim të Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban", pika 9 ku përcaktohet: *"Konvertimi nga tokë "Arrë" në tokë "Truall" për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi" (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.3. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 139/1, datë 10.03.2005, leje legalizimi nr. 7009301 datë 23.07.01.2018, ndërtim për aktivitet social ekonomik, pronar i ndërtimit pa leje T.H, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 223.4 m².

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga tokë bujqësore në truall,

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 25.05.2018, nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.4. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 277, datë 22.02.2005, leje legalizimi nr. 7012176 datë 22.09.2016, për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje I.B, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 406 m², sipërfaqe e ndërtimit 280.9 m²,

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga ullishte në truall, në mungesë të dokumentacionit;

- Skica fushore dhe procesverbalit të verifikimit në terren datë 24.06.2016, firmosur vetëm nga specialisti verifikimit në terren, nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë D.D (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



30.5. Gjetje nga auditimi: Dosja nr.1595, datë 04.09.2006, leje legalizimi nr. 7002163 datë 20.09.2016,për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje R.A me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 490 m², sipërfaqe e ndërtimit 350.3 m²,

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së ALUIZNI-t nr. 856 prot. datë 06.09.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë në Zk 2291, zëri kadastral e llojit arë me sipërfaqe 1780 m².

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë.

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 25.07.2016, rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.6. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 1469 datë 29.08.2006, leje legalizimi nr. 702154 datë 19.09.2016, për ndërtim për banim 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: M.S me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe e ndërtimit 168.1 m²,

ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri,duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga ullishte në truall,

-Me mangësi është plotësuar procesverbali i verifikimit në terren, nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

- Nga pamjet në ortofoto konstatohet se objekti është pranë zonës rezidenciale dhe në dosje nuk ka shkresë të dërguar institucionit përkatës për konfirmimin e distancave të lejueshme (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.7. Gjetje nga auditimi:Dosja nr. 381 datë 25.03.2005, leje legalizimi nr.7010327 datë 28.03.2019,për objektin ndërtim për banim 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje A.S , me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 339 m², sipërfaqe e ndërtimit 113 m²

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke mos patur informacion për statusin e pronës. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 280 datë 01.04.2015 pika 9 e tij citohet se : *Në rast mosplotësimi, nga subjekti poseduesi ndërtimit informal, të dokumentacionit që duhet të dorëzohet prej tij, brenda 6 muajsh nga njoftimi zyrtar i ALUIZNI- t, ky i fundit informon Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për të vepruar, sipas legjislacionit përkatës.*

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

- Nga pamjet në ortofoto konstatohet se objekti është pranë linjës së tensionit të lartë dhe në dosje nuk ka shkresë të dërguar institucionit përkatës për konfirmimin e distancave të lejueshme nga rreziku i linjës elektrike (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.8. Gjetja nga auditimi: Dosja nr.1372, datë 21.08.2006, leje legalizimi nr. 7002134 datë 16.09.2016,për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje F.D, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 440 m², me sipërfaqe e ndërtimit 140.1 m², trualli vreshta pa konfirmuar nga ZVRPP.

- Në dosje nuk administrohet përgjigja e shkresës së Aluiznit nr. 625 prot. datë 04.08.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 187/162 vol 25 faqe 187 ndodhur në Zk 2291, për zërin kadastral vresht me sipërfaqe 634 m².

-Me mangësi është plotësuar procesverbali datë 05.08.2016 nga ku mungojnë të gjitha të dhënat sipas rubrikave të formatit.

-Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 05.08.2016, distanca nga kufitari në veri të objektit përshkruhet 2 m dhe në jug 2.30 m dhe në dosje nuk ka asnjë deklaratë noterile me kufitarët (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



30.9. Gjetje nga auditimi: Dosja nr. 573 datë 3.10.2014 është dhënë leje legalizimi nr.7002151 datë 13.09.2016, për objektin ndërtim për banim 4 kat, pronar i ndërtimit pa leje R.M, me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 310 m², sipërfaqe e ndërtimit 140.7 m², sipërfaqe totale për banim 922 m², trualli arë konfirmuar nga ZVRPP.

-Në vet deklarin datë 03.10.2014 e qytetarit R.M i cilësohet se objekti ndërtimit është godine 4 katërshe. ALUIZNI-t Kavaje me dokumentacionin për legalizimin e objektit bën fjalë për objekt me 4 kate nga të cilët 1 kat i nëndheshëm me sipërfaqe gjithsej 922 m² si dhe leja është plotësuar me legalizim të objektit me 5 kate.

-Në dosje administrohet përgjigja e shkresës së ALUIZNI-t nr. 526 prot. datë 20.07.2016, drejtuar ZVRPP Kavajë për konfirmimin juridik të pasurisë 185/34 vol 34 faqe 59 ndodhur në Zk 2291, për zërin kadastral e llojit arë me sipërfaqe 400 në pronësi të z. R.M.

- Skica fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren datë 11.07.2006, nuk është miratuar nga përgjegjësi i Sektorit të hartografisë .

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.10. Gjetje nga auditimi: Dosjet nr. 6274, 6290, 6291, datë 31.01.2015, leje legalizimi nr. 7002113, nr. 7002114, nr. 7002115 datë 25.08.2016, për objektin ndërtim për banim 2 kat, pronar i ndërtimit pa leje për tre objekte me sipërfaqe e parcelës ndërtimore 345 m², sipërfaqe e ndërtimit 115.1 m², trualli sipas kartelës së pasurisë së palujtëshme nr. 20/29, nr 29/30, nr.29/31 vol 14 faqe 227,228,229 me sipërfaqe 1700 m² e llojit arë, konfirmuar nga ZVRPP.

-ALUIZNI Kavajë ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këtë pasuri, duke e konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP nga arë në truall, në mungesë të dokumentacionit;

-Në procesverbalin e verifikimit rubrikat nuk janë plotësuar me të dhënat për distancat me kufitarët të shprehura në metra dhe përshkruara me fjalë.

-Në procesverbalin e vlerësimit të dosjes së legalizimit mbajtur me datë 20.07.2006 cilësohet se subjekti në dy raste ka më shumë se një ndërtim informal. Në dosjet tre objekteve të legalizuara ka të njëjtën deklaratë noteriale të qytetarit B.S për përzgjedhjen e legalizimit vetëm të një objekti, veprim çka nuk është në përputhje me ligjin e legalizimit por, në dy rastet e tjera legalizimin e dy objekteve të tjera duhen plotësuar dhe vërtetuar se detyrimet financiare janë zbatuar me çmimet e tregut (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektet informale të ndërtuara në kundërshtim me ligjin e legalizimit dhe të pajisur me leje legalizimi të cituara si **më sipër**, për shkeljet e konstatuara të marrë masa dhe të rishqyrtojë lejet e legalizimit duke kërkuar subjekteve dokumentacionin e plotë tekniko ligjor, të verifikojë dhe të rivlerësojë statusin e ri të këtyre lejeve të legalizimit pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020

31. Gjetje nga auditimi: Në ish-Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë nuk administrohet dokument mbi përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, duke mos siguruar edhe gjurmët e auditimit, në kundërshtim me Kap. I, pika 1.2, shkronja "a" dhe Kap. II, pika 2.1.2 dhe 2.1.3 të Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", me përcaktimet e bëra në Kap. 2, pika 7 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.3.2018 "Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin sistemin informatikë financiar të qeverisë", si dhe me nenin 12, pika 2 të Ligjit nr.



10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Pra nga DRAK nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar mbi planifikimin e nevojave për fonde buxhetore për vitin 2018 dhe 2019 (*Më hollësisht Trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

31.1. Rekomandim: Titullari i DVASHK Kavajë, në rolin e drejtuesit të programit buxhetor, në fillim të planifikimit të nevojave për fonde buxhetore të marrë masat e nevojshme duke krijuar ekipin e menaxhimit të programit, si dhe përcaktimin e nëpunësit zbatues të DVASHK KAVAJE, në rolin e sekretarit të grupit për hartimin e projekt-buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor. Gjithashtu procedura e përgatitjes së buxhetit të sigurojë gjurmët e auditimit, ku çdo anëtar i grupit të menaxhimit të programit të dokumentojë me shkresë përcjellëse drejtuar sekretarit të grupit, kërkesat për fondet buxhetore, për strukturën që është përgjegjëse.

Në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste është konstatuar keq klasifikim i shpenzimeve në llogaritë ekonomike të përdorura, në kundërshtim me përcaktimet e bëra për SKK 5 të përmirësuara (trajtimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale) bazuar në Urdhrin nr. 65, datë 5.5.2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar", i ndryshuar, me Kreun III, të Udhëzimit nr. 14, data 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1. Rekomandim: Titullari i DVASHK Kavajë në rolin e Nëpunësit Autorizues si dhe Nëpunësi zbatues të marrin masat që në çdo rast të shpenzimeve të institucionit ato të klasifikohen në llogarinë ekonomike të duhur, pra nëse është investim për rritjen e aktiveve të trupëzuara ose të patrupëzuara të institucionit, me jetëgjatësi mbi 1 vit, të përdoret llogaria 231 dhe jo llogaria 602, me qëllim kontabilizimin e saktë të tyre në pasqyrat financiare.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Në dy raste është vepruar në kundërshtim me pikën nr. 151, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe pikës 3, Kreu I, të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", për mosrespektimin e prioritetit të radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit (*Më hollësisht trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

33.1 Rekomandim: DVASHK Kavajë të respektojë prioritetet e radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit, në përputhje me pikën nr. 151, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe përcaktimeve të bëra në Udhëzimet plotësuese vjetore për zbatimin e buxhetit, me qëllim edhe eliminimin e efekteve negative financiare që krijohen në buxhet, nga mos pagesa në kohë e faturave për shpenzime operative (*TVSH-së, tatim mbi të ardhurat*).

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2016-2018 nga DRAK nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar i monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



34.1 Rekomandim: DVASHK Kavajë për çdo vit buxhetor të përgatisë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit (fondet buxhetore dhe të ardhurat e realizuara), si dhe raportet periodike të zbatimit të tij, si dhe të dërgojë me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës, duke siguruar edhe gjurmët e auditimit.

Në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 nga DRAK janë drejtuar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t 6 kërkesa për fonde për miratim rritje autorizim buxhetor nga të ardhurat e realizuara nga tarifat e shërbimit dhe penalitetet, për kryerjen e shpenzimeve operative, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me nenin 45, të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe me pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" (*Më hollësisht trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

35.1 Rekomandim: DVASHK Kavajë për çdo kërkesë për fonde shtesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës gjatë vitit buxhetor, të jetë e shoqëruar me një relacion ku të pasqyrohen arsyet për fonde shtesë, arsyet mos parashikimit gjatë planifikimit të buxhetit, kontributi që do të sjelli fondi shtesë në aktivitetet e DVASHK Kavajë, si dhe risqet që mund të pengojnë realizimin e tyre.

Në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Procedurat për marrjen në dorëzim të aktiveve për vitin 2016 dhe 2018, nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 42, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

36.1 Rekomandim: Nga titullari i DVASHK Kavajë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të respektohen përcaktimet e bëra, si dhe në çdo rast të mbahet në konsideratë, që komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, të ketë specialist të fushës në përbërje të tij në varësi të llojit të aktiveve që merren.

Në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2015-2018, u konstatua se vlerat e aktiveve të institucionit, të pasqyruara në raportet e inventarizimit periodike vjetore rezultojnë me diferenca, viti 2016-410,139 lekë; viti 2017 me diferencë në vlerën 306,674 lekë dhe viti 2018 me -644,957 lekë. Gjithashtu rezultoi se në asnjë prej viteve 2016-2018, nga komisionet respektive të inventarizimit të aktiveve, nuk janë pasqyruar diferencat dhe më pas të mbaheshin procesverbalet për këto diferenca, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja "b" dhe "c" të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1 Rekomandim: Nga titullari i DVASHK Kavajë, të merren masat e nevojshme për sistemimin e diferencave të aktiveve, të rezultuara nga procesi i inventarizimit, si dhe të bëhet kontabilizimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse. Gjithashtu çdo komision inventarizimi për çdo diferencë që rezulton nga inventarizimi i aktiveve me vlerën e tyre në kartelat përkatëse të mbajë procesverbal dhe në fund të procesit të hartojë raportin e inventarizimit për nivelin drejtues të institucionit.

Në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2016-2018 është konstatuar se vlera e detyrimeve të DRAK-së, pasqyruar në Pasqyrat Financiare sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni janë të gabuara dhe nuk pasqyrojnë informacion të saktë dhe real, në kundërshtim me nenin 61,



shkronja "a" dhe "b" të Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr. 25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr. 8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

38.1 Rekomandim: Nga titullari i DVASHK Kavajë të merren masat e nevojshme për sistemimin e diferencave që rezultojnë, si dhe në çdo rast të bëhet kontabilizimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit për vitin 2017, ka konstatuar përlllogaritje të gabuar të vlerës së amortizimit për aktivet e institucionit, konkretisht për vitin 2017 sipas përlllogaritjeve të DRAK vlera e amortizimit është 287,183 lekë, ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit është 130,942 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqe 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

39.1 Rekomandim: Titullari i DVASHK KAVAJE Kavajë të marrë masat e nevojshme për përlllogaritjen e saktë të vlerës së amortizimit të aktiveve të institucionit dhe kontabilizimin e saktë dhe real të tyre në pasqyrat financiare.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi

40. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit për vitin 2018, në 3 raste ka konstatuar se llogaria 7110 të ardhura nga tarifa administrative dhe rregullatorë, llogaria 7115 të ardhura nga gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime, llogaria 7116 të ardhura nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore, nuk pasqyrojnë vlerën reale të të ardhurave të rakorduara me thesarin në fund të vitit 2018, në kundërshtim me nenin 11 dhe 15 të Ligjit nr. 25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreun II, Kap 2.1, pika 5, paragrafi i parë, të Udhëzimit nr. 8, data 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja "ë" të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

40.1 Rekomandim: Titullari i DVASHK KAVAJE Kavajë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë dhe real të vlerave të të ardhurave në llogaritë e mësipërme në pasqyrat financiare.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nuk ka dërguar shkresë për likuidimin e taksës së infrastrukturës për 823 objekte të legalizuara në vlerën prej 31,737,349 lekë, në kundërshtim me nenin 27 pika "ç" "vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë" ligjin nr. 948 datë 03.04.2006 i ndryshuar "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" (*Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

41.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, të dërgojë pranë bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë, listën e 823 objekteve të legalizuara dhe të kërkojë vërtetimin të likuidimit taksës së infrastrukturës të papaguar.

Brenda muajit Shkurt 2020



42. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet, nuk ka vërtetimin e likuidimit të taksës së infrastrukturës, për **1947 objekte** informale, në kundërshtim me nenin 27 pika “ç” “*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë*” (ligjin nr. 948 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 78,940,503 lekë** (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, të plotësoj dosjet me dokumentacionit tekniko-ligjor, të objekteve të legalizuara me mandat pagesat përkatëse për secilin objekt të likuiduar në Bashki të Kavajë dhe Rrogozhinë *në mos pasje të vërtetimit të taksës së infrastrukturës të vendosen masë për kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.*

Brenda muajit Shkurt 2020

C. I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësive publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë administrative dhe ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e demit **në vlerën 384,000 lekë në total**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e demit, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në dy raste të procedurës së marrjes me qira të ambienteve për zyra për vitin 2018 dhe 2019, grupi i auditimit ka konstatuar se ofertuesi i shpallur fitues nga anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave të ngritur me Urdhrin e brendshëm nr. 35 prot., datë 21.03.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dokumenteve dhe çmimeve mbi marrjen me qira të ambienteve për zyra” është bërë në kundërshtim me kriteret e hartuara në dokumentin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 34 prot., datë 21.03.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e dokumenteve dhe kriterëve për marrjen me qira”, për arsye se është vlerësuar oferta e cila ka mangësi në dokumentacion dhe nuk plotëson kriteret e vendosura, konkretisht për dokumentin e pronësisë së ambienteve pasi disponohet dokument pronësie vetëm për sipërfaqen 110 m² dhe jo për sipërfaqen 101.6 m², dhe si pasojë e këtyre veprimeve fondet e shpenzuara për hapësirën 101.6 m² nga data 03.04.2018-03.04.2019 në vlerën **384,000 lekë do të konsiderohen mospërdorim efektiv i fondeve publike** (Më hollësisht trajtuar në faqe 56-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Titullari i DVASHK Kavajë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **384,000 lekë nga subjekti përfitues.**

Menjëherë

C. II. TË ARDHURA TË MUNGUARA.



1. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) në marrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", në të gjitha rastet, nuk ka vërtetimin e likuidimit të taksës së infrastrukturës, për **1947 objekte** informale, në kundërshtim me nenin 27 pika "ç" "**vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë**" (ligjin nr. 948 datë 03.04.2006 i ndryshuar "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 78,940,503 lekë** (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, të plotësoj dosjet me dokumentacionit tekniko-ligjor, të objekteve të legalizuara me mandat pagesat përkatëse për secilin objekt të likuiduar në Bashki të Kavajë dhe Rrogozhinë **në mos pasje të vërtetimit të taksës së infrastrukturës të vendosen masë për kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda muajit Shkurt 2020

2. Gjetje nga auditimi: Në ish/Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë) nga 2950 leje legalizimi të lëshuara, 1798 leje legalizimi vlerë **63,700,768 lekë** dhe Bono Privatizimi, janë **pa VKM**. Lejet e legalizimit janë vetëm për objektin e ndërtimit pa likuiduar parcelën ndërtimore. Në lejet e legalizuara është vendosur shënimi "Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave" referuar V.K.M. nr. 954, datë 25.11.2015 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015", veprim në zgjatje të afateve, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17, pika 5 (Trajtuar në faqet 19-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

-të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **1798 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin e vlerës së parcelave ndërtimore prej 63,700,768 lekë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit ka konstatuar se në procedurën e prokurimit publik me objekt "furnizimin me kompjuteri" për vitin 2016, me fond limit 300,000 lekë pa TVSH, nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të furnizuara, nuk administrohet asnjë dokument ose procesverbal", verifikimin e tyre e më pas në arritjen në përfundimin se këto mallra nuk janë sipas përcaktimeve të bëra, duke mos siguruar gjurmët e auditimit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2/a-g, në nenin 12, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Si pasojë e këtij mosveprimi është krijuar efekt negativ financiar në vlerën 32,500 lekë, diferenca në lekë nga oferta e përzgjedhur fituese me ofertën e shkualifikuar (Më hollësisht trajtuar në faqe 89-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Titullari i DVASHK KAVAJE Kavajë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 32,500 lekë, si dhe çdo veprim nga komisionet e ngritura për realizimin e procedurave të prokurimeve (komisioni i prokurimit, komisioni i marrjes në dorëzim, komisioni i përcaktimit të kriterëve kualifikuese, etj) të dokumentohen dhe inventarizohen.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Kavajë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë), në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe (ISSAI 4100)³ për të cilën do të japim opinionin:

-Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i dërgojë shkresat Bashkive Kavajë dhe Rrogozhinë për 823 objekte të cilat nuk u janë nisur shkresat bashkive përkatse për likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën **78,940,503 lekë, dhe nga keto nuk janë nisur shkresat për 823 objekte në vlerën prej 31,737,349 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, në refuzim të vendosën masë për kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

- Për 1798 leje legalizimi të lëshuara dhe dërguar në ZVRPP për regjistrim të objektit informal për periudhën objekt auditimi në momentin e auditimit nuk ka VKM për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objektit të legalizuar duke sjellë mos llogaritjen e detyrimit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore dhe krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit e ish pronarëve në shumën 63,700,768 lekë,

- Në 11 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përjashtimi nga legalizimi" me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" kreu III. "Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara", pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë", neni 2 "Përcaktime dhe klasifikime rrugësh" dhe neni 4, "Përcaktimi i qendrave të banuara" -VKM nr. 153, date 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë" neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në 6 rast është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" Kreu III, pika 4, germat: "dh";

-Në 19 raste me sipërfaqe prej 6,727 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit "Arë, Pyll,Ullishte". Pra legalizimi është kryer në zona "Territore të tjera", për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në

³ **ISSAI 4100** - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”

-Në 2 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur dhe pamjes grafike të ASIG rezultojnë se objekti ndodhet mbi një objekt tjetër, dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej verifikimit të pronësisë së parcelës ndërtimore si dhe marrëdhënies me objektin e vjetër, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim. Veprimet janë në kundërshtim me: nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 13.

-Në 3 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezultojnë se objekti është i ndërtuar mbi tortuar mos zbatimit së ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Veprimet në kundërshtim me: nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006; VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 1 e 7.

- Në 3 raste Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si vetëdeklarimi (i regjistruar edhe në faqen zyrtare të ALUIZNI-t) fotografitë e objektit si dhe imazhet satelitore konstatohet se objekti informal i vetëdeklaruar është ndërtuar pranë shirave hekurudhore në kundërshtim me ligjin 9317, datë 18.11.2004 “ Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” neni 35 pika 2 i ndryshuar me 142/2016 neni 118 ,pika 2 si dhe me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, dhe VKM 280 pika 2 dhe 4 e ndryshuar.

-Në 61 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyrojnë kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri)

Opinion i kundërt mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së ALUIZNI Kavajë⁴

Sipas opinionin tonë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, aktiviteti i kryer nga Drejtoria e ALUIZNI Kavajë për zbatimin e procedurave në legalizimin e ndërtimeve informale për periudhën 2016-Gusht 2019, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, kuadrin ligjor “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të cilat në

⁴ Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura, ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KAVAJË"

gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

Ne besojmë se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kundërt.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Projektraport auditimi duhet t'u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Projekt Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

H	M	Përgjegjës grupi
B	B	Anëtar,
XH	D	Anëtar,
K	K	Anëtar.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Bajram **LAMAJ**